
Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti VII (XXI) - Nr. 25 (178) ISSN: 2305-655X

SHKENCA ISLAME | SOCIOLOGJI | PSIKOLOGJI | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE

25

2018

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI VII (XXI) 2018, NR. 25 (178)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2018

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VIII VII (XXI), tetor, nëntor, dhjetor 2018 nr. 25 (178)

Nën kujdesin e: H. Skender Bruçaj

Drejtor: Dorian Demetja

Bordi editorial: Prof. Dr. Ferdinand Gjana, rektor, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, dekan, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Tidita Abdurrahmani, dekan, Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, dekan, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Prof. Dr. Ayhan Tekines, Austri
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Njazi Kazazi, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti i Tiranës
Dr. Agron Tufa, Universiteti Bedër
Dr. Atakan Derelioglu, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, Universiteti European i Tiranës
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
Dr. Matilda Likaj, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Dr. Xhemal Seferti, Universiteti Bedër
PhD. Cand. Ali Zaimi, drejtor, Medreseja e Tiranës
MS/MA Fatos Kopliku, Washington, DC, SHBA
MA. Ramadan Shkodra - Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë
Xhemal Balla, Tiranë

Kryeredaktor: Dr. Genti Kruja

Redaktor: Andrin Rasha
Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi /
Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: Pamje nga Pogradeci , Sh. Pici 1929.

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50,
Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zanimalte.al
www.zanimalte.al

Përmbajtja

Shkenca Islame

1. Mendime, **Rexhep Vokë-Tetova, Myfti i Manastirit** me parathënie nga **Akademik Feti Mehdiu, Kosovë**5
2. Hafiz Ali Kraja, “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”,
Xhorxhina Seferi, Kolegji Universitar Bedër16

Studime

3. Ligjërimi që u bë gurkyç i fetarisë,
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, Kolegji Universitar Bedër27
4. “Medresetë e Shkodrës” (nga fillimet deri në vitin 1947),
Prof. dr. Njazi Kazazi, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”45
5. Mevlana Xhelaluddin Rumi - Simbol i dashurisë (II),
MA. Dorian Demetja, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë63

Histori

6. Historia e personaliteteve shqiptare të Vilajetit të Janinës (1859-1909) III,
Syrja bej Vlora,
editor **Dr. Hasan Bello, Instituti i Historisë, QSA**76

Recensë libri

7. Recensë mbi librin “Tarikati Halveti te shqiptarët” të studiuesit Dr. Alban Dobruna,
Dr. Ilirjana Kaceli, Kolegji Universitar Bedër105

Personalitet

8. Salih ef. Myftia110

Retrospektivë

9. Nisjativa te reja për bashkëpunim midis feve II	115
10. Abstracts in English	122
11. Rregullat e shkrimit	129



MENDIME*

Rexhep Vokë - Tetova
Myfti i Manastirit

Abstrakt

Libri “Mendime” është i shkruar në gjuhën shqipe me alfabetin osman. Edhe Voka, si disa autorë të tjerë shqiptarë, të cilët veprat e tyre i shkruan në gjuhët orientale, në radhë të parë në gjuhën turke, perse dhe arabe, e shkroi këtë vepër në prozë të rimuar. Padyshim për këtë formë ndikim të madh kanë letërsitë orientale. Këtu nuk do ndalemi në analizë të hollësishme, sepse nuk është ky qëllimi ynë, por vetëm dëshirojmë që vepra e Rexhep Vokës t’u ofrohet për lexim të gjithë atyre që merren me studimin e problemeve të historisë së kulturës sonë kombëtare. Vetëm në këtë mënyrë, pasi deri tani kjo vepër, në formën e saj, nuk ishte e afërt për masën e gjerë të studiuesve, mendojmë se krijohen mundësitë që një vepër të çmohet realisht. Kuptohet, duke e peshuar atë me peshoren e kohës së vet dhe rrethanat në të cilat lindi kjo vepër.

* Titulli i origjinalit: Mendime, Murettibi Manastir myftisi, Kalkandelenli Rexhep Xhevdi bin Nureddin Voka, Tab-i ev-vel: Matba-i Ebu Zija, 1327. Ribotuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Tetovës me parathënie, transkript dhe përshtatje në gjuhën e sotme shqipe nga Prof. Dr. Feti Mehdiu, lektor Mr. Elez Ismaili dhe korrektorë Bahri Aliu & Neshat Xheladini, Tetovë 1991.

P.s. Fusnotat gjatë tekstit origjinal të transkriptuar, të cilat janë me yll dhe të gjitha fjalët e vura në kllapa janë të autorit.

Akademik Feti Mehdiu Disa fjalë për Rexhep Vokën dhe veprën e tij “Mendime”

Për jetën dhe veprën e Rexhep Vokë Tetovës lexuesi jonë është informuar qysh në vitin 1957 nga një punim i Dr. Hasan Kaleshit¹. Edhe më vonë është shkruar nga i njëjti por edhe nga të tjerë. Shënime më të plota për jetën e tij na jep Islam Islami në punimin e botuar në revistën Dituria².

Rexhep Voka u lind në vitin 1847 në fshatin Shipkovicë të Tetovës. Këtu ka kryer mësimet e para, kurse të mesmet i vazhdoi në medresenë e qytetit, në Tetovë. Njohësit e biografisë së R. Vokës informojnë se që kur ishte nxënës, përveç mësimëve, ai u dallua edhe për qëndrimet e tij të qarta ndaj çështjes kombëtare. Nuk pajtohej me mësuësin e vete Behxhet Hysen efendiun kur ishte fjala për raportin kombi-feja. Voka nuk e identifikonte kombin me fenë siç bënin shumë bashkëkohës të tij.

Pasi kreu medresenë në Tetovë, me përkrahjen e xhaxhait të vet, Ali Vokës dhe Rexhep efendi Tetovës, në vitin 1868 regjistrohet në Fakultetin Islam në Stamboll. Pasi kreu studimet

1. Dr. Hasan Kaleshi, **Prilog poznavanje arbanske književnosti iz vremena preporoda**, GODIŠNJAK, I, 1957. Balkanološki Institut, Sarajevo.

2. Islam Islami, **Jeta, puna dhe veprimtaria pedagogjike e Rexhep Vokës**, DITURIA, 2-3/1971-1972, Prishtinë, f. 103-116.

për një kohë punoi si profesor në të njëjtin fakultet. Nga Stambolli në Tetovë kthehet në vitin 1895 dhe fillon të merret aktivisht me çështje të kulturës kombëtare. Ai nuk kishte mësuar në gjuhën amtare, pasi i kishte kryer shkollat në gjuhën turke, por dëshira për të mësuar në gjuhën e vet e kishte shoqëruar tërë kohën. Tani angazhohej me këmbëngulje që fëmijët shqiptarë të mësonin në gjuhën shqipe. Gjithmonë i porosiste bashkëkombësit që të arsimohen, i këshillonte të njohin dhe të respektojnë kombin e vet dhe vetveten, e kjo arrihet me dije, prandaj **“po lijet edhe kalem e këndijm fjalë e mendim”**.

Në vitin 1903 Rexhep Voka emërohet myfti i vilajetit të Manastirit, i cili përbëhej nga: Sanxhaku i Manastirit me 439 fshatra, sanxhaku i Serfixhes me 29 fshatra, sanxhaku i Dibrës me 111 fshatra, sanxhaku i Elbasanit me 155 fshatra dhe Sanxhaku i Korçës me 160 fshatra.

Sanxhaqet përbëheshin nga kazatë si vijon:

Manastiri

Kazaja e Përlepes 131 fshatra
Kazaja e Florinës 76 fshatra
Kazaja e Kërçovës 113 fshatra
Kazaja e Ohrit 103 fshatra

Serfixha

Kazaja e Kozanës 81 fshatra
Kazaja e Xhumas (Kalajar) 54 fshatra
Kazaja e Neslixhes 93 fshatra

Kazaja e Korbinit 78 fshatra
Kazaja e Alasonjës 72 fshatra

Dibra

Kazaja e Matit 32 fshatra
Kazaja e Dibrës së poshtme 37 fshatra
Kazaja e Rekës 44 fshatra

Elbasani

Kazaja e Gramshit 66 fshatra
Kazaja e Peqinit 53 fshatra

Korça

Kazaja e Kesrijes 120 fshatra
Kazaja e Starovës 100 fshatra
Kazaja e Kolonjës 54 fshatra

Në përbërje të vilajetit të Manastirit merrnin pjesë, gjithsej, 2201 fshatra.³

Gjatë shërbimit të tij si myfti i Manastirit, Rexhep Voka u dallua edhe në lëvizjen kulturore dhe politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Për këtë dëshmon pjesëmarrja e tij në Kongresin e Bukureshtit në vitin 1906 bashkë me Ismail Qemalin.⁴ Rexhep Voka ka botuar disa vepra⁵, por këtu do t'i hedhim një vështrim vetëm veprës së tij me titull "Mendime".

Libri "Mendime" është i shkruar

3. Këto të dhëna janë marrë nga: **Salname-i devlet-i alije-i Osmani-jje**, për vitin 1321 h. /1903-4/, f. 801.


4. Më gjerësisht shih: Islam Islami, **Jeta, puna dhe veprimtaria pedagogjike e Rexhep Vokës**.

5. R. Voka është autor edhe i një Ilmihali dhe i Abes-ë shqip.

në gjuhën shqipe me alfabetin osman. Edhe Voka, si disa autorë të tjerë shqiptarë, të cilët veprat e tyre i shkruan në gjuhët orientale⁶, në radhë të parë në gjuhën turke, perse dhe arabe, e shkroi këtë vepër në prozë të rimuar. Padyshim për këtë formë ndikim të madh kanë letërsitë orientale. Këtu nuk do ndalemi në analizë të hollësishme, sepse nuk është ky qëllimi ynë, por vetëm dëshirojmë që vepra e Rexhep Vokës t'u ofrohet për lexim të gjithë atyre që merren me studimin e problemeve të historisë së kulturës sonë kombëtare. Vetëm në këtë mënyrë, pasi deri tani kjo vepër, në formën e saj, nuk ishte e afërt për masën e gjerë të studiuesve, mendojmë se krijohen mundësitë që një vepër të çmohet realisht. Kuptohet, duke e peshuar atë me peshoren e kohës së vet dhe rrethanat në të cilat lindi kjo vepër.

Kur e lexojmë me vëmendje dhe analizojmë kushtet në të cilat veproi Rexhep Voka - Tetova, myfti i vilajetit të Manastirit, dhe pozitën e tij, një herë myfti e në kohët e fundit

6. Dr. Hasan Kaleshi, Autorët e Kosovës në gjuhët orientale, KOSOVA DIKUR DHE SOT, Beograd 1973. Këtu autori ka përmendur poetët: Suzi, Nehari, Sa'ji, Shem'i, Mesihi, Azmi Dede, Prishtine-i Bejzade Nuriu, Prishtineli Buhari, Behari, Sulejman efendi /Axhize Baba/, Mehmet Tahir efendi, Haxhi Ymer Lutfi Paçarizi, Shejh Hilmi Maliqi, Shejh Selimi dhe Mehmet Aqifi, por ka edhe të tjerë që nuk janë përmendur si: Maliq Sulejmani, Hafiz Islami, Hafiz Imeri, Mulla Hyseni, Mulla Mehmeti, etj.



MENDIME-REXHEP VOKA

të jetës së tij shitës lulesh e perimesh në tregun e Stambollit, si pasojë e qëndrimeve të tij ndaj kulturës dhe arsimit kombëtar, sigurisht do të japim vlerësime më reale dhe të paanshme.

“Mendimet”-t e R. Vokës kanë për qëllim të shtyjnë bashkëkombësit dhe bashkëkohësit e tij të mendojnë seriozisht për momentin historik dhe të marrin mësim nga fqinjët e tyre lidhur me ngritjen arsimore e kulturore. Libri ka vetëm 16 faqe por lexuesi e studiuesi këtu do të gjejë, përveç këshillave që janë edhe sot aktuale, edhe material për qasje shkencore nga aspekti filologjik, pedagogjik, fetar, etj.

Në transkriptimin e veprës së Vokës kanë pasur parasysh vlerat dialektologjike, prandaj kam

bërë përpjekje që të jem sa më korrekt në këtë punë, i kam ruajtur besnikërisht formën e të shkruarit dhe të vargëzimit, duke ruajtur edhe sqarimet e autorit në fusnota me yllzë në fund të faqes.

**Rexhep Voka - Tetovari
Mendime përshtatje në gjuhën e
sotme shqipe**

Lutje

O Zot! Lavdrimet dhe madhërimet e vërteta, emrat të mirë dhe gjendja e lartë të Tuat janë.

Të gjitha përsosmëritë nga vetja e për vehte⁷ i ke në çdo⁸ aspekt i pastër dhe i lartë je.

Vend e makam sigurisht nuk ke, se hasha – ruana Zota, për ty varfëri nuk ke, por pasi dëgjon dhe gjithçka sheh dhe e din, kudo që të lypim Ti je.

Gjithësinë me gjith çka ka, fare pa qenë ti e ke bë me të gjitha të mirat ti e ke zbukuru, me gjith farë pasurishë të pafund që njeriut i shtangin mendën dhe e habisin, Ti e ke lulëzu.

Kudo që të këthehemi bukuria dhe fuqia jote përpara na dalin, kahdo që lëshojmë shikimin shohim shenja të madhërisë sate.

7. Përsosmërinë e ke tënden dhe vetëm ti je i denjë për të.

8. Nuk ka ndonjë qëndrim të caktuar se ku do të përdorë -gj- e ku -xh-. Për këto ai përdor dy shenja të ndryshme në alfabetin arabo-turk dhe jemi përpjekur t'i qëndrojmë besnik.

Gjithë këtyre njerëzve e çdo lloj bagëtie, madje shpezëve në hapësirë ajrore dhe peshqive në det, haje dhe pije Ti ua⁹ fal o Zot i vërtetë.

Gjithsinë¹⁰, me këtë harmoni, pa qenë askush¹¹, Ti e ke bë! Po të duash ti sa çel e mshel sytë krejtsisht e humb, e po të urdhërosh me njëherë e kthen në vend.

Fuqia dhe madhëria yte nuk kanë fund, të mirat tua sikur deti, pa mbarim e pa fund janë.

Ti pa kërkend, prapë çka të duash në dorë e ke.

O Zot! Pashë madhërinë tënde neve të varfërve të na mëkojsh, kurrë prej dore mos të na lëshojsh.

Zemrat na i pastro, mendje dhe të menduar na e mbarëso!

Nga punët e liga na ruaj gjuhën dhe gojën nga fjalët e këqia na i pruaj.

Në ditë të kijametit rënkimet¹² të na i dëgjosh lutjet me zemër të përvëlur të na i dëgjosh.

O Perëndi, pash xhelalin dhe xhemalin dhe tërë sifati qemalin që ke, ne të ngratëve nga paudhët na largo, në rrugën tënde na drejto.¹³

9. Në vend të **ua** përdoret **va**. Kjo është karakteristike edhe për të folurën e Kërçovës edhe për të Tetovës, f. v. va ap, va dëftoj.

10. Zakonisht kështu e shkruan gjithësinë kurse gjithë e shkruan me xh. Të dalluarit e këtyre dy tingujve është problem edhe sot jo vetëm në të folmen e Tetovës por në tërësi.

11. Pa qenë kurrkush, pa ekzistuar asnjë.

12. Rënkimet, ankimet.

13. Pjesa hyrëse e cila përdoret në ven të

Disa fjalë vëllezërve të dashur shqipëtarë

Pa më dëgjoni se kam hallë t'ua them disa fjalë, sado që s'kam shkruar hadith e ajet por fjalët që dot t'jua them, secila prej tyre është një mendim i lartë dhe i vërtetë.

Din e dije

O burra! O bijë, mirë ta dini që feja e dija

janë dy fletë për njerëzinë nga Perendija,

Me ato njeriu nëse don vehten ta naltësojë

tërë jetën do të ëndërrojë.

Njerëzia e njerëzive me fe e me dije¹⁴

fetari i dijshtëm edhe te Zoti është i dashur, edhe në

sy të çdo kujt është i ndershëm

Feja dhe dija të tëra të mirat e sjellin e gjithë

të këqiat i përcjellin.

Njeriu fe e dije kur të ketë

atëherë ka gjallëri të vërtetë.

parathënies e që fillonte me falënderimet dhe lëvdimet Zotit, mbaron zakonisht me ndonjë lutje për shpëtim nga fatkeqësitë e ndryshme.

14. Siç duket, Voka me fjalën fe e kupton edhe diturinë dhe anasjelltas. Ai është i bindur se ai që nuk do diturinë nuk do as fenë, po ashtu edhe ai që nuk do fenë nuk e do as diturinë. Kjo ka qenë një metodë mjaft e qëlluar për t'i ngritur njerëzit e kohës së vet në pikëpamje arsimore.

Një njeri që nuk ka fe e dije sado që e sheh të gjallë, të vdekur dije.

I lutem Zotit në këtë jetë shqiptarë të pa fe mos të ketë.

Edhe kjo fjalë, është e zgjedhur, nga dijetarët e mentarët që i besuan të mbarët se:

Njerëzia e njerëzive me fe e me dije

bagëtia e bagëtive është me haje e me pije¹⁵

një njeri që shikon vetëm të hajë e të pijë, e nuk

mundohet të fitojë virtyte të mira dhe të mësojë fe e dije

s'dallon dot prej bagëtive, përveç se me haje e pije.

Mësime¹⁶

Burra, të shikojmë një herë në të majt e në të djatht, dhe të shohim që bota sa me vrap e me dëshirë të madhe punojnë për përparim e për gëzim të farës vet. Bashkqytetarët tonë grekë e bullgarë dhe shumë të tjerë, secili është zgjuar dhe njëmend është bashkuar. Me dashuri të madhe, që buron nga fundi i zemrës e shikojnë njëri-tjetrin në sy.

Bëjnë përpjekje. Si t'ia bëjmë e tia kthejmë se po nevojitet dije. Populli po e çmojnë dhe e dëgjojnë njëri-

15. Ai apelon që njerëzit të lartësojnë mendjen e vet duke mësuar, sepse vetëm me dije e fe njeriu dallohet nga kafshët.

16. Autori këtë titull e ka vënë në kllapa të vogla.

tjetrin. Mentarët dhe dijetarët janë vu në ballë dhe u prijnë në rrugë të përparimit dhe të fitimit. Të fortit dhe të pasurit janë bërë shpinë e ndihmëtarë të të varfërve, ua mësojmë diturinë dhe rrugën e fitimit. Me këtë rrugë të mbarë që kanë marrë dhe po e ndjekin vëllazërinë e forcojnë.

Fuqinë e shtojnë edhe farën, sojin e nderojnë. Me diturinë që kanë shti në dorë krijuan kushte për jetë të bukur¹⁷, fitim dhe livdim për farën e vet dhe gëzim – tërë botës njerëzinë ia tregojnë.

Tani, ne që jemi popull shqiptarë, duke qenë në këtë vend më shumë, më të fortë dhe më të vjetër, më të mençur dhe më të kujdesshëm, si edhe me shumë vepra tjera e cilësi të mira dhe të livduara, sot, mozo mëkeq kemi mbetur pa mësim e arsimim, nga të gjithë tjerit më të fundit jemi.¹⁸

Nuk duan të na njohin dhe të na pranojnë se jemi gjallë, as popujt që i kemi këtu brenda as Evropa.¹⁹

Kësaj kurrëgjë nuk mund t'i themi, se pasi që na ka lënë dija

nuk po na bën dobi fuqia dhe trimëria.

17. Sigurisht mendon në ngritjen e standardit jetësor.

18. Atë e bren diçka përbrenda pse kombi i tij janë të paarsimuar sa duhet dhe mundohet me çdo kusht t'i nxis për shkollim.

19. Padyshim e ka fjalën për periodën kur fati i shqiptarëve ishte në tryezën e fuqive të mëdha të Evropës dhe luanin me fatin e tyre, duke u përpjekur t'u mohojnë edhe kombësinë.

Një njeri: mësim, këndim e fitim si të mos ketë

nuk ka si e sjellë në dorë as këtë jetë as atë jetë²⁰

kushedi sa të përpiqet, ai s'mund të gëzohet asnjë ditë.

A nuk po na shohin sytë se tërë bota hyri në kadife e në mëndafsh, e ne s'jemi kah vejmë në trup brekë e kmishë.

Perëndia veç na dhasht të mbarën, se ne me këtë gjendje që kemi sot, do të mbesim robër në duar të botës tjetër kot.

Mos qoftë thënë prej Zotit të mëshirshëm se edhe një kohë kështu me shku, emri fare ka me na u harru.

Turp i madh, si për ne, burra trima, bujar, sot të mbesim më të poshtër se farët tjera.

Nuk duhet të jemi kaq të pakujdesshëm²¹.

Djemt tanë si skyfter kujt t'i teket, nga pa dija, i merr nëpër këmbë.

Ku jeni o krerët e Shqipërisë? E fikët vehten dhe i koritët varret e emrat e prindërve tanë.

Na pa këndim e pa mësim, kemi mbetur si të egër në mal e në errësir.

Veshë kemi por nuk ndijmë sy kemi e nuk shohim, mend kemi e gjë s'dijm.

Sot bota është bërë tjetër, vetëm me pushkë e me thikë nuk po fitohet. Lypet shkrim e lexim, fjalë e mendim.

Kemi mbetë në egërsinë e në errësirë

shoqi shoqin jemi duke lëvyrë

Ah, thua nuk vjen një ditë

të dalim në qytetërim e në dritë

Mundohemi dit për ditë

njanji tjetrit syt me ia qitë.

Kuku qyqe për ne!

E zeza çka na ka gjat!

Jemi duke u vra vëlla me vëlla

humbëm vehten sytë s'janë tuj na

pa,

Na të ngratët shkojmë kot

Ti, Ti na ndihmo o i madhi Zot.²²

Këto të zeza e këto punë të liga të tëra na kanë pas ardhë nga qeveria e parë dhe e shkretë që punonte në krye të vet. Na i pat prishur vetitë e mira, na pat dhënë rrugët e këqia, na dau e përçau na shtiu pushkën ndërmjet e na vrau.

Miqësinë e vëllazërinë nga mesi jonë e kishte ngritë

djallëzinë e armiqësinë na kishte pru.

20. Është i qartë mospajtimi i tij me predikimet e hoxhallarëve të cilët ndiqnin principet e feudalizmit mesjetarë, e që Voka e dinte mirë se nuk kanë lidhje aspak me predikimet kuranore, se për të fituar parajsën duhet të jetosh në vuajtje dhe skamje në këtë jetë. Rexhepi u tregon se pa dituri nuk fitohet asgjë.

21. Nuk duhet të jemi kaq të pakujdesshëm.

22. Këtu nga dëshira e tij e flakët për ta parë kombin e vet, shqiptarët, në rrugë të mbarë e të ngritur dhe të pajisur me dije, edhe pse si myfti, harron parimin kuranor i cili thotë se Zoti s'ka për t'ia ndryshuar gjendjen një populli asnjëherë në qoftë se ai popull vetë nuk ndryshon, dhe i drejtohet për ndihmë Zotit duke iu lutur: "Ti, Ti na mbarso o i madhi Zot".

Atdheun²³ dhe popullin me tëra rreziqet e kishte rrethu

i pat dhënë zjarrin, i shkonte flaka pi përpyjetë

e askush gjë nuk mund të flet.

Se ata, burrat dhe të mirët që mundoheshin për atëdhenë, dhe mendonin për popullin, njerëzit e ligj i ndiqnin në çdo formë.

I....²⁴, i mbythshin me farë e me fëmi. E merrshin më qafë, i humbnin sa e sa shpirtëra që ne duhet t'i kujtojmë e t'i madhërojmë sepse për të mirë të popullit²⁵ i kanë mbytë, oxhakët në jetë ua kanë fik.

Pas gjithë këtyre të ligave u tremb njerëzia. Botën e kaploi një droje e madhe, kurrsesi nuk guxonin të flisnin asgjë, se për pak e për shumë fundin e detit e gjejshin. Ishin bërë dy krahërorë e një krye, nga njerëzit e ligji kishin dro të shikojnë djathtas e majtas, ishte punë me erdhë krye për krye.

Vëllaun e vet njeriu, përpara e shihte dhe bëhej se nuk e njihnte, kishte frig që ta njihnte,

Zemra me njëmijë ofkamë i thëriste

por me gojë asgjë s'mund fliste.

Ah, ajo kohë e shkretë, ajo qeveri e mallkuar²⁶! Ajo ishte

23. Këtu është fjala për atdheun, mëmëdheun.

24. Këtë fjalë nuk kam mundur ta lexoj.

25. Për të mirë të popullit. Voka ndjen respekt të thellë ndaj atyre që kanë dhënë sakrificë për atdhe e popull të vet.

26. Sigurisht e ka fjalën për qeverisjen e absolutistit famëkeq Sulltan Abdul Hamidit.

armik i njerëzisë. Ajo kohë e shkretë ishte sepse çdo fjalë për mëmëdhenë trajtohej si tradhëti kundra qeverisë²⁷. Paria kishte një faj të madh që nuk falet²⁸ sa i përket shpëtimit dhe gëzimit të popullit e atëdheut. E kishin shpjer popullin e pafajshëm e të ndershëm në prag të greminës me pasuri e me fëmi. Buzë vorrit të poshtnuar e kishte shpënë, çfar ironie!? Me duar lidhur përpara shpatës së armikut kishim ra e s'kishim dert si me qa.

Kishim ardhë deri në atë shkallë që njeriu me mend në krye, kur ulej në sofër, kur i vijshin parasyshë këto rreziqe, e kaplonte kujtesa trishtuese, fëmijit si përpara xhelatit i parafytyronte²⁹, e pushtonte një i keq i madh sa kafshata në gojë e në fyt i mbeste.

Pas këtyre peripetive nuk kishim më askund ku të mbështetemi, përveç te Zoti xhel-le shanuhu, na kish mbet shpresa kah nuk shihet e nuk dihet.

Zoti me rahmet të vet, siç e dini edhe vetë, na mëshiroj, nga ajo zgjedhë e mallkuar na shpëtoj e na liroj³⁰.

27. Të flisje për atdhe quhej si ta urreje, tradhëtoje qeverinë.

28. Ai, Rexhepi, e dënonte parinë duke e akuzuar për gabime të rënda që nuk faleshin. Meqë Voka është angazhuar shumë për ngritjen arsimore të popullit, ma ha mendja se dhe këtu ai e ka fjalën për mosinteresimin ndaj shkollimit të masës.

29. I parafytyronte fëmijët para xhelatit.

30. Si duket ai sheh njëfarë shpëtimi për

E tash, ato situata të këqija për faqe të zezë t'ia ngarkojmë asaj qeverie të mallkuar e të shkatrruar për jetë, të kapim një udhë të drejtë e një punë të vërtetë.

Se sot erdhi koha me ia dhënë krye për krye dhe me pleqnu. Se udha u çel për shpëtim të mëmëdheut, për gëzimin dhe përparimin e popullit të varfër të punojmë, të mos rrijmë kot. Asnjë minut të mos e humbim por të përpiqemi seriozisht se Zoti me rahmet të vet na ka bërë një të mirë të madhe. Atë shpresë të pastër e të madhe që e lypnim me mallë të flakt e me zemër të djegur, mushkëri të përgjakur e faqe të përplotur, na e plotësoi. Si e kam lexuar, këtu e dhjet vjet më parë, në një vjershë të një shqiptark, gjegat dhe dëshirat për mëmëdhe e për kombin që i kishte, kështu i kallzonte shkruante dhe thonte:

Vëjersh

Një natë ndeja në kopshtë të artë
Cili ishte fije artë
.....
Edhe gjithësia ranun në gjumë
Degë e gjeth nuk lëviste
Veç një zog ja thërriste
Këndim të bukur fort
Pri mallëngjimit mu çuen lot
Zog i shkretë tue kënduar
Unë ma tepër tue menduar

kombin shqiptar në qeverinë e Turqve të Ri dhe i thërret të kapi të mbarën.

Mendja vot e fluturoj
Posi shkëndija me vrap shkoj
Ke mamdheu ke Shqipërija
Ke ka vendin trimrija
Thash Zot o Zot i gjithsijs
Fali lirinë edhe Shqiprijs
S't'vjen keq o Perendi
Se ka xhem e bijra e bi.³¹

Vëllazër të dashur e të nderuar, këto dhimbje, këto hidhërim e këto rënkime të tëra kështu, në këtë formë, kapërcyen. Sot populli e fitoi udhën e lirinë. Sot iu liruan këmbët – edhe duart iu zgjidhën dhe po mundohet të marrë të mbarën të dalë nga fatkeqsitë që pat ra³², të mëkambet dhe ta shpëtojë qeverinë nga rreziqet që e kanë rrethu³³. Zoti i ndihmoft që forcën e parë që e pat në vend t'ia kthejë e t'ia sjellë lehtë e mbarë ia bëft.

Tani, edhe na veçanrisht duhet të mësojmë edhe për mëmëdhenë edhe për mbretërijnë. Ashtu si

31. Për autorin e kësaj vjershe nuk dihet më tepër se sa na jep vetë Rexhep Voka. Ai është Kamber efendi Elbasani. Edhe ai si duket nuk gjen mbështetje tjetër veçse te Perëndia, që është qëndrim karakteristik me atë të Vokës edhe pse jo i arsyeshëm. Atij më së shumti i dhimbset rinia, pikërisht për atë ndoshta edhe Voka e sjell këtë vjershë të tij.

32. Mundohet të dalë nga kriza.

33. Nuk është sa duhet i qartë për çka mendon, por edhe nëse mendon për mbretërinë e Stambollit nuk e ka nga zemra. Për këtë më së miri na flet fundi i jetës së tij (shih Dituria 2-3/71-72, Prishtinë, ku flitet më gjerë për jetën e tij nga Islam Islami).

duhet të përpiqemi dhe gjith duhet të punojmë, të mendojm – se kjo kthesë e madhe që është bërë, është një rast³⁴ shumë i mirë për ne. Duhet ta dijme dhe të mos rrijmë kështu si të shembur e të ngrimë, mos e kalojmë kohën vetëm me fjalë si ndojnë palë robër që flasin e rrahin duart dhe nuk kuptojn se mos e bëft Zoti vjen një ditë rrahin kryet.

Pra ajo që na takon neve kurrë mos ta lejmë. Të kujtohem mirë, asnjë minut të mos vonohemi, por me të tëra forcat dhe prirjen që kemi popullit dhe qeverisë dorën t'ia japim, të formojmë një fuqi të madhe sepse fitimi e shpëtimi, gjallërimi dhe jeta unë e ti do të jemi³⁵.

Secili prej nesh në shpirtë të vete një të mirë për milet

Për atdhe e për shtet duhet ta ketë.

Nëse më pyet mua se cila është puna e parë që duhet të ndjekim e të punojmë, ashtu që një orë as një minut të mos vonojmë.

Shkollat t'i hapim edhe në mos paqim mundësi të ndërtojmë ndërtesa të mëdha, në koliba me kashtë fëmijë t'i tubojmë vetëm që të mësojnë.

Mos shikojmë vetëm nga qeveria, por edhe vetë të mundohemi, se një

qeveri e cila nuk ka mund të na bëjë çare deri sot, edhe këtu e tutje, bëhet që na len shkret e të shkojmë kot³⁶. Mos rrimë, mos rrimë, por i madh e i vogël të vrapojmë në shkollim e të mësojmë³⁷. Mos rrijmë kështu si të marrë, por tërë botës njerëzinë tonë t'ia tregojmë.

E dyta³⁸

Gjuhën tonë, bashkë me gjuhën turke, ta mësojmë se është një punë e mençur. Secili e din³⁹ se deri sa të mos mësojmë edhe në gjuhën tonë amëtare, kombit dije dhe edukim të përgjithshëm nuk mund t'i japim.

Nuk ka në histori asnjë shembull, e në jetë, që një popull është përparuar dhe është ngritur pa mësuar në gjuhën e vet.⁴⁰

Kjo punë do të bëhet sepse dijetarët e fesë dhe imamët të gjithë janë më një fjalë, kanë një mendim.

36. Bën apel, duke e nënçmuar ndihmën e qeverisë, që me forca të veta t'i përvishen mësimit e të ndriçojnë mendjen e vet.

37. Nuk bënte dallim në moshë kur ishte fjala për mësim.

38. Këtë titull e ka vënë në kllapa të mëdha. Këtu ma merr mendja se është fjala për një nëntitull e që duhet të jetë – E dyta, pasi e para ishte, në rend të parë, hapja e shkollave.

39. Gjuhës turke i jep rëndësi si gjuhë e huaj, është e dobishme të mësohet një gjuhë e huaj e për atë kohë turqishtja ishte gjuha më e rëndësishme për vendin e autorit.

40. Mirëpo shqipja ishte primare, sepse historia nuk njih ndonjë popull që ka përparuar pa pasur gjuhën e vet. Në këtë frymë Voka përpiqet t'i edukojë bashkëkombësit e vet.

34. Është një rast, moment i volitshëm. Shans ideal.

35. I bën me dije bashkatdhetarët e vet se kurrkush nuk mund të jetë më i afërm se sa ata në mes veti, sipas asaj: “I imi je i yti jam, ç'më bën s'ke e ç'të bëj nuk kam.”

Asnjë nuk është ndarë, të gjithë kanë thënë se çdo komb mundet të kultivojë fenë në gjuhë të vet.

Për të gjithë dijetarët lusim e madhërojmë Zotin xhel-le shanuhu, që të jenë të shpëtuar dhe të ndihmuar. U falënderoj dhe i lus, njëmend, që këto mendime që i kam shkruar t'i pleqnojmë mirë e hollë, e pastaj nëse i shohin si mendime të mira e të drejta le t'ia dëftojnë kombit⁴¹. Le të bashkohen sikur një dhe të punojnë për t'i dhënë kombit dije, edukim⁴² e arsimim.

Prej nesh kërkohet që shumë të kujtohem dhe ta dijim e ta kemi shumë të qartë se për këtë komb do të përgjigjemi, do të vij një ditë që do të pyetemi.⁴³

Ta heqim më njëherë nga zemra djallëzinë dhe të kapim mirësinë e mbarsinë. Të mos thomi se ky është mysliman e ky tjetri i krishterë, jo toskë e jo gegë, se të gjithë që jemi farë shqiptari jemi një fis e një farë.⁴⁴

41. Ai qëndrimet e veta ua lë dashmirëve të kombit, nëse ata i shohin të arsyeshme e të dobishme, le t'ia mësojnë kombit.

42. Janë dy sinonime. Edukatë, mirësjellje.

43. Sigurisht mendon në parinë, dijetarët dhe ua përkujton se janë përgjegjës për masën e gjerë. Ndoshta aludon edhe në përgjegjësinë pas vdekjes, që është shumë efektive disa herë, kuptohet te një shtresë e caktuar njerëzish.

44. Kjo përçarje përherë i ka kushtuar shumë shtrenjtë popullit shqiptar dhe ka shkruar në

Duhet të mirremi vesh, të shikojmë ku e kemi ndonjë rrugë të çelur të kërkujmë rrugëdalje dhe të gjejmë mënyrën se se e ku do të mblihdemi, sepse jetën më një vend e kemi.

Përndryshe humbasim, emri shqiptarë shuhet, madje shqiptari, në sy të popujve të tjerë turpërohet për jetë. Prandaj kërkohet prej nesh të bashkohemi për një mend. Askush prej nesh anash të mos mbesë, sepse kemi një besë dhe na mban një shpresë.⁴⁵

Armiqsinë e mallkuar e të shkretë

Për gjithmonë ta përcjellim ndërmjet

Vëllazërimin e bekuar e të vërtetë

Ta sjellim në mes nesh për jetë

Atëherë fuqia na shtohet e shkon - përpjetë

Edhe ndihma e Zotit me ne bëhet dhe do të jetë.⁴⁶

dobi të armikut. Për ta theksuar mu këtu ndoshta ka ndikuar edhe mospajtimi që lindi në Kongresin e Manastirit lidhur me unifikimin e alfabetit të gjuhës shqipe.

45. E vetmja dëshirë e tij ishte t'i shohë shqiptarët të bashkuar më një, sepse kishin një interes të përbashkët.

46. Ai e përfundon veprën e vet "Mendime", duke i thirrur që të gjithë të jenë singërisht të bashkuar me shpresë se edhe Zoti atëherë do t'u ndihmojë. Edhe ai do jetë me ta.

Analizë e veprës së H. Ali Krajës, “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”

**Xhorxhina Seferi
Kolegji Universitar “Bedër”**

Abstrakt

Hafiz Ali Kraja njihet si një nga personalitetet e shquara të botës shqiptare. Ai ishte mjaft i ditur dhe kishte një formim jo vetëm teologjik, por edhe si intelektual erudit. Kontribuoi në predikimin e fesë në raport me nevojat dhe problematikat e kohës. Ndihmoi në përhapjen e diturisë, në mbrojtjen e atdheut e në interes të çështjes kombëtare. Oratoria dhe atdhedashuria që ai kishte, bëri që fjalimet e tij të kishin mjaft ndikim në popull. Hafiz Ali Kraja i ka dhënë shumë rëndësi bashkimit kombëtar, duke shpjeguar se feja nuk është pengesë për unitetin kombëtar. Ai thekson se njeriu ka nevojë për fe në pikëpamjen shpirtërore, morale, juridike e shoqërore. Hafizi i ka dhënë një rëndësi mjaft të madhe moralit, duke thënë se baza e moralit duhet të jetë feja. Rëndësi të veçantë i ka dhënë edhe shpjegimit të Islamit në raport me fanatizmin, ateizmin dhe laicizmin. Gjithashtu ka shkruar për qytetërimin e vjetër, i cili nuk mund të ndahet prej fesë dhe ka trajtuar problematikat e botës pas luftës së përgjithshme. Çështjet e trajtuara i shpjegon me versete nga Kur’ani Famëlartë dhe hadithe të Profetit Muhamed a.s.



H. Ali Kraja, foto Marubi, 1929

Hafiz Ali Kraja (1900-1973)

Hafiz Ali Kraja lindi në Shkodër në vitin 1900. Ai është ndër personalitetet më të rëndësishëm që ka nxjerrë bota shqiptare në shekullin XX. Edukimin fillestar dhe shkollën e mesme i përfundoi në Shkodër, ndërsa studimet universitare i kreu në Kajro, në universitetin El-Ez'her, një nga qendrat universitare më të njohura të botës. Falë natyrës së tij kërkuese dhe kushteve që i ofroi mjedisi në të cilin përfundoi studimet e larta, arriti të formohej jo vetëm si prijës fetar e teolog, por edhe si intelektual erudit. Pas diplomimit në shkencat islame në vitin 1924, ai u kthye në atdhe për të kontribuar në predikimin e fesë islame.

Ai i bëri një shërbim të çmuar atdheut, duke bërë thirrje për unitet kombëtar, duke u përpjekur për zgjimin dhe forcimin e ndërgjegjes kombëtare, si dhe për përhapjen e diturisë në masat e popullit. Thirrjet për unitet kombëtar, krahas oratorisë dhe atdhedashurisë, vihen re edhe në fjalimin e mbajtur në varrimin e poetit At Gjergj Fishta: “Vepra jote, o poet, ka për të formue një faqe të shkëlqyeshme në historinë politike të kombit! Te jesh i bindun, o poet i madh, se shqiptari me ‘Lahutën e Malcisë’ ka për të qenë gjithmonë kryenaltë, siç janë grekët me ‘Iliadën’ dhe persianët me ‘Shahnamenë’... Sot djelmnia intelektuale me Lahutën Tande në dorë të nep besën shqiptare, tue t’u betue se idealin tand te naltë, që shprehe për kombësinë shqiptare do ta ruajë e do ta mbajë si gjatë të shenjtë morale.”

Pavarësisht propozimeve që pati nga personalitete të njohura të prijësve myslimanë, ai kryesisht shërbeu në qytetin e tij të lindjes. Më shumë se një e katërtën e jetës e kaloi nëpër burgje, për arsye të qëndrimit të tij antizogist, angazhimit kundër ideologjisë marksiste dhe qëndrimit të tij antikomunist. Hafiz Ali Kraja është dekoruar nga Këshilli Bashkiak- Shkodër; “Krenaria e Qytetit”.¹

1. “100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame”, Botimet KMSH, Botimi 3, Tiranë, 2015, f. 28-29.

1. Vepra “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”

Për të ndriçuar sadopak historinë e lëvizjeve të mëdha kombëtare për liri, për arsimim dhe me aspiratën e ndërtimit të identitetit kombëtar, një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe rilindësit e mëdhenj shqiptarë. Në shumë raste ata ishin prijës myslimanë, ku në rrethana shpeshherë mjaft të vështira, punuan për krijimin dhe ngritjen e shtetit shqiptar. Ata gjithashtu kontribuuan në konsolidimin e këtij shteti, duke dhënë një ndihmesë të çmuar në formësimin e vetëdijes kombëtare dhe fetare të popullit tonë. Për të arritur bashkëpunimin ndërmjet fesë dhe kombit një rol mjaft të rëndësishëm kanë luajtur personalitetet shqiptare të kulturës islame. Një ndër këto figura, për të cilin mund të themi se përbën një “pasuri kombëtare”, është Hafiz Ali Kraja me librin “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”.

Kjo vepër u botua për herë të parë në vitin 1934, për të njohur më pas disa botime, si në Kosovë, Maqedoni dhe SHBA. Ajo që e shtyu autorin për të shkruar këtë vepër ishin mendimet e disa intelektualëve shumë të formuar, por skeptikë për rolin që religjionet kishin luajtur në historinë e civilizimit botëror dhe, në rastin konkret, në Shqipëri. Mendime të tilla aludonin dhe akuzonin fenë si një faktor që, midis të tjerave, pengonte bashkimin dhe unitetin kombëtar. Kjo akuzë gjente interpretim në çdo tekst

të historiografisë zyrtare edhe në vitet e diktaturës komuniste. Por, kjo akuzë hidhet poshtë nga autori, i cili, me këtë vepër, pa frikë, mund të thuhet se është një nga themeluesit e mendimit sociologjik shqiptar.²

Temat e trajtuara nga Hafiz Ali Kraja

a. Nevoja për fe në pikëpamje shpirtërore, morale, juridike e shoqërore

Në çdo periudhë të historisë njerëzit kanë qenë të ushqyer nga ndjenjat fetare. “Filozofët e shpjegojnë nevojën e besimit për shpirtin e njeriut me këto fjalë: Shpirti është një rruzullim i padukshëm. Kurse ky rruzullim, të cilin e shohin sytë tanë, është i dobët dhe në një pjesë të këtij rruzullimi hyn edhe trupi ynë.”³ Hafiz Ali Kraja e shpjegon këtë duke krahasuar gjendjen e shpirtit në trup me gjendjen e zogut në kafaz. Ashtu siç është kafazi një banesë e mërzitshme dhe zogu kërkon të largohet sa më parë nga ai, ashtu edhe ky rruzullim material, nga i cili shpirti ynë rënkton për t’u larguar dhe kërkon të lartësohet në lumturinë e amshueshme, paraqet një banesë të mërzitshme. Mjeti me anë të të cilit shpirti arrin lartësimin dhe qetësinë e

2. Po aty, f. 30.

3. Kraja, Ali, “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”, Botimet KMSH, Tiranë, 2010, f. 11.

vërtetë është pikërisht besimi. Nëse njeriu e zhvesh shpirtin për disa çaste nga mburoja e trupit, do arrijë ta kuptojë mjaft mirë atë që shpirti ka nevojë, pra besimin.

Për sa i përket nevojës për fe, në pikëpamjen morale, Hafizi fillimisht tregon se shoqëria është një bashkësi njerëzish me interesa të përbashkëta dhe shtylla e kësaj bashkësie është ligji i moralit. Ky ligj i moralit, të cilit shoqëria duhet t'i nënshtrohet, është pikërisht besimi, i cili siguron stabilitet e harmoni. Ai hedh poshtë mendimet e atyre që pretendojnë se shoqëria mund të përparojë dhe të zhvillojë një jetë të harmonishme edhe pa besim, duke shpjeguar këto tri fuqi (ndërgjegjja, natyra dhe shoqëria), të cilat e dënojnë ose e shpërblejnë njeriun kur vepron në bazë të ligjeve të moralit, ose kur i kundërshton ato. Për të qenë ndërgjegjja një argument i fortë është e domosdoshme të qëndrojnë nën ndikimin e besimit. Gëzimi ose pendesa që ndjen njeriu janë pasojë e ligjit të moralit. Për sa i përket natyrës, që është argumenti i dytë i ligjeve të moralit, është e vërtetë që nuk i lë pa dënuar veprat që bien ndesh me të, por, sërish, nuk mund të sjellë dobi i vetëm si argument, sepse natyra qëndron indiferente kundër atyre që i dënojnë ligjet e saj të moralit. Për argumentin e tretë të ligjit të moralit, që është shoqëria, mund të thuhet se as kjo e fundit nuk e jep dënimin ose shpërblimin e merituar, sepse ligjet e shoqërisë dënojnë vetëm fajet

e dukshme. Ligjet morale nuk zënë vendin e duhur në mendimin botëror, për arsye se mendimi botëror mund të gënjejë dhe automatikisht nuk mund të jetë një shtyllë për qëndrueshmërinë e moralit. Duke parë këto arrihet në përfundimin se feja është mjeti më i fuqishëm për harmoninë e shoqërisë dhe zbatimin e saj të ligjeve morale.

Shkurtimisht, Hafiz Ali Kraja shpjegon që besimi është nevojë për shoqërinë njerëzore, sepse është ai që e siguron rregullin, harmoninë dhe është i vetmi faktor për shpëtimin e saj. Besimi është burim i lumturisë dhe i shpresës që ia bën të këndshme jetën njeriut. Në një mjedis afetar nuk mund të sigurohet në asnjë mënyrë një harmoni shoqërore, sepse individit afetar është njeri i epsheve, jeta e tij nuk udhëhiqet nga modestia në të cilën mbështetet qëndresa e shoqërisë dhe lavdërimi i afetarëve me njohjen e ligjeve të natyrës thjesht e përforcon më shumë faktin se këta individë bëhen mjerim edhe për veten, edhe për shoqërinë ku jetojnë.

b. Çka është Islami

“Ajo dituri, pa kurrfarë lajthitje, ato urdhra e porosi të pakundërshtueshme, të cilat më i madhi i gjithë njerëzisë që mban mend historia, i dalluari ndër të gjithë pejgamberët, Muhamedi (a.s.), që e mësoi dhe vuri në praktikë, përmbledhet në fjalën Islam.”⁴ Hafiz

4. Po aty, f. 23.

Ali Kraja shpjegon se besimet qiellore të vërteta kanë mbetur të njëjta në thelb përpos ndryshimeve në detaje, të cilat janë fryt i ndryshimeve kohore. Ajo që bëri Muhamedi (a.s.) ishte ringjallja dhe tërheqja drejt origjinalitetit të humbur, besimit, që e kishin praktikuar profetët para tij. Zoti e përmend këtë në Kur'an duke thënë: “Ai ka urdhëruar për ju atë Fe, të cilën ta zbuloi ty (o Muhamed) dhe që pati urdhëruar për Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain, duke thënë: ‘Qëndroni në fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!’.”⁵

Besimi islam është besim i amshueshëm. Ai nuk humbi asnjëherë, por, ashtu si shkencat që e humbin vlerën nga padituria e njerëzve, ashtu edhe besimi islam e humbi vlerën e tij. Ka edhe nga ata që e mohojnë pejgamberinë e Muhamedit (a.s.), duke pretenduar se ai ishte një gjeni që e shpiku këtë besim, por ajo që ai bëri ishte kumtimi dhe e fuqizoi këtë besim me të gjitha detajet, me të vetmin qëllim që njerëzimi të ketë dobi prej tij.

c. Islami dhe fanatizmi

Fjala “Islam” në fjalor mbart kuptimin e bindjes, bindje ndaj një të vërtete, në Hyjni.⁶ Pra, çdo mysliman duhet të pranojë vetëm ato gjëra që janë të vërteta para Zotit. Ai që

5. Kur’ani, Shura, 42/13.

6. Kraja, Ali, “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”, f. 27.

i është bindur Zotit i gjykon gjërat dhe u jep atyre vlerë vetëm sipas këndvështrimit hyjnor. Një njeri i tillë quhet njeri me ndërgjegje të formuar dhe që adhuron të vërtetën (Zotin). Hafizi shpjegon duke u bazuar në ajete kur’anore se fanatizmi nuk pajtohet me Islamin. Disa nga ajetet që e tregojnë këtë: “O ithtarët e Librit! Përse e pështjelloni të vërtetën me të pavërtetën dhe përse e fshihni të vërtetën me qëllim?”⁷, “Thuaj: ‘O ithtarët e Librit! Mos i shkëlmi kufijtë e së vërtetës në besimin tuaj...’”⁸ Pra, Kur’ani na tregon që duhet të jemi këmbëngulës vetëm në të drejtën dhe të vërtetën, sepse feja islame të mirën e gjen vetëm në njohjen dhe adhurimin e së drejtës.

d. Islami dhe ateizmi

Besimi në një Zot të vetëm është shtylla e parë e besimit islam. Gjithësia dhe çdo qenie e gjallë, që gjendet në të, ka një Krijues të vetëm, i Cili është larg çdo cilësie të mangët dhe nuk ka shëmbëlltyrë. Nga ana tjetër, janë edhe disa kundërshtime të parashtruara nga mohuesit, të cilave Hafiz Ali Kraja i jep përgjigje në mënyrë bindëse dhe në formën më të bukur, duke përdorur argumente shkencore dhe logjikën e thjeshtë. Fillimisht na tregon këtë ajet kur’anor, në të cilin thuhet: “Ata thonë: ‘Nuk ka tjetër veç

7. Kur’ani, Al ‘Imran, 3/71.

8. Kur’ani, Ma’ide, 5/77.

jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron'. Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, ata vetëm hamendësojnë ashtu.”⁹ Mohuesit e një krijuesi të vetëm çdo të qenë e gjykojnë për mosqenie dhe kjo për faktin se nuk i shohin argumentet e së vërtetës. Këta janë ai grup njerëzish, që nuk ia kanë ndjerë as aromën diturisë, nuk kanë një zemër të thjeshtë dhe, për rrjedhojë, as rrezet e diturisë nuk kanë depërtuar në zemrat e tyre. Ka disa zemra që arrijnë të zbulojnë një ligj të madh, por ka edhe nga ato që notojnë nëpër fushat e eksperiencës dhe nuk arrijnë të marrin mësim.

Hafizi tregon se dyshimi dhe mohimi shfaqen tek ata njerëz që zemrat i kanë të prishura dhe organet e të kuptuarit të shkatërruara, sepse nuk mund të bëhen të qarta gjërat të cilat shihen me syze me xham të thyer. Nëse do ta shihnim njeriun në pikëpamje mekanike dhe fizike brenda këtij rruzullimi do dukej si një insekt, ose si një mikrob në përpjesëtim me lëmshin e dheut. Por kur vetë mohuesit shtrojnë tezën se mbi njeriun nuk ekziston një Krijues, ata bien në kundërshtim me vetveten, sepse, sipas tyre, njeriu që duket si një thërmijë në raport me rruzullin i bie të jetë një krijesë e fuqishme.

Njeriut, privilegjin për të qenë më i lartë se të gjitha krijesat ia mundëson prania e mendjes dhe

aftësia për të gjykuar. Gjërat të cilave mohuesit ua japin emrin lëvizje mekanike dhe fizike janë vetëm dhuntitë e vetëdijes dhe arsyes. Vetëdija e çdo njeriu është e fshehur dhe nuk mund të kuptohet nga të tjerët. Pra, njeriu ka ndjenja, vetëdije dhe shpirt e më pas, nëpërmjet fuqisë së kësaj vetëdijeje, shfaqet i gjithë mekanizmi dhe jeta trupore. Njeriu është një kompozim i përbërë nga shpirti e trupi dhe është vetëm një krijesë, sepse më parë nuk ka ekzistuar. Pra, njeriu e ka një Krijues, i Cili ka pushtet të bashkojë trupin dhe shpirtin e prej tyre të formojë njeriun. Zoti është fillim i të gjitha cilësive njerëzore dhe është fillimi i të gjitha fuqive.

Hafizi thotë se nga asgjëja nuk del asgjë, ose e thënë ndryshe, asgjëja nuk mund të jetë motiv për qenien. Edhe kuptimi shkencor i ligjit të evolucionit nuk është që ta konsiderojmë atë fillimin absolut, por, në botën e kafshëve, është ligj proporcional i Hyjnisë. Revolucioni francez hutoi njerëzit, sepse hodhi një ide të zmbropsjes së njeriut në periudhat primitive të filozofisë, sipas të cilit, njeriu ishte imagjinuar si një makinë trupore. Por, Monteskieu u ishte përgjigjur duke u thënë se, një fuqi e verbër nuk mund t'i ketë krijuar këta njerëz që dinë të arsyetojnë. Ata nuk kishin arritur ta njihnin fuqinë e mendjes dhe ta ndanin objektin nga subjekti.

9. Kur'ani, Xhathije, 45/24.

Në përfundim, Hafiz Ali Kraja thotë se nëse njeriu nuk njeh mendjen dhe ndërgjegjen nuk duhet të ngrihet e ta kërkojë Krijuesin përmes teleskopëve. Qielli është krijuar për ne për ta njohur Krijuesin dhe, për ta arritur këtë, duhet të kemi një zemër dhe kujdes mbi veprat e krijuara nga Ai. Bukuria hyjnore kuptohet në këtë botë, por shihet në jetën tjetër.

e. Feja dhe morali

Baza e moralit duhet të jetë feja, sepse besimi është themeli dhe shtylla e rregullimit të njerëzimit. Disiplina është ajo që kufizon veprat e këqija e i mban ato nën kontroll dhe kjo disiplinë është feja. Feja është më e fortë se të gjitha ligjet dhe rregulloret, sepse burimi i saj është i lartë. Disiplina fetare nuk ndahet asnjëherë nga njeriu dhe e mban këtë të fundit gjithmonë nën kontroll. Meqenëse njeriu nga natyra është narcizist asnjë rregullore apo ligj nuk mund ta mbrojë atë më shumë se feja. Feja e bën njeriun që të jetojë me vetëdijen e ihsanit (kudo që ndodhet Allahu e sheh njeriun, çdo moment, edhe pse njeriu nuk e sheh dot).

Hafiz Ali Kraja thotë se morali është i nevojshëm për çdo shoqëri dhe si rrjedhojë vërtetohet edhe nevoja për fe. Gjithashtu shton se ka edhe nga ata njerëz që pretendojnë se feja nuk është e nevojshme dhe themelet e moralit ia ngarkojnë ndërgjegjes. Por, këtë e hedh poshtë duke thënë se ndërgjegjia

ka nevojë për një prijës të ndritshëm që të mund të jetë e fuqishme. “Ky prijës i ndërgjegjes mund të jetë vetëm Feja dhe se një moral i ndërtuar vetëm mbi ndërgjegje personale, pa pasur si prijës Fenë, nuk mund ta ketë vulënpërulëse.”¹⁰

f. Islami dhe bashkimi kombëtar

Disa intelektualë i sulmojnë besimet fetare në Shqipëri me pretendimin se nuk mund të formohet një unitet kombëtar, për shkak se anëtarët e besimeve të ndryshme janë kundërshtarë me njëri-tjetrin. Hafiz Ali Kraja e kundërshton duke thënë se kjo nuk pajtohet me besimin islam. Ky ajet kur’anor është vërtetues se Islami nuk i njeh kundërshtarë ndjekësit e Krishtit, “...miqtë më të afërt të tyre janë ata që thonë: “Ne jemi të krishterë”...”¹¹ Pra, në pikëpamjen e dashurisë dhe dhembshurisë, të krishterët i njohim më afër. Kjo vihet re në dëshpërimin që shkaktoi te Profeti (a.s.) dhe te shokët e tij disfata e bizantinëve të krishterë ndaj persëve.

Një tjetër tregues është edhe fakti se në pallatet e mbretërve myslimanë jetonin të lumtur dhe ishin gjithmonë të mirëpritur dijetarët e krishterë, sidomos në periudhën e dinastisë së Abasidëve. Sipas H. Ali Krajës, një dijetar amerikan në librin e tij “History of the Conflicts”, ka thënë: “Këta

10. Kraja, Ali, “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”, f. 46.

11. Kur’ani, Ma’ide, 5/82.

lloj dijetarësh, që punonin në oborrin mbretëror të Abasidëve në Bagdad, jo vetëm që nuk u merrej parasysh vendlindja, kombësia dhe besimi, por, përkundrazi, si shpërblim për dituritë që posedonin, emëroheshin edhe në shkallë të larta shtetërore dhe me dhuratat që u jepeshin siguronin jetën e tyre.”¹² Duke treguar këta shembuj Hafizi argumenton qartë atë të vërtetë që është në themelet e parimeve të Islamit, pra që myslimanët, jo vetëm që nuk i shohin si kundërshtarë anëtarët e besimeve të tjera, por duke qenë së bashku, ruajnë dashurinë kombëtare dhe çojnë një jetë të lumtur.

g. Drejtimi i botës së qytetëruar pas luftës sëpërgjithshme (botërore)

Hafiz Ali Kraja bën një analizë të përmbledhur të gjendjeve që ka kaluar bota, duke treguar edhe rëndësinë që i është dhënë shpirtërores. Ai thotë se bota është larguar nga qetësia dhe gjendja e saj është ashtu si barka që e ka zënë furtuna e detit. Para luftës së përgjithshme (botërore) bota kishte arritur një qetësi të dukshme por, kur popujt filluan të bëjnë konkurrencë ndërmjet tyre në jetën e tyre filloi të sundojë vetëm materialja. Në këtë periudhë feja konsiderohej si pengesë për zhvillimin dhe përparimin njerëzor, por, sërish, edhe në ato kushte, u arrit që të ruhej një baraspeshë e përgjithshme.

12. Kraja, Ali, “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”, f. 50.

Me fillimin e luftës së botërore gjendja u përkeqësua, duke sjellë kriza ekonomike, shumë humbje jetësh dhe çrregullime, aq sa rrezikuan zhdukjen e shpirtit të qytetërimit. Hafizi thotë se Gustav Le Bon, kur ka folur për këtë temë, ka shpjeguar se kjo gjendje tërhoqi vëmendjen e udhëheqësve të botës dhe të mendimtarëve, duke bërë që këta të fundit të arrijnë në përfundimin se shpëtimi i vërtetë bëhet vetëm me anë të rikthimit kah ndjenjat fetare e shpirtërore. Tregon se fashistët fillimisht u përpoqën për zgjimin e çështjeve shpirtërore. Në Angli, gjithashtu, më 1924 u mbledh një kongres fetar, i cili pati një rëndësi të madhe dhe ndaj të cilit zgjoi interes e gjithë bota. Hafizi thotë se nga të gjitha këto arrijmë në përfundimin se, bota e qytetëruar e ka kuptuar që nga çrregullimet mund të shpëtohet vetëm me ringjalljen e ndjenjave shpirtërore dhe të besimit.

h. Qytetërimi i vjetër nuk ndahet prej fesë

Hafiz Ali Kraja vëren: “Qytetërimi (civilizimi) është i themeluar mbi një grumbull të drejtash e detyrash të ndërsjella dhe çdo formulim i tij, që përbëhet nga parimet kryesore, është si një gur themeltar mbi të cilin është ndërtuar dogma e ndërtesës së qytetërimit. Por, në rast se prishet një nga ato parime, natyrisht baraspesha e qytetërimit tronditet dhe ai qytetërim nuk mund të qëndrojë edhe shumë kohë.”¹³

13. Po aty, f. 57.

Revolucionet përgjatë shekujve e kanë burimin në tronditjen e ndërtesës besimore e morale, por këtë kuptim filozofët ua atribuojnë revolucioneve. Qytetërimi përfitohet, mbahet dhe ruhet prej një fuqie besimtare, pra është një përmbledhje besimesh. Hafizi thekson se nuk është kundër zhvillimeve teknologjike e shkencore, por këto përparime shkencore nuk mjaftojnë për plotësimin e ndërtesës së civilizimit. Këto zhvillime duhet të shkojnë paralel me parimet morale dhe me kuptimet dogmatike. Kjo na bën të mendojmë se shkaqet e rënies së të një qytetërimi duhen kërkuar në lëkundjet dogmatike. Hafizi kishte një horizont të gjerë dhe një formim mjaft të mirë. Këtë e tregon edhe kur thotë se këto janë fryt i ngjarjeve historike dhe dëshmi e filozofëve me famë botërore, jo mendime fetare të një hoxhe.

i. Islami dhe laicizmi

Në lidhje me këtë temë, Hafizi ka shpjeguar vlerën shkencore e logjike të shkaqeve që laikët kanë shprehur për nevojën e një edukimi laik. Laikët synonjë që edukata e të rinjve të jetë e mbështetur mbi parimet laike, duke u bazuar në këto shkaqe:

1. “Në pikëpamje politike ekziston një kundërshtim i madh midis evolucionit kombëtar dhe fesë. Feja në qenien e vet shëmbëllen një administrim autokrat, kurse Shqipëria është shtet i lirë.”

Hafizi e komenton këtë duke thënë se feja ka në themel detyrimin, pra të marrësh mbi vete përgjegjësi ndaj të drejtës së përgjithshme dhe private. Në rastin kur nuk merret përgjegjësi ndaj çdo të drejte nuk mund të themelohet liria e së drejtës. E drejta duhet studiuar vetëm në pikëpamjen e lirisë dhe jo të detyrës, sepse në detyrë nuk ka liri. Ata që nuk duan ta njohin ndjenjën e detyrës nuk duhet të pretendojnë për lirinë e së drejtës. Kombi tregon për ndihmën vëllazërore, themel i së cilës është të kryerit me drejtësi të detyrës së marrë mbi vete. Meqenëse feja e shëmbëllen këtë detyrim nuk është kundër evolucionit, por shpirti i tij.

2. “Në mes fesë dhe njërit prej parimeve të shoqërive shekulariste – lirisë së ndërgjegjes, ekzistojnë kundërshtime të mëdha, kështu që asnjë drejtim fetar, pa humbur vetveten, nuk mund ta pranojë atë parim.”

Hafizi shpjegon se çdo mjedis shoqëror pasqyron ndërgjegjen e asaj shoqërie dhe feja nuk mund të mendohet se ekziston pa liri të ndërgjegjes. Sheriati i myslimanëve ishte ai që ia bëri botës të njohur lirinë e ndërgjegjes, duke e bërë pjesë të besimit pranimin e pejgamberëve të tjerë dhe duke treguar përmbledhjen e të gjitha besimeve dhe ndërgjegjeve. Që një shoqëri të veprojë sipas parimeve të ndërgjegjes duhet që, fillimisht, të jetë poseduese e një ndërgjegjeje të plotë.

3. “Parimet fetare kurrë nuk mund të bashkohen me ato parime mbi të cilat është mbështetur demokracia jonë.”

Sipas botëkuptimit të Hafiz Ali Krajës kjo konsiderohet injorancë, sepse në praninë hyjnore nuk ka ndarje mes demokratit dhe aristokratit. Kjo tregon barazinë e njerëzve në rrugën e drejtësisë dhe më pas na urdhëron të ecim në këtë rrugë duke çmuar të drejtën e çdokujt. Kjo rrugë e drejtë, që fillon me barazinë e përgjithshme, në hadith përshkruhet si shembulli i dhëmbëve të një krehri, që është i njëjtë edhe me ajetin Kur’anor: “Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.”¹⁴, pra, përcaktohet aristokracia morale, ndërsa ajo intelektuale shpjegohet në këtë ajet: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?!”¹⁵.

4. “Ligji fetar është: t’i besosh asaj çka komunikuar feja, nuk pranon dyshime e kontestime.”

Hafiz Ali Kraja e shpjegon në mënyrë të përmbledhur këtë pretendim të laikëve, duke thënë se si dituria, ashtu edhe feja kanë si qëllim t’i shpëtojnë njerëzit nga dyshimet, duke i orientuar kah e drejta, lumturia dhe realiteti. Që të dyja thonë realitet, por ndryshimi qëndron në faktin se ajo që thotë feja konsiderohet si punë e mirë. Allahu thotë në Kur’an: “Thirr (fto) në rrugën e Zotit tënd

me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë! Me të vërtetë, Zoti yt i di më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij, e i di më së miri ata, që janë në rrugë të drejtë”¹⁶. Popullin intelektual binde me arsytetime kategorike, kurse masës mbushja mendjen me predikime, këshilla dhe me shembuj të dobishëm; inatçinjve kur qëndrojnë në mendimin e vet, parashtroju çështjen me butësi e me arsytetime bindëse. Me këtë shihet se feja islame është gjithmonë e gatshme t’i pranojë polemikat që bëhen me qëllim të mirë. Sado që dyshimi me dijen nuk përkon e as dyshimi me besimin, nuk do të thotë se feja mbyll shtegun e polemikave¹⁷.

5. “Përparimi i shkencës ka shkaktuar dobësimin e feve, pra, as moralin nuk duhet t’ua besojmë atyre se kjo gjë është rrezik.”

Fillimisht mund të thuhet se asnjë faktor nuk mund ta zërë vendin e fesë dhe ta ruajë moralin më tepër se feja. Hafizi thotë se feja është një administrator që e prek njeriun deri në misterin më delikat dhe është një realitet që depërton deri në ndërgjegje. Duke qenë se (Meqenëse) feja i drejtohet njerëzve të ndershëm, shpirti i të pafeve lufton që të largohet prej ligjeve fetare, sepse dëshirojnë ta jetojnë këtë botë pa ndërgjegje.

16. Kur’ani, Nahl, 16/125.

17. Kraja, Ali, “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”, f. 68.

14. Kur’ani, Huxhurat, 49/13.

15. Kur’ani, Zumer, 39/9.

6. “Rregullat morale të caktuara tash sa mijë vjet nuk përkujnë me jetën e sotme shoqërore; pra qëllimi ynë është që në moral të zëvendësohen faktorët fetarë me faktorët njerëzorë.”¹⁸

Sekularistët e argumentojnë vjetërsinë fetare duke e parashtruar si arsye të mungesës së një morali fetar, apo ndonjë vlere të caktuar shkencore në këtë shekull. Por, Hafizi i kundërpërgjigjet me logjikë të thjeshtë, duke thënë se shumë ligje

ekzistente nuk i përshtaten nevojave të popullit dhe në vend të tyre mund të gjenin zbatim mjaft mirë disa ligje të vjetra. Gjithashtu thotë se morali fetar islam është një burim filozofik, i cili kurrë nuk do ta humbë vlerën e vet të diturisë. Laikët, duke dashur ta zëvendësojnë faktorin moral me faktorin njeri, mohojnë të gjitha sendet që kanë lidhje morale me shpirtin, duke harruar se bota në të cilën jetojmë nuk është vepër njerëzore. Ata harrojnë se morali ofron paqe, ndërsa faktorët njerëzorë janë në kundërshtim me njëri-tjetrin.

18. Po aty, f. 61-62.

Përfundim

Hafiz Ali Kraja me shkrimet e tij ka dhënë një kontribut të madh në kuptimin e mjaft temave aktuale. Me bindje të plotë mund të thuhet se Hafizi ishte një intelektual për t'u marrë shembull. Populli ynë ka shumë nevojë për njerëz si hafizi i nderuar me vlera e virtyte të larta dhe me një formim të gjithanshëm. Shpjegimet e bëra prej tij janë për t'u vlerësuar, sepse ndërthurin shkencën me fenë në mënyrë mjaft origjinale dhe të kuptueshme.

Duke i dhënë rëndësi të madhe fesë edhe atdheut, ai na bën të ndërgjegjësohemi dhe të kuptojmë se, si myslimanë, kemi një detyrë e cila peshon mbi supë dhe, për ta kryer në mënyrën më të mirë të mundshme, duhet të jemi të pajisur me dije të mjaftueshme. Ai na sqaron se shoqëria dhe mbarë njerëzimi mund të zhvillohet, si në aspektin moral, ashtu edhe në atë shkencor, vetëm nëse është e lidhur me moralin fetar. Në të njëjtën kohë, duke e vlerësuar Islamin si burim lumturie dhe motivim për zhvillim të mëtejshëm, ai na shtyn të mendojmë për kontributin që ne mund të japim në shoqërinë në të cilën jetojmë.

Bibliografia

“100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame”, Botimet KMSH, Botimi III-të, Tiranë (2015).

Kraja, H. Ali, “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”, Botimet KMSH, Tiranë (2010).

Prof. Nahi, Hasan, “Kurani i Madhërishtëm”, Institut i Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (2012).

Ligjërimi që u bë gurkyç i fetarisë

Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi*
Kolegji Universitar Bedër
Fakulteti i Shkencave Humane

Abstrakt


Ecuria e shoqërisë shqiptare nga periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe këtej është shoqëruar me pasurimin dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, që nga ana e vet i ka ndihur zhvillimit dhe përparimit të shoqërisë shqiptare në jo vetëm një aspekt. Mendimi kritik, i plotësuar nga metafizika hegeliane, i ndihmoi prijësit fetarë shqiptarë të përdornin ligjërimin e hollë libror, si stil, i cili në fillimet e veta u përdor nëpërmjet botimeve për të grishur mirëkuptimin kombëtar dhe i shoqëruar me butësi, për të cilën kishte aq fort nevojë. Ky lloj ligjërimi, që mbante gjallë shpresën dhe besimin për të ardhmen, duke iu qasur racionalitetit që pengon vendimet emocionale, grishi durimin e të gjithëve që punuan për vëllazërimin kombëtar, si një hap më tej në udhën e krijimit të ndërgjegjes kombëtare dhe në mbrojtjen e identitetit shqiptar. Filozofia e butësisë e durimit, fjalori gjegjës, fryma e ngjizur dhe konteksti i përdorimit të tij, flet për efikasitetin e stilit të komunikimit dhe nga ana tjetër, për begatimin shpirtëror të shqippfolësve, që arritën nëpërmjet tij të kompozonin ndërgjegjen kombëtare dhe jo pak ndikime të tjera prej këtij lloji komunikimi gjuhësor, i cili rezultoi shumë i suksesshëm. Ligjërimi i hollë libror u bë model dhe pasuroi edhe ligjërimin bisedor, duke arritur të dobësojë klaustrofobinë, që sëmurte masivisht te ne, duke i hapur udhë filoksenisë, si çelës për integritet e pritshme.

Hulumtimet e imta, përfaqset mes tyre dhe analizat e gjetjeve do të plotësohen mes modeleve që e dokumentojnë risinë, të cilin e sollli ligjërimi që iu bë krah formimit të qytetarit shqiptar dhe nga ana tjetër përsosi vetveten.

Të armatosur me këtë lloj mendësie dhe me ato mjete gjuhësore që dubeshin, ligjërimi i hollë libror iu bë krah emigrantëve shqiptarë edhe në vendet ku jetuan, duke u shërbyer edhe aty në dobi të çështjes kombëtare.

Fjalë kyçe: vëllazërim, predikonjës, mendësi, klaustrofobi, këshillues, filokseni, mirëkuptim

* Prof. Rahim Ombashi është dekan i Fakultetit të Shkencave Humane në Kolegjin Universitar Bedër.



Kristo Thanas, Imam Vehbi Ismaili, Fan Noli, Baba Rexhebi,
Anthony Athanas, Boston, 1959

Te llojet e ligjërimeve, të cilët përcaktohen nga rrethanat në të cilat realizohet kumtimi, si dhe nga qëllimi i tij, duket se *ligjërimi i bollë libror* ka një rol të veçantë në historinë tonë moderne. Meqenëse qëllimi diktohet nga nevoja, kuptohet se ai mjet i fuqishëm ka nxitur në njohjen dhe përvetësimin, më pas, të qëndrimit kritik të ndërthurur mes elementeve të filozofive Lindore dhe Perëndimore, i cili mbështetet te finesa e ligjërimit, që nga libror në fillimet e veta, fillon të bëhet pasuri edhe e komunikimit bisedor, të cilin e bën më shprehës dhe më kuptimplotë, duke ndikuar në mirëkuptimin mes pjesëmarrësve. Ai hap pas hapi e pasuroi përmbajtjen e komunikimit, duke luajtur rol parësor në forcimin e sdrës kombëtare

dhe më pas të ndërgjegjes sonë kombëtare, si elemente që i ndihmën paqes humane, vëllazërimit kombëtar e më tej.

Ligjërimi i bollë libror është njohur, vlerësuar dhe përdorur qysh më herët prej njerëzve tanë të letrave, por në vitet '20 të shekullit XX, nisi të zinte vendin që i takonte, duke iu afuar kësaj formatimit të emërtimit brenda *ligjërimit human*. Organet e shtypit të Rilindjes Kombëtare, mbollën farën e këtij mendimi të shoqëruar me metafizikën hegeliane, që jetësonte ide dhe përvoja nga Lindja e Perëndimi, duke mbrojtur traditën e lashtë. Faik Konica në revistën e tij *Albania*, e vlerësuar si 'enciklopedia e Rilindjes sonë Kombëtare', grishte fillimin e punës për gjetjen e një alfabeti të përbashkët

për shqipfolësit, si dhe për hedhjen e themeleve të gjuhës standarde shqipe, si domosdoshmëri për ecjen e kombit në rrugën e duhur, duke u kujdesur për mbrojtjen e traditës. Fryma e mbjellë vijoi të forcohej me shpalljen e pavarësisë dhe veçmas pas viteve '20 të shekullit që lamë pas. Në shkrimet e kohës punohej intensivisht për zhvillimin e aftësisë në të formuarit e një mendimi real nëpërmjet mirëkuptimit, butësisë, tolerancës (durimit), siç thuhet te manualët e Burbaki-ve, apo vepra e Jean-Paul Sartre-it. Duke ngritur institucionet kulturore, shpirtërore, arsimore e shkencore, që i paraprinë krijimit të shtetit, ato jo vetëm ndihmuan në shpalljen e pavarësisë kombëtare, por u bënë edhe model i institucioneve të reja shtetërore. Në fjalën e tij në Kongres, kleriku dhe udhëheqësi shpirtëror hodhi idenë e krijimit të institucionit kombëtar të myslimanëve shqiptarë, që do të mbronin vëllazërimin mes tri besimeve, që praktikoheshin historikisht ndër ta. Shumica e prijësve fetarë morën pjesë në Kongresin e Manastirit, siç ndodhi dhe me nënshkrimin e aktit të pavarësimi. Zijimi i gjithçkaje, që ishte vetëm pasqyrim pa predikim, në jo pak botime, i binte ndesh punës që po bëhej ndërkohë në institucione, veçmas në publicistikën e kohës. Megjithatë, kjo ishte detyrë së pari e gazetarëve dinjitarë, vërtet pak asokohe, por që nuk dinin të jepeshin. Në vitin 1924, te shkrimi

Gazetarëve, Mithat Frashëri, që ishte shkrimtar dhe gazetar jo më pak se historian, veprimtar kombëtar, shtetar, përkthyes..., përcakton si të tillë:

“Çdo shkrimtar është një këshilltar; po gazetari është edhe më tepër akoma: një predikonjës, një njeri, fjalët e të cilit, të hedhura së sipri katedrës, mbeten e qëndrojnë. Edhe e shihni sa përgjegjësi ka ai që thotë ato fjalë.”

Dhe predikues (e vjetër - *predikonjës*) nuk mund të jetë një “njeri me hënë”, i vetëshpallur gazetar, që vetëm vepron pa u menduar e jo më pastaj të predikojë, pra të nxisë besim. Njëherazi ato botime janë fakte historike, që dëshmojnë për rolin që kanë luajtur në formimin e ndërgjegjes kombëtare, në forcimin dhe begatimin e shtetit të ri dhe, shumë më tepër se kaq, për vëllazërimin kombëtar, si parakusht i ngjizjes së ndërgjegjes kombëtare.

Që një ligjërim i tillë ka pasur ndikim të madh në jetën shoqërore, dallohet duke parë disa shembuj nga përfaqësues tipikë të kulturës dhe publicistikës shqiptare. Le të nisim nga fillimshkulli XX, nga Bostoni, Mass. i SHBA, ku doli gazeta e parë në shqip atje. Në numrin e fundit të *Kombit* ishte botuar një letër e Sotir Pecit, që i ftonte botuesit të ktheheshin në atdhe ‘për të punuar dobërisht’, ftesë e vendim që Fan

Noli nuk e miraton. I kthen përgjigje ish-drejtuesit të revista *Dielli* në shkurt 1909, pa emër autori. Le të sqarojmë se pse autori nuk i nënshkruan artikujt e vet dhe se si njofton emrat e tij letrarë. Një numër të madh shkrimesh të botuara atje, madje, nuk i nënshkruan, gjersa rishfaqet në prill 1909 me pseudonimin *Pesimisti*. Pas këtij pseudonimi vijon të mos nënshkruhen shumë shkrime të tjera, deri sa nënshkruan në një shkrim me pseudonimin *Diximus* dhe po vetëm në një rast tjetër pas tij rishfaqet pseudonimi *Hieronymus*. Fan Noli ka përdorur jo pak emra letrarë për arsye nga më të ndryshmet, por pseudonimi *Pesimisti* dëshmon realisht për problemet dhe vështirësitë e shumta, që po kalonte në Boston, të cilin e metaforizon si Athina e shqiptarëve, sepse ata që kishin mbërritur atje si emigrantë ekonomikë, kishin filluar të integroheshin. Kur boton artikuj, që as nuk i nënshkruan fare, flitet për rëndimin e gjendjes së tij shpirtërore dhe nevojën për identitet, e cila e afron me vendime e gjendje, që vetë do t'i qortoje me të madhe pas disa vjetësh qëndrimi në SHBA. Pas këtij shkrimi ai boton përsëri pa emër, kësaj here të revista *Dielli e Flamuri*, ku në datën 14 shtator 1911, boton artikullin *Kryengritje e përgjithshme në Shqipëri*, nga i cili citohet më poshtë një fragment:

“E kemi thënë që sa herë që një *kryengritje* e përgjithshme dhe e rregulluar mirë, i mbulon të gjitha

ballet dhe *mjerimet* tona. Këtë e presim me gojë hapur nga vera që vjen, po më parë *duben qërruar tradhëtorët*, të cilët kurdoherë janë pengimtarët më të këqij të zhvillimit kombëtar. Kur plasi për të parën herë kryengritja e bullgarëve të Maqedonisë, kapedanët e tyre s’bënin punë më të madhe, përveçse *helmonin* tradhëtorët. Me këtë mënyrë bullgarët arrijtën të shoqërojnë me veten e tyre gjithë fshatarët dhe të punojnë liruar gjithë qëllimet e tyre kombëtare. Për neve shqiptarët do të ish shumë më mirë po të vihej në udhë ky mendim praktik. Pse jo?” (Noli, 1987: 409)

Kjo lloj filozofie e dhunës, që duket nuk u la në Ballkanin inatçor, por u mor me vete deri në SHBA, gjalloi edhe më pas te vetëm disa individë si një lloj gjendjeje emocionale inatçore më shumë se mendësie vetjake, e cila mbolli përçarjen e besimtarëve ortodoksë shqiptarë, që kishin emigruar atje. Në kahun tjetër, qysh në vitin 1921, ortodoksi nga Korça, Ilo Mitkë Qafëzezi, ia nisi përkthimit të *Kur’anit*, nga i cili solli në shqip vetëm disa sure, duke dëshmuar se vëllazërimi mes besimeve jo vetëm nuk do të hepohej, por do të thellohej më tej:

“Muhamedanë dhe të Krështerë: Le të bëjmë nga librat fetare, çështje të kulluara kombëtare. S’është nevoja të de(A)bëtojmë ndjenja të shpirtit. Nga këjo nuk’ e gjen fare dem Shqipërin’ e sotshme. Vetëm fanatizmi fetar duhet

ndjekur edhe luftuar, gjer të shduket krejt nga zemrat e Shqipëtarëvevet *që e duan Shqipërin'* e Lirë ndë radhë qytetërimi. Tjetrazi, jemi të humbur...”

Toni i butë dhe grishja për vëllazërim mes dy besimeve kryesore fetare, nxjerr në pah nevojën për më tepër hapësirë për zemrën plot ndjenja që i arsyeton gjaku i njëjtë. Fjalët: *lexo, libra, mëmëdhe, kombëtar, shpirt, Shqipëtarëvevet, Shqipëri, zemër, Liri, qytetërim* po viheshin në themelet e ligjëritimit të ri që po bënte vend, duke u ardhur *në ndihmë përdornuesve të kësaj gjube dhe njëherazi duke formësuar veten cilësisht.*

Kësisoj grupimet e ngjizura pas Luftës së Dytë Botërore në Boston i binin ndesh grishjes për ‘vllaznim’ mes besimtarëve të një institucioni fetar dhe të asaj mes besimeve dhe degëve të tyre të ndryshme, të nisur nga binomi *Fe-Atdhe*, i cili mbizotëroi ndër shqiptarët gjithkund dhe në Shqipëri shumë më herët se të shpallej Pavarësia Kombëtare. Lidhja dhe bashkëpunimi u përforcua gjatë e pas Luftës së Parë Botërore dhe që dha rezultat deri me fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Për pasojë, pas Luftës, në Kishën Ortodokse Shqiptare të Amerikës, u çel një përçarje, aq sa iu desh FBI-së të hetonte Peshkopin Fan Noli, i cili vijonte të ishte një nga më të afërtit dhe më të respektuarit e qeverisë komuniste të Tiranës. (Leustean, 2010: 149)

Sipas studimit të plotë të Nikolla Panos, të përfshirë si kapitull i 9-të brenda librit të Leusteanit, titulluar *Kisha Ortodokse Shqiptare*, Peshkopi Fan Noli, gjatë Luftës së Dytë Botërore, nuk e kishte fshehur simpatinë për lëvizjen e rezistencës komuniste, duke besuar se ajo do të themelonte një regjim, që do t’u futej reformave liberalizuese, menjëherë pas përfundimit të Luftës. Nikolla Pano nuk lë pa shtuar, se ky besim i Peshkopit shqiptar në SHBA, vijoi deri në fillim të viteve ‘50, kur atij iu desh të përshtaste një qëndrim kritik lidhur me situatën në Shqipëri.

Ndërkohë ishte ndarë nga jeta Faik Konica, një nga këshilluesit e spikatur të poliedrikut Fan Noli, kësisoj qëndrimi dashamirës i tij dhe i mbështetësve përfundoi në konfliktin brenda Kishës Ortodokse Shqiptare të Amerikës (KOSHA), që solli brenda saj fraksionet pro dhe kundër komuniste. Kur kundërshtia u thellua, që përkoji me përkeqësimin e shëndetit të tij, Peshkopi pranoi ta vendoste kishën e tij nën juridiksionin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë (KOASH). Megjithatë, ai e tërhoqi kërkesën, shton Nikolla Pano në studim, duke vijuar të mos komunikonte me Kryepeshkopin Kisi në Tiranë.

Për të mos lejuar ndarjen e kishës në Amerikë, kundërshtarët e Fan Nolit iu drejtuan Patriarkanës së Stambollit, që t’u dërgonte një Peshkop, i cili të ishte antikomunist. Mark Lipa i Dioqezës Shqiptare në

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili mbërriti në SHBA në dhjetor 1950, mundi të fitonte besimin e vetëm 3 nga 12 famullitë e Kishës Ortodokse Shqiptare të Amerikës (angl. AOCA).

Për të siguruar statusin e saj kanonik, Peshkopi Mark Lipa u bashkua me Kishën Ortodokse Shumëkombëshe të Amerikës si Kryepeshkopata Ortodokse Shqiptare. Të dy dioqezat kishtarë ortodokse të mbetura nën juridiksionin e Peshkopit Lipa dhe Patriarkanës së Kostandinopojës (Stambollit) vijuan të funksiononin si Dioqeza Ortodokse Shqiptare në Amerikë.

Studiuesi Pano njofton me autoritet shkencor në punimin e tij serioz, se Peshkopi Fan Noli iu drejtua përsëri për ndihmë KOASH-it në vitin 1965. Nga shtrati i vdekjes, ai kërkoi që At Stefan Lasko (Stephen Lasko) të shenjtërohej Peshkop i AOCA. Autoritetet gjegjëse në Shqipëri e miratuan kërkesën e Peshkopit Fan Noli, por ngritja në detyrë e Peshkopit Lasko, ngjalli kundërshtime të forta brenda AOCA, deri sa u zgjidh në vitin 1969, me njohjen prej tij të grupimeve. (Leustean, 2010: 149) Sipas të dhënave, përçarja e komunitetit ortodoks shqiptar në SHBA vijoi deri në vitin 2008, por ndërkohë marrëdhëniet midis dy grupeve ishin përmirësuar. (Leustean, 2010: 149)

Një tjetër pamje, që fakton ecurinë dhe rolin e këtij lloj ligjërimit, është dokumentuar në një ligjëratë të Fan Nolit, mbajtur vetëm disa

muaj para ngjarjeve të lëvizjes së qershorit, që ndodhën edhe për shkak të ligjërimeve johumane që do zinin vend, sidomos në ligjërimet e mbajtura në Parlamentin e Shqipërisë (atëherë Kuvent Themeltar). Në fjalën e botuar në mesin e shkurtit 1924, bie në sy se ajo ka zbutur marrëdhëniet ndërpolitike mes deputetëve të Kuvendit. Të gjithë e miratojnë kërkesën e Kryepeshkopit të KOASH, i cili do të flasë për figurën e presidentit të SHBA. Fjala e deputetit Fan Noli dokumenton kahjen pro-perëndimore të shoqërisë shqiptare në përgjithësi, e përfaqësuar në Kuvent Themeltar, kurse lloji i ligjërimit të përdorur atje dëshmon për ndikimin e tij në krijimin e ‘njeriut fisnik të iluminizuar’, për të cilin kishte nevojë jo vetëm çasti, por sidomos ardhmëria. Ligjërimit human ishte ndërkallur deri në shkrimet liturgjike të cilat po silleshin në gjuhën shqipe nga personalitete, jo vetëm të fetarisë shqiptare, por, njëherazi, edhe të jetës kulturore e shtetërore te ne.

Ligjërimit i Fan Nolit është botuar me titullin: *Fjala memoriale e Imzot Nolit për Uillonin në Kuvent Themeltar*. Panegjirika i shkon figurës së Presidentit të 28-të të Amerikës, Uoodrou Uilson (Woodrow Wilson), amerikanin e madh, idealistin bujar dhe mbrojtësin e fortë të Shqipërisë së vogël e të dobët, por që ishte në të drejtën e saj. Nga foltorja e parlamentit pluralist, ai i fton shqiptarët të vajtojnë për Uillonin, udhëheqësin e vendit:

“Titulli ‘Amerikan’ mjafton që ta bëjë popullin tonë të marrë pjesë në çdo vajtëm të Amerikës, se që të gjithë e dimë sa të mira kemi parë prej saj. Që më 1900 Amerika ka qenë kurbeti më i madh i shqiptarëve. Që më 1914, kur Shqipëria u shkel prej të huajve, Amerika u bë vendi ku shqiptarët shkonin për të shpëtuar jetën e tyre e për të fituar bukën e fëmijës. Për të njëzet e pesë vjetët e fundme Amerika ka qenë për shqiptarët një fushë pune dhe një shkollë: Një fushë pune ku fitonin aq para sa ishin të zotët, dhe një shkollë ku mësonin respektin e kanunit, disiplinën, vlerën e organizimit dhe detyrat kundrejt Atdheut, kështu që ktheheshin në Shqipëri krejt të transformuar dhe njerëz me idera të ra.”

Amerika zemërmadhe i lejoi emigrantët shqiptarë të themelonin institucionet e tyre shpirtërore dhe kulturore. Atje lindi KOASH, që më pas u përcoll në Atdhe dhe gazeta e revista e shoqatës panshqiptare *Vatra*, jep fakte që numërojnë se ajo dërgon *Kryqin e Kuq* që t’i lehtësonte vuajtjet e Shqipërisë, por dhe hap shkolla, sepse sipas tij, ‘një nga të vetëmat, në mos e vetëmja, shkollë moderne që kemi është ajo e Amerikës: *Shkolla Teknike*’.

Nuk duhet harruar që kjo fjalë u mbajt jo vetëm nga deputeti, por edhe nga Kryepeshkopi i KOASH, ndaj domethëniet e fragmentit janë

të thella, por edhe dokumentimi i qasjes drejt Perëndimit prej parlamentit rishtar:

“Veç titullit ‘Amerikan’, Uillsoni ka për mirënjohjen tonë edhe një titull tjetër, atë të idealistit dhe të *“Profetit”* të vëllazërimit ndërkombëtar dhe të paqes së përbotshme. Presidenti Uillson ishte idealist se ishte amerikan. Ata që kujtojnë se Amerika është vendi ku njerëzia kujdesen vetëm për të bërë dollarë nuk e njohin Amerikën aspak. Fakti që një idealist si Uillsoni u zgjodh dy herë President, arrin për të provuar tezën tonë.”

Më poshtë Fan Noli gjykon se Presidenti Uillson ishte një hap para gjykimit të shoqërisë së kohës, e cila nuk e kuptoi, siç ndodh rëndom me gjenitë. Pasi u kthye nga Franca, senati i SHBA-ve refuzoi të ratifikojë Paqen e Versajës, të kryesuar prej Paktit të Lidhjes së Kombeve, për pasojë Presidenti, ‘nga zenithi më i lartë ku ka ëndërruar të hipë në histori të botës një njeri, u rrukullis dhe u rrëzua përdhe’, por jo figura e tij:

“O, çfarë rënie qe ajo, O qytetarë!
/ Ahere ju e unë të gjithë ramë, /
Dhe tradhti e gjaktë mbretëroi mbi ne.”

**“O, what a fall, O citizens! /
Then you and I and all fell down,
/ And bloody treason reigned
over us”.**

Pas largimit nga posti i lartë, Presidenti i la Shqipërisë një mbrojtëse besnike, Lidhjen e Kombeve, që ishte sajesa e tij, gjersa Shqipëria u qas në Lidhjen e Kombeve në dhjetor 1920, dhe u bë e aftë të mbronte veten me bijtë e vet. Emocionohesh kur lexon grishjen për të nderuar një Mik të Madh si një detyrim kombëtar përmes mirëkuptimit, pa dallim bindjesh, krahine apo shtrese shoqërore:

“Një herë në Parlamentin anglez Edmund Burke ka thirrur me dëshpërim: “*Alas, the age of chivalry is gone*” (Ajme, koha e kalorësisë shko). Presidenti Uillon e përgënjeshtroi këtë aseron (pretendim) dhe provoi në shekullin e njëzetë që ka një vend, i cili edhe prodhon kalorës bujarë për të mbrojtur jetimët, të vejat dhe të shtypurit. Qysh ta qajmë e ta vajtojmë këtë kalorës pa frikë edhe pa njollë, ‘chevalier sans peur ni reproche!’ (*U eklipsua Dielli i të vegjëlve dhe i të mjerëve*). U rrëzua përdhe dushku i madh mbi degët e të cilit kishin ndërtuar folenë e tyre ëndërronjësit idealistë dhe nga ky oshëtim me rënkim pylli i errët i dheut, dhe u zhduk vizioni i një bote më të mirë njerëzore. (*Po zemrat përphetë!*) “Sursum corda!”

Duke bërë të vetën frymën kritike, që mban gjallë besimin për të ardhmen më të mirë, ai jep bindjen e vet se çka është mbjellë me dashuri, do të rritet e shëndetshme, duke shtuar:

Amerika, ajo nënë bujare që i ka dhënë botës Uillonin, ka për të lindur edhe të tjerë kalorës si ay, kalorës të cilët të kenë mbi shqytin e tyre kryefjalën e Virgjilit “*regere parvons, debellare superbos*”, (kalorës të cilët të mbrojnë të vegjëlit dhe të përunjnin kryelartët), kalorës të cilët të vazhdojnë dhe të mbarojnë veprën e paqes, e vëllazërimit e mirëdashjes ndërkombëtare. (*Duartrokitje të përgjithshme*) (Ombashi, 2002; 2014)

Është fillimviti 1924, por me gjithë ndryshueshmërinë e botëkuptimeve, kulturave, klasave shoqërore dhe interesave personale, folësi merr, sipas raportuesit të lajmit, *Duartrokitje të përgjithshme*, çka dëshmon se ligjërimi i hollë po fitonte përkrahës, të paktën në elitën e kohës.

Fryma pozitive nxiti lucidët e kohës që të ftonin masën e lexuesve që të mos e shihnin tjetrën si të kundërt të vetes, por përkundrazi. Në një shkrim publicistik, Mithat Frashëri rreket të informojë lexuesin përmes ligjëritimit human se *Bektashizmi* i shton vlerë kulturës së besimeve në Shqipëri, por edhe identitetit kombëtar në veçanti.

Personaliteti i kulturës shqiptare fton lexuesin e specializuar, duke kërkuar mirëkuptimin e tij, që të mos lexojë gramatikisht e as vetëm kuptimisht, por edhe semiotikisht, duke e ndjerë fillimisht dhe pastaj duke nxjerrë kuptimin në kontekstin e tekstit, që e quan shpirt të teksteve fetare:

“Kjo panteizëmë beson se fuqia e perëndishme ekziston në të gjithë rruzullin, e pandarë prej natyrës dhe shfaqja m’ë lartë e kësaj fuqie është njeriu. Prandaj bektashizmi beson se, për të zgjidhur të gjitha çështjet metafizike, duhet marrë parasysh njeriu. Dhe *Lajmëtarin* e konsideron një nga këto shfaqje të larta të formës njerëzore. Parajsën dhe skëterrën njeriu i ka vetë në dorë. Në këtë mënyrë, *bektashizma* përmbledhet në katër fjalë: *Dituria, Besnikëria, Ligji* dhe *Sekti*.” **Reformat e Bektashizmës në Shqipëri**¹

Raporti që njeriu ka me lirinë, në përgjithësi, dhe atë të besimit e mendimit në veçanti, e ndihmon autorin të sqarojë lexuesin, duke e informuar shkencërisht atë, pa fshehur rolin e këtij tarikati të fesë islame në kulturën dhe identitetin shqiptar:

“Si produkt i racës ariane u përhap dhe në Shqipëri, sidomos në një kohë kur Sulltan Mahmuti, bashkë me prishjen e Jeniçerëve, persekutoi dhe të parët e *bektashizmës*. Pjesa shqiptare erdhi në Shqipëri, ku gjeti pasonjës të vjetër dhe ngriti teqetë. Çdo sekt i persekutuar është anëtar i lirisë. Prandaj *bektashizma* në Shqipëri kurdoherë është shfaqur tolerante e liridashëse dhe me të dalë në shesh të letrave shqiptare, i adaptoi me kënaqësi, ndërsa teqetë i bëri fole të kulturës kombëtare.”

1. *Gazeta e Re*, 11 prill 1929.

Nuk i shpëton grishjes për mirëkuptim midis besimeve, duke ftuar për dialog, që e afron dituria kur shprehet se me parimin “Dituri” bektashizmi pranon çdo kulturë shkencore, me fjalën “Ligj” kupton respektimin e ligjeve të shtetit dhe se çdo njeri e lë të lirë të adoptojë çdo udhë për të arritur të vërtetën. Pasardhësi i frashërllinjve të shquar, duke besuar te dituria dhe ligji arrin të sugjerojë edhe shtigje, që nxisin nismat në shërbim të çështjes kombëtare:

“*Bektashizma*, po të mund të bëjë organizatë, me të cilën të vërë në aktivitet klasën kulturore të sektit të saj, do të kurorëzojë me një sukses të shkëlqyer iniciativën, që kish marrë qysh në krye të nacionalizmës shqiptare.” *Kokojka* (Frashëri, 2017: 548)

Fara e shëndetshme e kësaj fryme u rrit shpejt falë butësisë dhe durimit. Vetëm disa vjet më pas, gjithnjë në periudhën e ndritshme të gazetarisë shqiptare, arrihet një kulm, diçka për të cilën as që mund të mendohej se mund të arrihej te një komb tjetër. Bariu i KOASH mban fjalën kryesore në varrimin e Prijësit të Komunitetit Mysliman Shqiptar. Fjalët kryesore të përdorura janë fjalë çelësa për të ndërtuar fjali, që ishin në koherencë të asaj, e cila synonte durim dhe vetëm durim pas durimit si mendësi e traditës, për të cilën kishte aq shumë nevojë.

Që Haxhi Vehbi Dibra ishte një personalitet i përkushtuar, si në aspektin shpirtëror, ashtu dhe kombëtar, këtë konstatim e përforcon edhe vlerësimi që i bëri me fjalën e përmortshme Visarion Xhuvani (1890-1965), Kryepeshkopi i parë i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare (1929-1937).

“Flet Im-Zot Vissarioni

Disa pjesë nga fjala e Im-Zot Vissarionit, ish-Kryetari i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipnis.” (Zani i Naltë, 1937/4)

Qysh në krye duhet sqaruar se realisht Shkëlqesia e Tij, Imzot Xhuvani, vijoi të ishte Kryetar i Sinodit të shenjtë të KOASH, ndonëse ai kishte dhënë dorëheqjen nga posti i lartë i Kryepeshkopit, meqë Patriarkana e Stambollit nuk pranoi që Imzot Xhuvani të ishte në krye të Sinodit të Shenjtë, detyrë që iu dha zyrtarisht Imzot Kristofor Kisit në prill 1937, i cili njëherazi u zgjodh edhe Kryepeshkop i KOASH. (Leustean, 2010:144)

Kryepeshkopi pohon për lidhje institucionale me Haxhi Vehbiun, duke i dhënë meritën si njeri ‘që u dha dorën të Krishterëve tue u thanë se e ndjekim, po, besimin, që na kanë lanë trashëgim të parët, porse kudo, në jetën t’onë, jemi vllazën të pandarshëm’. Ai kishte punuar për të gjithë vendin e jo për një krahinë apo një pjesë, duke luftuar sëmundjet

e provincializmit, *klaustrofobisë* e sektarizmit, gjithnjë i udhëhequr prej *filoksenisë*, që nxit të thyesh ‘pengesat e mos marrjevet pjesë’ në nderimin e njeriut me ideale të shenjta dhe duke mos e lënë besimin në dorë të politikës:

“Unë sod po e thyej pengesën e mos marrjevet pjesë, nga ana e jonë, në ceremonina të tilla: na jemi vllazën. Myslimanizmi Shqiptar duhet të jetë krenar që pati në gjirin e vet burra si i ndjeri: uroj nga zemra që të vazhdojë të ketë të tillë. Aj po ju len juve, shokë të Klerit Mysliman, idealin e tij që po forcohet dita ditës: Haxhi Vehbiu asht nga ata që i pjellë rrallë koha, Aj tashti prehet i sigurt se misioni i tij atdhetaro fetar qëndron ndër duer të mira si të juejat.”

Për t’u bërë më bindës jep fakte të tjera të imta që plotësojnë figurën e tij ‘vetëm si një Shqiptar i mirë’, që la trashëgim për KMSH karakterin e burrit:

“Sa i nalt e sa i math ishte edhe në çdo rast prezantimi miku i Ynë i dashtun, Haxhi Vehbi Dibra! Kur ecte, kur bisedonte, kur qëndronte në mest të miqëve dhe misafirve i bante të gjithë pa ndryshim feje ta duan e ta respektojnë; nuk bani kurrë dimagogji as reklamë, por vetëm detyrën e tij Fetaro Kombëtare si një Muhamedan i mirë si u tha prej të tjerëve, por edhe si një, vetëm si një Shqiptarë i mirë,

por edhe si një fillosof i zoti i punëve shoqërore, n'as një tallas nuk u përul dhe për as një mik nuk u kursye, dhe n'as një politikë nuk u trazue, si asht fare lehtë ose natyrale për çdo Kryefetar dhe sidomos në kohnat e brumëzimit të parë social-fetar-politikë dhe patriotikë në Shqipëri; jo se ishte miku i jonë personal, por pse ishte edhe një njeri i tillë, edhe neve e pamë t'arsyeshme me mos u kërsye por me kuxue dhe me çqetsue pak kët mbledhje të hirëshme me fjalë tona, në kët vend shumë të ndershëm ku prehen eshtnat e të dashtunve t'onë vllëzër në kombësi, sa do që për të parën herë ndofta, jo vetëm në Shqipëri, por ndofta edhe në të gjithë botën, për të parën herë flet një Kryepriift Kristijan Orthodhoks në varrin e një Kryehoxhe Muhamedan Mysliman. Nuk ka ma trashigim të çmueshëm se karakteri i këti burri për bir e bij të tij që i le mbrapa njerz të meritueshëm.” (Zani i Naltë, 1937/4: 109-111)

E kishte dëshmuar burrinë kur kishte dhënë *Fetvanë* për Deklaratën e Pavarësisë, kur po e nënshkruante në Vlorë. *Fetva* (arab. *fatwa*) del si propozim i zgjidhjes së ndonjë çështjeje juridike, interpretimi i Ligjit të Sheriatit, përkatësisht vendimi formal juridik i mbështetur në *Kur'an*, në *Hadith* dhe në *fikh*; *fetvaja* paraqet vendimin formal juridik lidhur me ndonjë çështje sociale, që ka të bëjë me trashëgiminë, martesën apo me shkurorëzimin e bashkëshortëve

myslimanë; *fetvanë* e jep myftiu i autorizuar ose ndonjë njohës i mirë i Ligjit (arab. *ulema*); gjyqtari (*kadiu*) merr parasysht *fetvanë* e myftiut, por vetë merr vendimin përfundimtar. (Myrtezai, 2007: 128) Propozimi juridik ftonte për profilizim ideor dhe politik të parisë myslimane të shtetit të sapongritur, që i vuri themelin e një shteti laik, ku komunitetet fetare do të përfaqësoheshin sipas parimit të së drejtës latine ‘pares inter pares’. Revista *Zani i Naltë*, nr. 4, 1937, opinionin e saj mbi këtë veprim të Vehbi Dibrës, në lidhje me Shpalljen e Pavarësisë, e përshkruan në këtë mënyrë:

“Goja e tij e ambël e bekoji për herën e parë Veprën e Shenjtë të ngritjes së Flamurit. Flamuri i jonë i dashur do të valojë gjithmonë, pse se pati fati e lumnuëshëm që t'a fillojë tallazin e parë me bekimin dhe uratën e një fetari të vërtetë.”

Sqarojmë se në mjaft raste, si në Dosjen 24 AQSH, Haxhi Vehbi Dibra, Kryetari i parë i Pleqësisë së Kuvendit të Vlorës (Hysa, 2012), shënohet edhe si Sherif Ef. (Efendi) Dibra: 24 AQSH, F. 145, V. 1912, D. I-4, f. 9.

Prijësit myslimanë e kishin ngulitur në vetëdijen kombëtare binomin “Për Atdhe dhe Fe”, duke u bërë pendë me prijësit françeskanë të Shkodrës. Për këtë personalitet të historisë sonë kombëtare, ashtu

si dikur Frang Bardhi, që për Skënderbeun zgjodhi të citonte vetëm personalitete, për fat të mirë ka folur një tjetër gegë me shenjë.

Ka thënë At Zef Pllumi për Hafiz Ali Krajen:

“Hafiz Ali Tari (Kraja) ishte njeri i madh për kohën e padyshim njeni ndër hoxhët ma të dijtun. Kishte përfundue studimet universitare në Kajro - Egjipt - dhe njëhej si një teolog mysliman, që dinte shumë gjuhë dhe ishte gojëambël. Në vitin 1939 ishte caktue edhe ai në delegacionin për të çue kunorën prej Shkodre dhe, siç e tregon vetë Hafizi, nuk shkoi për meritë të Atë Anton Harapit. Kujtohej shpesh fjala e mbajtur prej tij me rastin e vdekjes së Atë Gjergj Fishtës.”

Hafiz Ali Kraja ishte *suksesor* (pasues) i idesë së Gazzaliut, se politika del në krye dhe çmohet si e para e dijeve humane, ndaj iu qas idesë se politikanët përcjellin cilësitë hyjnore, duke mbajtur rendin dhe drejtësinë, pa të cilat nuk ka as familje, as komb e as shtet.

Te vepra e tij filozofike *A dubet feja*, që e shkroi kur ishte 33 vjeçar, rreket të argumentojë se ndërgegjet e formuara prej burimesh jofetare, të sjellin detyrimisht konflikt:

“Njeriu nga natyra është *narcisoid* dhe kur gjen rast dhe mbetet i lirë prej vërejtjeve të ligjit ose disiplinës,

ai vepron sipas ëndjes së vet. Pra, për ta ndaluar dhe për ta ruajtur prej të këqijave, e vetmja fuqi është disiplina fetare.” (Kraja, 2016)

Në mënyrë të natyrshme, te pika e gjashtë e punimit, që e ka ndërtuar si dialog me shekullaristët, ai del në përfundimin se morali fetar ka një burim filozofik, prandaj nuk i humb vlera e vet e diturisë. Për më tepër, morali u ofron shqiptarëve atë për të cilën ëndërrojnë: mirëkuptim brenda vetes, paqe e lumturi, duke i larguar nga kundërshtitë e pafundme lëndore. (Kraja, 2016: 68)

Me këtë lloj formimi filozofik, kulturor dhe kombëtar, më 30 dhjetor 1940, ai i drejtohet poetit gegë me një ligjërim të lartë, duke përdorur vetën e dytë të ligjërimin bisedor:

“Poet kombëtar, o Patër Gjergj!
Një orator, tue dashtë me folë mbi veprat Tueja, rrin shtang e hutohet, sepse ata janë shumë, janë aq të mëdhaja e të madhnueshme, sa asht vështirë me caktue se mbi cilën aso veprash duhet me folë. Vepra Yte o Poet, ka për të formue një faqe të shkëlqyeshme në historinë politike të kombit shqiptar, pse, në aktivitetin që ke zhvillue ndër konferencat politike ndërkombëtare, nuk kje tjetër veçse me i sigurue kombit tonë të drejtat, qi ai i ka jetike e si ma i vjetri komb në Ballkan.”

E vlerëson së pari për kontributin për të gjithë patriotik, mbi atë fetar që është vetëm për një pjesë të popullit shqiptar, duke e këtuilluar ‘poet kombëtar’, sepse vepra e tij në përgjithësi, por veçmas ajo poetike, kishte këshilluar për plotësimin e ndërgjegjes kombëtare. Kësisoj e ka vlerësuar edhe një tjetër prelat i Kishës Katolike, At Zef Valentini, që e përqsas me vlerat universale:

“Fishta asht një Homer shqiptar. Ai nuk asht vetëm një poet i madh kombëtar. Ai asht nga ma të mëdhajt në botë. E randsishme asht që ai të njihet prej saj.”

I bindur se kryeveprat letrare janë kujtesë kombëtare që jeton në jashtëkohësi, shpreh bindjen se psikika e kombit të lashtë forcohet me tiparet e zbuluara nga poeti i madh, duke iu bërë krah rinisë shqiptare në rrugën e së ardhmes. Ai shkon më tej përmes fjalës së tij të ndjerë:

“Gjithashtu edhe populli mbarë, i fushave dhe i maleve, anë e kand në Shqipni sot nep besën, se *Labuta* e jote në shpirtin e tyne do të sundojë sa të jenë stinë e mote. Trima e gra, djelm e vajza, me fjalën shqiptare të napin besën, se vllaznimin kombëtar, që ti çfaqe në *Labutë*, do ta mbajnë me forcë të madhe...

Me ty, patër Gjergj, kombi shqiptar mburret, naltësohet dhe madhnohet para popujve të tjerë,

prandaj sot krejt populli shqiptar të përulet; djelmnia intelektuale vajton humbjen Tande e me lot në faqe përcjellin me mallnjim e dhimbje në jetën e pasosun.”

Në ato vite besohej gjerësisht se lexohej me zemër, kësisoj vepra të tilla këshillonin për vëllazërim kombëtar, pa të cilin hapat në rrugën e formimit të ndërgjegjes dhe të ringritjes ekonomike do të rëndoheshin dhe do të ngadalësoheshin. Kultura e shkruar do t’i dëshmonte botës së qytetëruar se po kapej koha e humbur jo vetëm me luftëra me të tjerët, por edhe mes vetes.

Ky formim i marrë në atdhe, në familje dhe në bankat e Medresesë së Lartë të Tiranës, do ta shoqërojë imam Vehbi Ismailin, prijësin e myslimanëve të SHBA, që të mbante fjalën e përmortshme për ‘kolosin’, ‘simbolin’ kombëtar, historianin shkencëtar e patriot dhe me vlera universale Fan Noli, i cili themeloi KOASH-in, por jo vetëm aq:

“Hirësi! Si fetar unë i lutem Perëndisë që t’ju falë paraajsën e merituar dhe neve shqiptarëve, të gjithëve, të na japë durim për humbjen tuaj të pazëvendësueshme, e të na bëjë trashëgimtarë të denjë të amaneteve tuaja e pasues të zellshëm të jetës Suaj!”

Jetë e një fetari, kushtuar çështjes dhe kulturës shqiptare. (Ombashi, 2002; 2014)

I mbrujtur me filozofinë e qëndrimit kritik, që përmes termit kyç ‘*durim*’ përcjell pozitivizëm të ngritur mbi metafizikën hegeliane, nuk mund të mos theksonte se, duke i shërbyer binomit Atdhe-Fe, Fan Noli ishte e do të mbetej i të gjithëve.

Në këtë linjë është edhe fjala e Baba Rexhepit, që e thekson rolin udhëheqës të ‘Hirësisë së Tij, Kryepeshkop Fan Nolit, për të gjithë shqiptarët e Amerikës’, duke qenë një njeri i rrallë:

“Shqipëria humbi një bir të shquar, Kisha Kombëtare humbi themeluesin dhe kryetarin e saj të ndritur, komuniteti shqiptar në Amerikë humbi prijësin e pashoq. Në personin e Fan Nolit përfshiheshin cilësitë e rralla të një njeriu të rrallë. Cilësitë e një patrioti të palodhur. Cilësitë e një fetari të devotshëm. Cilësitë e një shkrimtari të jashtëzakonshëm.”

Më poshtë, prej fjalës së Baba Rexhepit, lexojmë se Fan Noli pati një influencë të madhe në historinë e kulturës shqiptare, sepse ‘ishte një thesar diturie’. E veçon mbi të gjithë që njihete, sepse, sipas tij, dilte në ballë të veprimtarëve shqiptarë në fushën e kulturës. Shton si vlerë edhe përkthimet në gjuhë të ndryshme, por nxjerr në pah vlerat e ‘përkthimit’ prej tij të *Rubairave* të Omar Khajamit në gjuhën shqipe, që i vlerëson si më të bukurat e

bëra në çdo gjuhë tjetër. Vepra ishte përkthyer nga origjinali persisht edhe nga Hafiz Ali Korça, por duke e njohur atë gjuhë të poezisë, Babai i Teqesë Bektashiane të Detroitit, dallon ‘shqipërimin’ nolian që nuk e cilëson kështu:

“Faik Konica, shok dhe bashkëpunëtor i orës së parë i Fan Nolit në gazetën *Dielli* dhe në federatën *Vatra*, kështjellë graniti e shqiptarizmit në mërgim, shkroi këto:

“Fan Noli na dha neve historinë më të mirë të Skënderbeut, heroit tonë kombëtar...”

Por ndihmesa e tij për dhe në gjuhën shqipe shkëlqeu në përkthimin e veprave liturgjike. Duke parapëlqyer që të vlerësojë mikun para vetes, si element i etikës islame, jep citimin e Faik Konicës për to:

“Përdorimi i gjuhës në Liturgji është një nga përparimet më të mëdha të Fan Nolit. Ditën në të cilën ai përdori për herën e parë gjuhën shqipe në Liturgji, atë ditë u shënuar një kthesë me rëndësi në historinë e Rilindjes Shqiptare...”

Kryepeshkopi Fan Noli u përpoq kurdoherë për vëllazërimin e shqiptarëve dhe për përparimin e tyre dhe të kombit. (Dela Roka, 1994) Bashkoi dashurinë e Krishtit me dashurinë e Atdheut. Zoti dhe

Shqipëria ishin idealet më të larta e më të shenjta në gjithë jetën e tij. Fan Noli u çmua dhe u nderua nga gjithë shqiptarët, por ai u çmua dhe u nderua edhe nga të huajt, si njeri i letrave, si udhëheqës fetar, si diplomat i hollë, si orator i mprehtë, si njeri me sjellje fisnike.

Kur shërbente si delegat i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, Fan Noli tregoi një zotësi aq të rrallë dhe një sjellje fisnike aq të shquar, sa fitoi simpatinë dhe respektin e shumicës së madhe të delegatëve. Dhe një ditë, kur delegati i Greqisë u shpreh në një mënyrë jo korrekte përkundrejt delegatëve të tjerë për qëndrimin që mbanin në favor të Shqipërisë, Lord Cecili i tërhoqi vërejtjen me këto fjalë:

“Ju delegatët e Greqisë, para se të flisni, duhet të merrni mësim nga delegati i Shqipërisë.”

Fan Noli dihej prej të gjithëve në SHBA që rrihte majtas, por kjo nuk e pengoi mërgimtarin politik që ta përcillte me fjalët ku shpresohet dhe besohet se Shqipëria do të bëhej një ditë e lirë dhe demokratike:

Me këtë besim në zemër, por, njëkohësisht, me shpirt të trishtuar përulemi tani me respekt të thellë përpara trupit të tij, duke i paraqitur nderimet e fundit, të bindur se eshtrat e tij, të cilat do të çlodhen në tokën e bekuar e të lirë të Amerikës,

ku ai zhvilloi veprimtaritë më të shquara, do të vendosen një ditë në Panteonin e pionierëve të Rilindjes Shqiptare, në një Shqipëri të lirë e demokratike, ashtu siç e ëndërronte dhe dëshironte Kryepeshkop Fan Noli. (Ombashi, 2002; 2014)

Përmbledhje

Gjithçka që erdhi në jetën kulturore dhe fetare shqiptare, veçmas me fillimet e Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare, u përgatit me dashuri dhe kujdes nga prijësit, çka siguronte se do të jepte prodhim të mbarë. Kongresi i Alfabetimit i vitit 1908 tregoi se diversiteti i panevojshëm gjuhësor, mund të ndalej. Duke miratuar alfabetin latin, u dëshmuar kahja pro perëndimore, ku Rilindja Evropiane kishte vënë në krye besimin te njeriu dhe, njëherazi, qasjen me filozofinë lindore të evolucionit. Pozicioni komod midis Lindjes dhe Perëndimit, solli në letrat shqipe fjalët: *Atdhe-Fe, hak* (e drejta), *mirësi, shpirt, Shqipëri, Shqipëtar, pari, pamvarësi, besë, optimizëm për të ardhmen, fanatizëm, mbrohtësi, mirëkuptim, butësi, durim, tërthër* (N. Veqilharxhi: për sakrifiko), *përlësi, falje, zemër, libër, besim, besimtar, besnikëri, Rilindje Kombëtare, liri demokratike, fletore, mirëdashje, kryelartë, kalorës, burrni, mbarësi, falje, civilizim, filozofi, folklor, etni, traditë, epos, Homer, prijëtar, liturgji, bashkëpunëtor, vëllazërim, mysliman, i krishterë, bektashi, franceskan, jezuit,*

*ortodoks, Haxhi, Hafiz, At, Peshkop, Kryepeshkop, diplomat, orator, republikë, fisnik, blu, flamur i bardhë, qytetërim... të përcjella me grishjen për shpresë dhe besim për të ardhmen e kombit dhe atdheut. Konteksti historik dhe kulturor, në të cilin ato u nyjëtuan, ndillnin urtësi gjatë marrëdhënies midis shqiptarëve, duke e përmirësuar realitetin kulturor, social dhe jo vetëm. Përkthimi i *Biblës* dhe pjesëve të *Kur'anit*, u pasua nga sjellja në shqip e kryeveprave të letërsisë botërore, kulturës e shkencës. Publicistika, veçmas botimet e revistave, nxitën diskutime mbi neo-shqiptarizmin, që predikonte ecjen përpara pa e dëmtuar traditën. Fjalët, togefjalëshat, emrat, nofkat, emërtimet dhe shprehjet: *kryengritje, helmim, hakmarrje, politikë, gjykim politik/ideologjik, dhunë revolucionare, prefekt, kryeplak, bashkë, konservatorizëm, inat, halle, kështjellë, forcat tona, socializëm, kapitalizëm, materializëm, bej, aga, imperializëm, internacionalizmi proletar, proletkult, kolektiv, kolektivizim, kooperativë, mjerime, duhen qërruar tradhëtorët, pengimtarët më të këqij të zhvillimit kombëtar, lufta e klasave, mikroborgjezi, borgjez, autokritikë, egoizëm, moral proletar, zakone prapanike, shtetërrufe, emancipim i gruas, aksionist, satrapi Zog, regjim antipopullor, i arratisur, vullnetar, pas(a-u)nik, varfanjak, Xhem komunisti, atentatori, zbor, kleçkë/njollë në biografi, rrethi familjar, dosje, tesër partie/rinie, anëtarësim, kulak,**

*prapanik, fetar, shamia e kuqe, njësitë gueril, ylli i kuq me pesëcepa, organizata bazë, byro, rrethim, rruga "Komuna e Parisit", "Shkolla e Kuqe", oxhak, opingë... të vendosura në kontekstet gjegjëse të kohës marrin vlerën e koncepteve, që grishnin dhe nxisnin urrejtje, prishnin vëllazërimin e lënë amanet nga të moçmit, duke krijuar konflikte ideologjike dhe klasa antagoniste, përmes ligjërimit riosh, i zëvendësoi hap pas hapi butësia e përcjellë nëpërmjet llojit të duhur të ligjërimit, që e kërkonte koha. Kur fjalë kyç doli politika/ideologjia, ajo zhvlehtësoi gjithçka tjetër duke zyrtarizuar largimin ekstrem deri në mohimin e së kaluarës, që u shoqërua me arsimim të mangët të mbështetur mbi trekëndëshin revolucionar mësim-punë prodhuese-edukim fizik dhe ushtarak. Njëherazi ligjërimi i butë libror, i marrë si metodë e praktikë komunikimi me shkrim dhe me gojë, pengoi sa mundi kuptimet e figurshme të fjalëve *oxhak, opingë, bujk, bej, borgjez, bankier, klerik, bolshevik, proletar, komunist, ateist...* duke u përpjekur të pengonte përhapjen e ideologjisë bolshevike, e cila gjeti strehë te shtresa e mesme e sapokrijuar, e cila, kryesisht mes qëndrimeve emotive, iu bë krah përçarjes sociale, ligjëroi dhunën dhe hakmarrjen klasore, mbolli urrejtjen që mezi priste ardhjen e pesimizmit apokaliptik. Në anë të kundërt me iluzionet e përhapura prej saj, kultura e komunikimit fituar*

mes ligjërimit të butë libror ftonte dhe shpresonte për mirëkuptim, që i parapriu vëllazërimit kombëtar, si bazë për ecurinë e dëshiruar, veçmas në krijimin e ndërgjegjes kombëtare. Ndikimi ishte i dyfishtë. Ligjërimi i butë libror ndihmoi në forcimin e sedrës vetjake dhe në krijimin e ndërgjegjes kombëtare, si dhe të pranimit të qëndrimit kritik pasuruar me filozofinë e evolucionit, por, nga ana tjetër, kjo lloj kujtese kolektive dha ndihmesën e vet në pasurimin e këtij lloji të komunikimit me anë të gjuhës.

Baza e hedhur nga prijësit fetarë shqiptarë shërbeu si themel i shëndoshë për ecurinë e mëtejshme të kësaj prirjeje komunikimi masiv, e cila, me kohë, u përhap më gjerë

si mendësi intelektuale, që nxiste për më shumë grurë sesa heroizma. Ajo u bë kulturë e kohës sipas së cilës u ngritën sjellja e individit dhe institucionet politike. Në përhapjen e ligjërimit libror të butë ndihmuan fjalorët shpjegues shqip të kohës dhe kur u vyshk nga furtunat e kohës ideologjike moniste, u ndalua, u përçmua apo u përjashtua ligjërisht nga përdorimi në Atdhe, sepse filloi mbjellja e fjalorit politik revolucionar, që do të rriste mendësi e praktika revolucionare, atë e morën me vete dhe mundi të mbijetojë te mërgimtarët, kryesisht në SHBA, Itali, Gjermani e gjetiu, të cilët binomin Atdhe-Fe, si dëshmi e ndritur e ligjërimit të butë libror, e mbajtën gjallë.

Bibliografi

- “100 personalitete shqiptare të kulturës islame”, botimet KMSH, Tiranë, 2012.
- AQSH, F. 882, d. 5, v. 1919, f. 30. *Bashkëpunimet e Vebbi Dibrës në lidhje me emërimet në Qeverinë Shqiptare dhe gjyqin e sberiatit.*
- Bello, Hasan. *Shkëputja e Shqipërisë nga Kalifati Osman dhe përpjekjet e bëra për autoqefalin e xhamisë shqiptare*, në: “Gjurmime albanologjike-SSHH, nr. 40, IAP, Prishtinë, 2011: 139; 145;
- Caushi Sulo, Ilira. *Klerikët e harruar të pavarësisë*, në: “Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX”, UT- IH, Tiranë, 2007, f. 86.
- Ceriq, Mustafa. *Kritika e fetarisë së kulluar*, “Univers”, Tiranë, 2018/19:308-321.
- Xhelili, Qazim. *Vebbi Dibra-personalitetet dhe veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare*, albin, Tiranë, 1998, f. 21, 200.
- Dibra Haxhi, Ismet. *Flet drejtori i Medresesë, “Zani i Naltë”*, nr. 4, Tiranë, 1937, f. 105. Shih: Parashkresë e përkohshme për organizimin e *Sherisë* në Shqipëri, Shkodër, 1917.

- Dela Roka, Roberto Moroco. (1994) *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920 - 1944*, (Përktheu nga origjinali Luan Omari), SHB, “Elena Gjika”, Tiranë.
- Fjalori Enciklopedik Shqiptar 2, ASHSH, Tiranë, 2008, f. 1260.
- Isufi, Hajredin. (2008) *Feja dhe Flamuri: Dom Nikollë Kacorri*, Pegi, Tiranë: 349.
- Kraja, Hafiz Ali. (2016) *A DUHET FEJA A e pengon bashkimin kombëtar*, Tiranë.
- Leustean, Lusian N. (2010) *Eastern Christianity and the Cold War, 1945-91*, London and New York.
- Morina, Qemajl. *Mbi fenë, atdheun dhe kombin*, “Takvimi” nr. 39, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 1998.
- Myrtezai, Ekrem. (2007) *Fjalori i terminologjisë fetare*, BIK, Prishtinë.
- Noli, Fan S. (1987) *Vepra 2 – Publicistika (1905-1925)*, Tiranë.
- Ombashi, Rahim. (2002; 2014) *Po vjen Noli...*, Korçë; Tiranë.
- Xhelili, Qazim. *Vehbi Dibra, hoxhë dhe patriot i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare*, në: “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët”, KBIK, Prishtinë, 1995, f. 394;
- Xhelili, Qazim-Kadiu, Arian. *Vehbi Dibra-Figurë komplekse e personalitetit të shquar mysliman dhe Lëvizjes Kombëtare*, “Perla”, nr. 3-4 (31), Tiranë, 2003, f. 44-63.
- Xhuvani, Visarion. (1887-1965), Kryetar i parë i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, shih: Fjalori enciklopedik shqiptar 3, ASHSH, Tiranë, 2009, f. 2961.
- Zani i Naltë. (1937) *Flet Im-Zot Visarioni*, Nr. 4, Tiranë, 1937: 109-111.
- Zekaj, Ramiz. (2002) *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shek. XX*, ISHMQI, Tiranë: 290.

Revista-gazeta

- Hysa, Mahmud. (2012) *Haxhi Vehbi Dibra - Kryetar i parë i Pleqësisë së Kuvendit të Vlorës*, “Kosova Sot”, nr. 4569, Prishtinë, 19 maj.
- Izeti, Metin & Ismaili, Adnan. (2016/17) *Modernizimi dhe sfidat e diskursit fetar*, Univers AIITC, Tiranë.
- Nuro, Kujtim. *Toleranca dhe harmonia e fesë islame te shqiptaret-faktor i rëndësishëm për çështjen kombëtare*, në: “Univers” nr. 1, ISHMQI, Tiranë, 2001, f. 125-126.

Webliografi

- <https://orientalizmi.wordpress.com/tag/fehim-zavalani/>
- Ahmeti, Nuridin. *Vehbi Ef. Dibra në lëvizjen kombëtare shqiptare*.

“Medresetë e Shkodrës” (nga fillimet deri në vitin 1947)

Prof. dr. Njazi Kazazi
Departamenti i Gjuhësisë
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Abstrakt

Ky studim u ndërmor me dëshirën për të ndriçuar sadopak punën e mësuesve dhe të nxënësve të medreseve, ndihmesën që kanë dhënë ato në çështje kombëtare dhe në edukimin e breznive të reja, si dhe për të vënë në vend atë që është mohuar për gjysmë shekulli e për të zënë edhe ato vendin që u takon në historinë e arsimit shqiptar, këtë të drejtë të ligjshme që ua japin ditët e bardha të demokracisë që erdhën te ne. Por, ashtu si për një poet tonin të njohur, edhe për ne “...demokracia nuk është një makinë elektronike llogaritëse për të gërmuar në koleksionet e gazetave dhe të revistave gjysmëshekullore dhe për të numëruar fjalitë dhe frazat e botuara nga njëri apo tjetri dhe për t'i përdorur si argumente akuzimi”.

1. Hyrje

Monografia “Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër (Nga fillimet deri në vitet ‘20 të shekullit XX)”, shtëpia botuese “Rozafa”, Shkodër, 2014, që po paraqesim, synon të ndriçojë sadopak historinë dhe traditën e arsimit të mesëm në trevën e Shkodrës e kësisoj të japë

një ndihmesë modeste në punën e këtyre shkollave, për rëndësinë e tyre në arsimin dhe edukimin e masave të popullit, për përgatitjen e intelektualëve, që punuan dhe kontribuan në fushat e ndryshme të jetës, që nga drejtimi i shtetit e deri si mësues në shkolla të ndryshme të vendit.¹

1. Libri është paraqitur në Jurinë për të marrë titullin “Kandidat i shkencave pedagogjike”,

Gjatë këtyre 26 viteve janë botuar shumë vepra madhore dhe monografi, të cilat në mënyrë të përmbledhur do t'i përfshijmë në këtë botim, (duke shfrytëzuar disa prej tyre) si:

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më pas ASHSH): Fjalori Enciklopedik Shqiptar (më pas FESH). Botim i ri. Grup autorësh. Vëll. 1-2. Tiranë, 2008. Vëll. 3. Tiranë, 2009.

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (më pas MASH), Instituti i Studimeve Pedagogjike (më pas ISP): "Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar". Grup autorësh. Tiranë, 2003.

- Komuniteti Mysliman i Shqipërisë: Enciklopedi – "100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame", Shekulli XIX-XX. Editor Dr. Genti Kruja-Andrin Rasha, Tiranë, 2012. Faqe 307.

- Komuniteti Mysliman i Shqipërisë: Kolana "Zani i Naltë" - Organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar, themeluar më tetor 1923, Vëllimi i Parë, vitet 1923-2024-1925. Editor Dr. Genti Kruja. Tiranë, Mars, 2014. Faqe 704.

- Shefik Osmani: "Reflekse etnopedagogjike". Vëllimi 1. Tiranë, 1998.

- Shefik Osmani: "Shpalime etnopedagogjike- Panoramë retrospektive e mendimit pedagogjik shqiptar". Vëllimi 2. Tiranë, 2008.

- Shefik Osmani - Njazi Kazazi: "Abetaret Shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike". Botim i MASH dhe i Shtëpisë botuese "Idromeno", Tiranë, 2000.

- Tomor Osmani: "Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918)". Shtëpia botuese "Camaj-Pipa". Shkodër, 2004 (Rib. 2009, 2012).

- Tomor Osmani: "Udha e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit". Botim i ASHSH. "Ilar", Tiranë, 2008.

- Vehbi Hoti: "Luigj Gurakuqi, për shkollën shqipe dhe arsimin kombëtar". Monografi. "Camaj-Pipa", Shkodër, 2002.

- Vehbi Hoti: "Ethem Osmani 'Mësues i Popullit'" (Monografi), "Camaj-Pipa", Shkodër, 2012.

- Mentor Quku: "Historia 100-vjeçare e shkollës së Barbullushit (1901-2001)", Shtëpia botuese "Lilo", Shkodër, 2001.

- Iljaz Gogaj: "Shkolla teknike dhe Harry Trevlye Fultz". (Botim i rivështruar). Tiranë, 2010.

- Ilir Kanini: "Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore". (Zona e pushtimit Austro-hungarez, 1916-1918). Tiranë, 2001.

- Ludovik Shllaku: "Shkollat klerikale". (Vështrim historik nga fillimet deri në vitin 1924). Monografi. "Camaj-Pipa". Shkodër, 2002.

më 28.12.1992, të përbërë nga Prof. Bedri Dedja, Akademik; Prof. dr. Hysni Myziri; BVSH Qazim Kashari (udhëheqës shkencor i disertacionit); Prof. dr. Vilson Kuri dhe Prof. dr. Kujtim Bevapi (dy të fundit nga UE "A. Xhuvani"). Oponencat u mbajtën nga Dr. Mikel Prenushi dhe Prof. as. dr. Marjana Sinani (punonjëse e ISP).

- Pipa, Fehime: “Një shekull shkollë shqipe”, (1861-1961). “Shëjzat”, Romë, 1961, nr. 7-8; 1962, nr. 1-2; 1962, nr. 3-4; 1962, nr. 5-6; 1962, nr. 7-8; 1962, nr. 9-10; 1962, nr. 11-12; 1963, nr. 3-4.

- Zenepe Dibra: “Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane”, EBP “Gjegj Fishta”, Lezhë, 2015, Faqe 772,

- Zenepe Dibra: “Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane”, EBP “Gjegj Fishta”, Lezhë, 2016, Faqe 886.

- Smajl Bala: “Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës (1662-1945)” në dy vëllime: Vëll. I, Vëll. II. Shkodër, 2011.

- Fiqiret Hoxha: “Fletët e Jetës, histori pedagogjike ndër vite”, (Historiku i shkollave Rus, sot “Skenderbeg”), Botimet “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2010.

- Abdullah Poti: “Shkollat e mësuesit në Anën e Malit”, Shtëpia botuese “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2010.

- Kujtim Shimaj: “Historiku i arsimit në Zonën e Bushatit”, Shtëpia botuese “Pakti”, 2011.

- Njazi Kazazi: “100-vjetori i shkollës Normale të Shkodrës”, “Zani i Naltë”-Themeluar më 1923, Viti V, (XIX), Nr. 19 (172), Viti 2017, f. 44-49.

- Njazi Kazazi: “95- vjetori i Gjimnazit të Shtetit”, “Zani i Naltë”-Themeluar më 1923, Viti VI (XX)-Nr. 21 (174), Viti 2017, f. 51-60.

- Eljaz Kraja- Ahmet O. Osja: “Themelet e një Medreseje” (Fillimet e medresesë “Haxhi Sheh Shamia” si një institucion i ri arsimor), Shtëpia botuese “Camaj-Pipa”, Shkodër 2008. Faqe 229.

- “Medreseja e Shkodrës në vite” 2000-2010, Ideoi: Elona Sytari, Përgatiti për botim: Dr. Irida Hoti. Shtëpia Botuese “Progresi”, 2017, Faqe 238.

Ajo që na shtyu për t’i hyrë kësaj pune ka qenë qëndrimi zyrtar i partisë-shtet gjatë 47 vjetëve të regjimit komunist. Ky qëndrim është paraqitur zakonisht: në lënien në heshtje të këtyre shkollave, në denigrimin e tyre, pa parë asgjë pozitive tek ato.

Nga propaganda zyrtare “*Shkolla e vjetër feudo-borgjeze e paraçlirimit u godit rëndë si në përmbajtje, ashtu edhe në metodë*”, pasi Partia, e udhëhequr nga Enver Hoxha, përcaktimin e rrugës së zhvillimit revolucionar të arsimit në Shqipëri e realizoi “...në luftën që i bëhej shkollës së vjetër”. Në kushtet e një totalitarizmi të tillë dhe të një politizimi të tejskajshëm “...autorit i lejohet liria e mendimit në trajtimin e historisë, por brenda cageve ku ajo nuk binte në kundërshtim me disa postulate të ngurtësuara marksiste-leniniste.”²

Studiues - titullarë të këtyre fushave kanë theksuar se këto shkolla kishin “*frymë fetare e klerikale, reaksionare dhe antikombëtare, në shërbim të padronëve të huaj...*” dhe se ajo ishte “...shkollë me

2. Stefanaq Pollo, Skematizmi-dhunë në historinë e popullit, “Drita” 12.5.1991, f. 5.

karakter antidemokratik e mbi të gjitha me një frymë të tërbuar agresive antikomuniste” dhe më poshtë si për merak rithekson “një këshjtjellë (Kolegja Saverjane dhe Gjimnazi “Illyricum” - shënim i Nj. K.) e vërtetë e reaksionit kulturor dhe ideologjik në shërbim të të huajve.... me frymë jo vetëm antipopullore, por, siç thamë edhe antikombëtare.”

Pikërisht për të ndriçuar sadopak punën e mësuesve dhe të nxënësve të këtyre shkollave, ndihmesën që kanë dhënë ato në çështje kombëtare dhe në edukimin e breznive të reja, ndërmorëm këtë studim me dëshirën për të vënë në vend atë që është mohuar për gjysmë shekulli, për të zënë edhe ato vendin që u takon në historinë e arsimit shqiptar, këtë të drejtë të ligjshme që ua japin ditët e bardha të demokracisë që erdhën tek ne. Por, ashtu si për një poet tonin të njohur, edhe për mua “...demokracia nuk është një makinë elektronike llogaritëse për të gërmuar në koleksionet e gazetave dhe të revistave gjysmëshekullore dhe për të numëruar fjalitë dhe frazat e botuara nga njëri apo tjetri dhe për t’i përdorur si argumente akuzimi.”³

Natyrisht kemi synuar t’iu bëjmë të njohur studiuesve të arsimit, shkollës dhe të mendimit pedagogjik shqiptar, si dhe opinionit tonë në përgjithësi, disa probleme që lidhen me: hapjen e këtyre shkollave (kuadri i të cilave plotësohet në fillimin e viteve ‘20 të shekullit XX.); programet e tekstet

me të cilat kanë punuar; punën e mësuesve dhe nxënësve që dolën nga këto shkolla; vendin që zinin lëndë të ndryshme dhe formimi teoriko-praktik që jepnin ato; rregullsinë e punës në dokumentacionin shkollor; lidhja e shkollës me prindërit dhe njohja e opinionit publik me rezultatet e shkollave në fjalë; punën edukative dhe kulturore të shkollës; botimet për shkollën dhe kualifikimin e mësuesve; bazën materiale dhe bibliotekat shkollore, duke shërbyer si përvojë për punën e sotme dhe në të ardhmen.

1 - Shkollat Osmane (Shekulli XVIII- 1912)

Siç dihet, sundimi osman në Shqipëri vazhdoi për afro 500 vjet, por edhe gjatë kësaj kohe ka pasur njëfarë arsimit dhe kulture, ndonëse bëhej në gjuhët orientale me përmbajtje fetare, shkencore e letrare.

Është theksuar edhe nga studiues tanë të njohur se “...për sa u takon influencave të huaja, influenca turko-orientale në gadishullin e Ballkanit është koncentruar qysh në fillim kryesisht në qytete dhe së këndejmi u zgjerua pak nga pak duke u shtrirë dhe mbi katundet. Influenca turke ka qenë influencë qytetare, ajo shprehej si në jetën e përditshme sociale dhe shtëpiake, ashtu edhe në doke, zakone, në gjuhë e në muzikën popullore.”⁴

3. Dritëro Agolli, O tempora, O mores!, “Drita”, 13.01.1991.

4. Dr. Eqrem Çabej, “Për gjenezën e literaturës shqipe”, Shkodër, 1939, f. 7.



Shkollë, viti 1878, foto Marubi

Kështu, siç duket, ka ndodhur edhe në Shkodër, si qendër e një vilajeti. Por historia e saj e shekujve XV e XVI e deri në gjysmën e shekullit XVII është mjaft e errët, gjë që vërtetohet edhe nga historianë të huaj e shqiptarë, duke mos transmetuar kështu të dhëna të argumentuara dhe të plota edhe për gjendjen reale të arsimit në Shkodrën e kësaj periudhe. Ndër dëshmitë e para të kësaj periudhe është libri i udhëtarit turk Evlia Çelebi (1611-1684), i cili në vëllimet VI e VIII të veprës së tij 10-vëllimshe “*Seyahatname*” (përkthyer në shqip me titullin “*Shqipëria para dy shekujsh*” Tiranë, 1930), autori, i cili ka shëtitur

thujse gjithë vendin tonë, flet edhe për gjendjen arsimore të vendit. Çelebi jep të dhëna interesante dhe përshkruan me hollësi natyrën dhe gjendjen ekonomike-shoqërore. Për Shkodrën, veç të dhënave të tjera, si: Varoshi ka 15 lagje, 10 dejlane, banorët e Shkodrës janë kryesisht shqiptarë, që flasin krejt shqip, e të dhëna të tjera të rëndësishme me karakter historik dhe etnografik, thekson se: “... *ka dhjetë xhami dhe pranë çdo xhamie nga një medrese.*”⁵ Mendimi ynë është se këtu nuk bëhej fjalë për medrese në kuptimin e një shkolle të mesme (që u krijuan më vonë dhe për të cilat do të flasim më

5. Evlia Çelebi, veper e cituar f. 154- 161.

poshtë), por për një shkollë të ulët (mejtep) për mësim besimi. Është interesant fakti që sjell udhëtari turk për gjendjen klasore të qytetit, duke theksuar se “...*populli i Shkodrës është shumë klasësh: peshkatarë, ushtarë, tregtarë, detarë, industrialë, intelektualë*. (nënvizimi im Nj. K.) *e bujqit e vreshtave*”,⁶ gjë që na lë të kuptojmë se në Shkodrën e kësaj periudhe kishte njerëz të edukuar në shkolla vendase, ose në shkolla të huaja, dhe ua jepnin këtë kulturë në forma të ndryshme të tjerëve. Por fakti që intelektualët veçohen si grupim më vete, forcon mendimin e dhënë edhe nga studiues të tjerë për një arsim

dhe kulturë paraosmane në Shqipëri dhe se numri i intelektualëve nuk ishte i papërfillshëm.

Ndonëse nuk është objekt i studimit tonë, theksojmë se hallka kryesore arsimore e kësaj periudhe kanë qenë mejtepet (shkolla fillore dhe foshnjore). Në mbështetje të të dhënave dokumentare dhe të kujtimeve, apo të dëshmimeve të ish-nxënësve të tyre të fillimit të shekullit:

- mejtepet ndërtoheshin pranë xhamive të qytetit dhe të pazarit;
- në mejtepet e qytetit shkonin fëmijë të moshave të vogla, kurse në ato të pazarit edhe djem të moshave të mëdha;

⁶ Po aty, f. 160.



Mejtepi i xhamisë së Plumbit, foto Marubi

- kryesisht punohej me këtë radhë pune: a) u mësohej nxënësve në fillim arabishtja, duke u shkruar në një fletore Elifbaja, b) pastaj kalohej në Jasin, e cila mësohej përmendësh. Në klasat më të larta mësohej edhe matematikë e kaligrafi osmane.

Këtë e vërteton edhe një studim për mësuesit e hershëm të Shkodrës që mendohet se është bërë nga Z. M. Harapi, botuar në katër numra të revistës “Përparimi” (nr. 6-10 viti 1915), ku thuhet: *“Muslimanët janë përkujdesë për mejtepet e veta e zëll të madh kanë pasë që fëmijët xejshin posë punëve të fes së vet, sado pak me këndu, me shkeru e me ba hesap”*.

Kujtojmë se në shkollat osmane të kësaj kohe mësohej: *“gjuhë arabe, aritmetikë, kozmografi, Kur’an”*.⁷

Mejtepet ndërtoheshin nga ndonjë bamirës, ose përdorëshin lokalet e ndonjë vakfi.

- Nxënësit rrinin në gjunjë përpara hoxhës dhe kishin përpara stola të gjatë, ku mbështeteshin ose vinin librat.

- Nxënësit ishin të ndarë në rreshta, në vend të klasave çdo rresht konsiderohej një klasë.

Bashkëkohësit, sipas kujtimeve të njërit prej nxënësve të Molla Medos, z. Tahir Selim Kazazit, tregojnë se kishte disiplinë të fortë dhe nxënësit mësonin Kur’anin dhe mësimet të tjera për të cilat folëm më sipër.

7. “Enciklopedi pedagogjike”, Moskë 1968, f. 331.

- Mejtepet deri në kohët e vona janë njohur me emrat e hoxhallarëve që jepnin mësim në to, ose që i kishin hapur. Edhe sot kujtohen nga të moshuarit e Shkodrës. Një paraqitje të plotë të tyre ka bërë edhe z. Smajl Bala në librat e cituar.⁸

Në pazarin e Shkodrës, që nga shek. XVIII e deri në fillimin e shekullit XX përmenden se kanë punuar rreth 8 mejtepe.

Megjithëse nuk kemi gjetur ndonjë të dhënë të saktë për datat e fillimit të tyre, vetë emërtimi si në rastin që po përmendim: Mejtepi i Mulla Ferhatit të Mulla Tafil Dobraçit, (ku ka marrë mësimet e para Daut Boriçi)⁹, flet për vjetërsinë e tyre. Mejtepet e pazarit kanë vazhduar punën deri rreth viteve të para të shekullit XX. Pas kësaj kohe u shtuan mejtepet e qytetit, veçanërisht pas shtrirjes së tij, kur qendra e administratës u shpërngul atje. Sipas të dhënave na rezulton se në qytet ka pasur 10 mejtepe të tilla. Ndër më të njohurit është ai i Molla Medos.¹⁰

8. Shih më gjatë: Smajl Bala, “Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës, 1662-1945”, V. I, Shkodër, 2011, f. 26-58.

9. Shefik Osmani-Njazi Kazazi: shih më gjatë në “Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike” Botim i MASH dhe shtëpisë botuese “Idromeno”, Tiranë, 2000, f. 367. Shih për Daut Boriçin, f. 85-92.

10. “Do mësuesa të hershëm musliman në Shkodër”, “Përparimi” V. 1915, nr. 10, f. 184. Të dhënat janë marrë nga studimi i Hamdi Bushatit “Gjendja arsimore e Shqipërisë në

Mejtepe të tilla ka pasur edhe në fshatrat e banuara nga myslimanët të mbajtura nga imamët e xhamive në Bushat, Trush, Mëlgushë, Barbullush, Kosmaç, Bërdicë, Ana e malit, Krajë, Postribë, Guri i Zi, Ura e Shtrenjtë, Drisht, Reç, Repisht, Grizhë, Koplík, etj.

Perandoria osmane mbas reformave të “*Tanzimatit*”, nën shembullin e shkollave perëndimore, bëri disa ndryshime edhe në sistemin arsimor të saj. Në këtë mënyrë u dukën edhe në Shkodër shkollat e para katër klasëshe-iptidaje (fillore), ato tri-klasëshe (Rruzhdiqe ose qytetëse) dhe më vonë Gjinnazi katërklasësh-idadiqe.

Megjithatë, ndryshimet dhe plotësimet në planin mësimor i gjykojmë nga dëftesa shkollore të këtyre viteve (të konsultuara nga ana jonë), që janë një tregues konkret për këtë.

Si rrjedhojë e reformave të përmendura më lart edhe në Shkodër u hapën herë pas here shkolla të ndryshme, të cilat mund të klasifikohen në tre grupe:

a) shkolla foshnjore dhe fillore (mejtepi dhe iptidaje-4 klasëshe), ku hyjnë edhe inas mektebi (shkolla fillore e vajzave) dhe nemune-i kebir (shkolla model);

b) ruzhdiqe ose qytetëse 3-klasëshe (quhet edhe mektebi ruzhdiqe ose ruzhdiqe mylkije);

c) idadiqe (e mesme) të llojeve të ndryshme, si:

- idadiqe mylkije (gjinnazi civil), që duhet të jetë hapur në vitin 1906. Sami Frashëri në fjalorin e tij “*Kamus-i turki*” thekson: “*Kjo shkollë kryhet pas fillores dhe ruzhdiqes. Personeli mësimor përbëhet nga të huaj, kishte edhe 2 mësues shqiptarë. Shkolla me programe perëndimore, po bëheshin edhe gjubët e lindjes*”¹¹

- mektebi asqerie (shkolla ushtarake). Mektebi ruzhdiqe i asqerije (shkolla ushtarake osmane) e filloi punën në vitin 1901-1902, panë furrës së madhe ushtarake, (furra e Bejlikut). Punën mësimore e filloi në vitin 1902. Drejtorët ishin ushtarakë me grada të larta. Personeli mësimor përbëhet nga ushtarakë, klerikë e civilë. Tre nga 13 mësuesit që ishin gjithsej, ishin hoxhallarë të diplomuar në medresenë e Stambollit (Haxhi Ibrahim Kaduku, Molla Hysen Vuthi e Haxhi Hafiz Abaz Golemi) dhe jepnin lëndët arabisht, persisht e Kur’an; kurse i vetmi mësues civil, Sheuqet Kraja, jepte kaligrafi osmane dhe histori. Duke gjykuar nga dëftesat e kësaj shkolle mund të krijojmë një mendim të përafërt për planin mësimor të saj. Kështu, mësohej osmanisht, letërsi osmane, arabisht, persisht, frëngjisht, matematikë, gjeometri, algjebër, trigonometri, hartografi, histori, gjeografi, kontabilitet, vizatim e gjinnastikë.

11. Sami Frashëri: “*Kamus-i turki*”, V. 1317 h. (1900), f. 130.

periudhën osmane”, “*Shkodra dhe motet*” (Traditë, ngjarje, njerëz), Shkodër, 1999, f. 19-95 të ballafaquara edhe me studimin e Prof. dr. Sh. Osmanit “*Mësuesit e shkollat e para në Shkodër për gjubën e lirinë kombëtare*” në “*Arsimi popullor*” nr. 3, 1963.

Sipas statistikave të kohës, rrjeti i shkollave osmane, fetare dhe zyrtare, nga fundi i shekullit të XIX u rrit shumë. Më 1894-1895 ekzistonin 110 shkolla të tilla në qytete e në fshatra, nga të cilat 75 ishin të sistemit të vjetër dhe 26 të sistemit të ri. Ndërkohë që shkolla e mesme po rritej.¹²

Në bazë të një dëftese të klasës së dytë të gjimnazit, bëheshin këto lëndë: Rendi i dytë i Gjimnazit të Shkodrës, vjeti shkollor 327-328 (viti shkollor 1907-1908). Lëndët: mënyra e leximit të Kur'anit (Kur-ani qerim), mësim feje, arabisht, gramatikë osmane, njohuri qytetnimi, histori, gjeografi, aritmetikë, gjeometri, mësim sendesh, frëngjisht, vizatim e bukurshkrim. Në fund të dëftesës jepet sasia totale e pikëve, vlerësimi i sjelljes dhe numri i regjistrimit. Theksohet se nxënësi Hysen Efendi Kruja në këtë vit shkollor dha provimet e përgjithshme mbi mësimet e mësipërme dhe në bazë të notave fiton dëftesën. Firmoset nga drejtori i shkollës. Nota më e mirë e dëftesës në fjalë ishte dhjeta, pra, përdorej sistemi i vlerësimit me dhjetë nota. Shkolla kishte edhe një konvikt ku strehoheshin edhe nxënës të qyteteve të tjera, si: Tirana, Kruja, Kavaja, Tuzi, etj.

Darul mual-liminë (shkolla normale) u hap në Shkodër në vitin 1909. Ajo është një ndër shkollat e mesme osmane në Shkodër. Në

fillim kishte drejtor shqiptar, pastaj në drejtimin e saj erdhi i quajtori Mustafa Bej, me studime universitare të kryera në Paris. Drejtori i ri e pajisi mjaft mirë shkollën me orenditë e nevojshme dhe me personelin mësimor, duke arritur ta vërë atë në baza të mira në çdo pikëpamje. Shkolla kishte edhe konvikt për nxënësit e krahinave të ndryshme, që vareshin nga Shkodra. Sipas kujtimeve të të moshuarve shkodoranë ajo ka vazhduar mësimet në shtëpinë e Pashko Ashikut, në rrugën kryesore të qytetit (Pjaca e dikurshme). Shkolla kishte tri klasa. Nxënësit që kryenin apo vazhdonin normalen e lartë të Stambollit, punonin si mësues në shkollat fillore të Shkodrës

Mejtepi ruzhdije (shkolla qytetëse).

Me hapjen e këtij mejtepi, ruzhdijes së parë, për Shkodrën fillon faza e dytë e arsimit në këtë qytet. U hap në vitin 1858, në një godinë të ndërtuar në fund të kodrës së fushës së Tepes. Ndër të parët studentë që e frekuentuan këtë shkollë mund të përmendim Jusuf Golemin, Riza Koplkun, Myrteza Xhabinë, Ibrahim Dervishin (Sokoli), Jusuf Krajën, Musa Boriçin, këta mund të quhen dhe intelektualët e parë myslimanë civilë shkodoranë, që dolën nga kjo shkollë.¹³

12. Dr. Mikel Prenushi: *"Vështim historik mbi gjendjen e zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaj në Shkodrën e shek. XIX"* në "Studime Historike", nr. 3, 1974, f. 68.

13. Kabineti Pedagogjik: (Faik Luli, Islam Dizdari, Vehbi Hoti, Mikel Prenushi, Xhevat Repishti, Eljaz Kraja) në "Historiku i arsimit në Shkodër" (me shaptilograf), Pjesa I, 1980, f. 24.

Për të pasur një ide më të plotë për planin mësimor të shkollës po japim dy dëftesa që kemi gjetur në familje të vjetra shkodrane:

Zotni Musa Qazimi, nga nxënësit e klasës së parë të shkollës Ruzhdije të Shkodrës, mbasi iu nënshtrua provimeve të rregullta, si kusht i shkollës Ruzhdije, në përfundim, për aftësitë që tregoi në çdo lëndë, u vlerësua duke plotësuar me 245 pikë dhe iu dorëzua kjo diplomë.

Në fund të dëftesës rreshtohen emrat e katër mësuesve (tre nga të cilët janë shkodranë) dhe një sekretari, mes të cilëve edhe Daut Boriçi.¹⁴ Diploma vërtetohet gjithashtu edhe prej një komisioni prej 11 vetash, duke e zgjedhur nxënësin e lartpërmendur si “*Dallues shembullor*”. Viti 1278 h. (1857). Në diplomën e sipërme mungesa e lëndës “gjuhë osmane”, që mendojmë se duhet të ishte lënda kryesore, mbetet pikë e paqartë për ne. Mësuesi i shkollës

14. Tomor Osmani, Udha e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit. MASH, “Idromeno”, Shkodër, 1999, “Ilar”, Tiranë, (Rib.), 2008, 2012, f. 254-259.

- Shefik Osmani, Njazi Kazazi, Njëri nga të tre... (Vështrim për abetaret e Daut Boriçit) në përmbledhjen “Daut Boriçi-personalitet i shquar i historisë, kulturës dhe arsimit në Shqipëri”, Shkodër, 1996, f. 53-61.

- Pa autor, *Daut Boriçi, dijetar i shquar islam*. Në *Drita islame*, korrik, 2012, f. 46-47.

- Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, editor: Dr. Genti Kruja, Andrin Rasha, “Enciklopedi, 100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame, shekulli XIX-XX”, Tiranë, 2012, f. 307.

në fjalë Daut Boriçi, në vitin 1861, pasi mbaron normalen e Stambollit, emërohet si kryemësues i kësaj shkolle dhe po këtë vit lëshon edhe dëftesat e para. Kjo shkollë erdhi vazhdimisht duke u rritur. Kështu në vitin 1900 kishte 103 nxënës dhe 4 mësues.¹⁵ Kjo Ruzhdije e zgjeroi programin edhe në lëndë të tjera, ashtu siç na tregon dhe dëftesa e dytë.

Shkolla Nemuine-i Kebir ose shkolla model u hap si rrjedhojë e reformave të *turqve të rinj* (*shbonturqve*, shën. i redaksisë). Kjo shkollë ushtrimore u plotësua me orenditë e nevojshme në ndërtesën ku ka qenë Kabineti Pedagogjik (te shtëpia e Dan Hasanit) në fillimet e punës së saj (aty ku sot ndodhet pllaka përkujtimore e shkollës popullore të Shkodrës). Shkolla punonte me programe moderne. Drejtori ishte nga Stambolli, por kishte edhe mësues shqiptarë, si: Abdullah Efendi Kraja, Ismail Anamali, etj. Kjo shkollë shërbente gjithashtu edhe si shkollë ushtrimore, ku bënë praktikën edhe nxënësit e shkollës normale.¹⁶

Shkolla fillore e vajzave (inas mektebi) u hap në sheshin Rus-Haslikej. Ajo drejtohej nga mësuese të huaja. E ndiqnin vetëm vajzat. Veç programeve të caktuara, i jepej rëndësi edhe punës së dorës. E ndoqën disa vajza shkodrane, njëra prej të cilave u bë kryemësuese e kësaj shkolle pas shpalljes së Pavarësisë.¹⁷

15 Kabineti Pedagogjik: “Historiku i arsimit në Shkodër”, (Grup autorësh), Pjesa I, f. 34.

16. Hamdi Bushati, studim i cit, f. 11.

17. Po aty, f. 12.

Numri 4 TURRA (Sulltan Abdyl Hamiti)

E MADHNUESHME MINISTRI E PËRGJITHSHME E ARSIMIT
DIPLOMË E SHKOLLAVE QYTETËSE

Dituri Fetare Arabisht Persisht Gjuhë Osmanisht Ortografi e sintaksë
9 8 9 9 7

Aritmetikë Gjeometri Gjeografi Histori Kontabilitet Vizatim
10 10 10 10 10 9

Shkrim rika Shkrim sylyz
9 9

Shuma e notave: 119

Iljaz Efendi (Elez Sokoli) nxënës i klasës të katërt të shkollës qytetëse të Shkodrës lidhur me studimin e shkencave, të gjuhëve e të shkrimeve të shkollës u pa sipas provimeve se i përvehtësoi ato në masën e nevojshme dhe në bazë të notave prej 119 pikësh që fitoi si më sipër është klasifikuar “shumë mirë”.

2 dhjetor 1304 dhe 12 korrik 1333
(15 dhjetor 1888 – 25 korrik 1887)

Kjo diplomë i lëshohet të lartpërmendurit **për të hyrë në çdo shkollë qytetëse sipas dëshirës së tij, pa iu nënshtruar provimeve.**

(Dëftesa vulozet edhe nga një komision prej 7 anëtarësh dhe një sekretar i këshillit).

DREJTORI I ARSIMIT (VULA)
DAUT SHYQIRI (BORIÇI)¹⁸

18. Diploma është parë në original dhe është përkthyer në shtëpinë e mësuesit z. Xheladin Sokoli.

(Në fund të dëftesës jepen emrat e mësuesve dhe të deleguarve në provime, që na bën përshtypje se çdo lëndë ka pasur një të veçantë. Ndër emrat e mësuesve lexojmë emrat e mësuesve shkodranë Faik Kraja, Musa Qazim-Boriçi.)

Nga sa parashtruar më lart, mund të përmbledhim:

- Në shkollat e sipërshtënuara në përgjithësi, ndonëse me programe osmane, të gjithë nxënësit ishin shqiptarë, po kështu edhe pjesa më e madhe e mësuesve. Siç është theksuar edhe nga studiues të ndryshëm “...për historinë e pedagogjisë shqiptare ky tregues është me vlerë”.¹⁹

- Ka pasur raste që drejtorët ose mësuesit e profileve të ndryshme, veçanërisht për gjuhët orientale, me qëllim që të ngrihej niveli i mësimave dhe të forcohej puna e shkollës, ishin të huaj, që kishin përfunduar studimet në universitete jo vetëm në Orient, por edhe në Evropën Perëndimore.

- Institutet më të vjetra, medresetë, të hapura nga vezirët Bushatlinj, qenë vepra shqiptare, pasi mësimet shpjegoheshin shqip dhe mbaheshin me fonde shqiptare të siguruar kryesisht nga vakëfet e lëna posaçërisht për to.

- Dyert e këtyre shkollave ishin të hapura si për qytetarin, ashtu edhe

për fshatarin, duke u bërë premisë për bashkimin e popullit.

- Nxënësve fshatarë dhe atyre të varfër ekonomikisht u jepeshin ndihma në të holla, ushqime, rroba, etj.

- Prej shkollave të mësipërme, veçanërisht atyre të mesme, filloi të brumosej një shtresë intelektualësh në mjedisin e pashkolluar, e cila do të luante një rol jo pak të rëndësishëm në zhvillimin e arsimit e në përparimin e kombit.

- Veç edukimit fetar dhe edukues qytetar, në përgjithësi, në programet e këtyre shkollave jepeshin edhe njohuri të fushave të ndryshme shkencore, të lëndëve shoqërore dhe matematiko-natyrore. Veçanërisht i kushtohej kujdes përvetësimit të gjuhëve të huaja, të cilat shikoheshin si rrugë e si mjete për t’u vënë në kontakt me kulturën e vendeve të ndryshme të Lindjes e të Perëndimit.

- Nga këto shkolla dolën punonjës të sferave të ndryshme të jetës.

- Siç e theksuam edhe më lart, disa prej këtyre shkollave nuk u frekuentuan vetëm nga myslimanë, por edhe të besimeve të tjera, ashtu si në shkollat e klerit katolik ka patur nxënës të familjeve myslimane.

2. Dhe medresetë...


Është i njohur fakti se osmanllinj të nga fillimet e perandorisë i dhanë rëndësi të madhe shkollave të

19. Prof. dr. Jup Kasarati: “Kontribut për historinë e arsimit në rrethin e Shkodrës, deri në vitin 1912”, “Arsimi popullor” V. XVIII, Nr. 2, 1963, f. 67.

mesme të tipit të medresesë. Në këtë zë të fjalorit “*Kamus-i turki*” thuhet në mes të tjerave: “...vend ku merret mësim, medrese për mjekësi, për shkencë të larta dhe fetare.”²⁰

Është me tepër vend të citojmë se: “Përveç medreseve, shkolla turke të edukatës, në kuptimin pedagogjik të fjalës, nuk ka pasur në Shqipëri në 100 vjetëshat e 18-të e 19-të.”²¹

Është gabim të mendojmë dhe t’i merrnim medresetë si shkolla që kishin për qëllim vetëm përhapjen e fesë. “Medreseja është një institut islam që ka për qëllim me veprue mbi të gjitha klasat njerëzore dhe me ju shpërnda këtyre dituritë që ju hypen për me realizue idealet njerëzore dhe qytetnore.”²²



23

20. Sami Frashëri: “*Kamusi-i turki*” V. 1317 h. (1900), f. 1314.

21. Ilo Mitkë Qafëzezi: “Dhaskal Gjoka dhe shkollat e qëmoçme korçare”, Korçë, 1936, f. 93.

22. Çasht Medreseja? në “*Zani i Naltë*”, V. VI, janar 1931, f. 113.

23. Revista “*Zani i Naltë*”, nr. 4-5, Qershor-

Duhet theksuar se institutet islame “... tipin e vërtetë të tyre do ta gjejnë në medresetë e Andaluzit, Bagdatit e të Egjiptit të shek. IX e X dhe në atë të Stambollit të shek. XV”.²⁴

Për gjendjen e këtyre shkollave në Shkodër vlejné të dhënat interesante që jep Sami Frashëri në Fjalorin Enciklopedik “*Kamus’ul alam*” 1889, në vëllimin e dytë të tij, f. 997, ku thotë se: “*Qyteti* (Shkodra-shënimi ynë) ka ...dy medrese, një bibliotekë, një shkollë qytetëse, dy shkolla kristiane.”

“Më e organizuar dhe me nivel përdorimi i gjuhës shqipe u bë në shkollat me alfabet turko-arab, në Shkodër në shekullin XVIII, ku funksiononte “Kompleksi arsimor e kulturor”. Kjo dukuri nuk është e rastit. Ajo lidhet me lulëzimin e Pashallëkut të Bushatllinjve. Ashtu si Ali Pashë Tepena në Jug dhe Bushatllinjët në Veri, për afër gjysmë shekulli, sunduan gati të pavarur nga pushteti i Sulltanit, si nga pikëpamja ushtarake, ashtu edhe ekonomike. Por që të prodhojë e që të drejtojnë tregtinë, flotën, mijëra ushtarë, duheshin njerëz të mësuar. Prandaj lindi nevoja e hapjes së shkollave, që nga fillorja e deri te medresetë. “Kompleksi arsimor-kulturor” në Shkodër hodhi themelet rreth viteve 1760-1770. Aty bënte pjesë medreseja, komiketi dhe biblioteka”²⁵

Korrik, 1925, Viti II, f. 495.

24. Po aty, f. 114.

25. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, ISP “Histori e Arsimit dhe e Mendimit Pedagogjik Shqiptar”, (Akademik B. Dedja,

Që nga kjo kohë, Mehmet Pashë Plaku themeloi të parën medrese në shtëpinë e tij në lagjen Qafë. Ambienti ishte i mjaftueshëm për klasë mësimi, dhomën e myderrizëve dhe dhomat për fjetjen e nxënësve nga fshatrat.


Pedagogu dhe didakti i njohur, prof. dr. Shefik Osmani në zërin e FESH “Medresetë e Pashallëkut të Shkodrës (1881-1760), thotë: *“Medresenë e parë e ngriti në Shkodër kryeveçiri i dinastisë së Bushatlinjve Mehmet pashë Bushati, rreth viteve 1760-*

Prof. dr. N. Ceka, Prof. as. dr. S. Dedaj, Prof. dr. H. Myziri, Prof. as. dr. Q. Kashari, Prof. dr. Sh. Osmaini, Dr. I. Gogaj) V. I. Tiranë, 2003, f. 69-70.

*1770 në lagjen Qafë... dhe më vonë pranë Xhamisë së Madhe në Pazar që mori emrin Medreseja e Pazarit...”*²⁶ (ASHSH, FESH, f. 1677-1678.)

“Ajo ka qenë një ndërtesë që ka pasur 12 dhoma, me sallën e studimit, sallën e mësuesve (myderrizëve) si dhe sallat e dhënies së mësimi. Biblioteka e krijuar nga Mehmet Pashë Plaku, që numëronte dorësbrkrime fetare, letrare, juridike, gjuhësore,

26. Prof. dr. Shefik Osmani (1923-2012) didakt i njohur, autor dhe bashkautor i më se 40 veprave me karakter didaktik (e qindra artikujve) të cilat janë paraqitur në librin “Në gjurmët e një didakti” (Nga veprimtaria dhe trashëgimia e didaktit Sh. Osmani), të hartuar nga Prof. Dr. Njazi Kazazi, Botim i Institutit të Kurrikulës dhe Standardeve, Tiranë, 2005, f. 444.



Medreseja e Pazarit dhe Biblioteka e Bushatlinjëve
(njëkohësisht Qendra e Lidhjes së Prizrenit, dega Shkodër), Foto Marubi.

retorike, kozmografike, logjike, filologjike e bibliografike u bë një mbështetje e fuqishme për rritjen e nivelit të pedagogëve dhe studentëve”.²⁷

Pas ndërrimit jetë të Mehmet Pashë Plakut, i biri, Karamahmuti, kur erdhi në fuqi, i dha rëndësi të madhe zhvillimit të kulturës e të përparimit dhe hapi një medrese tjetër në Pazar, pranë xhamisë së madhe. Medreseja e Pazarit të Vjetër, është ndërtuar afër Urës së Bunës. Hapja e këtyre medreseve nga vezirët Bushatlinj, ndikoi njëkohësisht edhe në formimin e një kategorie civile, që nuk bëhej hoxhë, por merrte mësim në medrese për të mësuar gjuhën dhe literaturën arabe, me të cilën përgatiteshin për të ushtruar gjuhën osmane dhe të merrnin përgjegjësi të ndryshme në administratën shtetërore. Ndër këto shkolla morën mësimet e para dhe të mesme Daut Boriçi, Jusuf Tabaku, Hafiz Ali Ulqini, Ahmet Kalaja, Hafiz Halit Bushati, etj., të cilët përfunduan studimet e larta në Stamboll dhe punuan pastaj për shkollat shqipe në Shqipëri.

Qeveria osmane botonte herë pas here disa vjetore të quajtura “*Salname*”, të cilat përgjithësisht kanë të dhëna të ndryshme me interes edhe për historinë e arsimit në Shkodër. Në një *Salname* të tillë të Vilajetit të Shkodrës, viti 1313 h. (1892), gjetëm këto të dhëna:

- Drejtoria e arsimit përbëhej nga drejtori Mehmet Efendi, llogaritar Ahmet Efendi, sekretar- Fejzi Efendi.

27. Dr. Zenepe Dibra: “Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane”, EBP “Gjergj Fishta”, Lezhë 2016, “Medresetë”, f. 141-143.

- Këshilli arsimor përbëhet nga drejtori i arsimit, anëtarët Jusuf Efendi, Hafiz Ismail Begu, Muderriz Omer Efendi, sekretar Fejzi Efendi.

Veç të dhënave për shkollat qytetëse dhe fillore të qytetit që gjithsej kishin 9 mësues dhe 640 nxënës, në zërin faltore e shkolla lexojmë: “... *dy medrese, një bibliotekë, 17 shkolla islame, ortodokse, 5 katolike...*”²⁸

Në një *Salname* (Vjetore osmane) të vitit 1900, shkruhet: “*Medreseja në lagjen Qafë ka 32 nxënës, kurse Medreseja e Pazarit të Madh ka 55 nxënës*”.

Më 1925 u hap Medreseja e Re. “*Kjo medrese u hap me iniciativën e H. Ibrahim Kadukut, i cili u caktoi edhe drejtor i parë i saj. U ndërtua tek Ura “Dervishbeg” dhe ishte vazhdim i traditës së dy medreseve të mëparshme... Këtu kanë dhënë mësim personalitete që kishin mbaruar studimet teologjike në Universitetin e Stambollit, si H. Ibrahim Kaduku, Hafiz Jusuf Kaduku, Sali Efendi Myftia, Hafiz Mubamet Bekteshi, Hafiz Ymer Bakalli, Hafiz Hasan Tabmizi, etj.*”²⁹

28. *Salname* e Shkodrës 1213h. (1897) në M. P., f. 2, 3, e 9.

29. Dr. Zenepe Dibra: “Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane”, EBP “Gjergj Fishta”, Lezhë 2016, “Medresetë”, f. 142.



Medreseja e Re

Në vitin 29-1928, nxënësit morën dëftesat e pjekurisë. Në dëftesën e Hafiz Xheudet Zylja të cilën patëm rastin ta shikojmë) ka 14 lëndë, si më poshtë:

arabisht, besim, logjikë, shqip (ku përfshiheshin gramatika, këndimi, shkrimi, ortografia e hartimi), aritmetikë e geometri, shkencë (biologji), histori e gjeografi, vizatim e gjimnastikë. (Shih 2 fotokopjet e dëftesave).



30

30. Njazi Kazazi: “Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër (Nga fillimet deri në

“Medreseja e vitit (1944-1947). Shkodra do të bëhet ndër qytetet e para që ribap medresenë e vitit 1944, me iniciativën e Komunitetit Bamirës Mysliman... Kjo medrese u rikonstruktua te mejtepi i Molla Medos, pranë Xhamisë Plakë të lagjes Zdralej. Drejtor ishte Hafiz Esat Myftia dhe drejtor nderi Haxhi Hafiz Muhamet Bekteshi.”³¹

vitet ‘20 të shekullit XX)” (Monografi), Shtëpia botuese “Rozafa”, Shkodër, 2014, f. 180-181.

31. Dr. Zenepe Dibra: “Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane”, EBP “Gjergj Fishta”, Lezhë 2016, “Medresetë”, f. 143.





Mësues dhe nxënës të medresesë (1944-1947)

PËRFUNDIME:

Pas kthimit të lirisë së besimit, në vitin 1991 (12 dhjetor) u hap Medreseja “Haxhi Sheh Shamia”. Aktualisht (viti shkollor 2018-2019) vazhdojnë mësimet gjithsej 1134 nxënës, nga të cilët 474 djem dhe 660 vajza, ku ndër ta në maturë janë 141 nxënës, nga të cilët 96 vajza dhe 45 djem.³²

Medreseja ka marrë tituj: “Mirënjohje” nga MASH, në dhjetor 2011; urdhrin “Naim Frashëri i Artë” nga presidenti i Republikës, dhjetor 2011 me këtë motivacion: “Për kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e arsimit kombëtar, për edukimin dhe përgatitjen e nxënësve me dashuri për Atdheun dhe besimin islam, të aftë të përballojnë sfidat e kohës në shërbim të përparimit dhe zhvillimit të shoqërisë”; çmimin “Pishtar i dijes dhe arsimit islam në Shqipëri” nga KMSH, me rastin e 20-vjetorit të këtij institucioni.

32 Të dhëna të marra nga drejtori i medresesë “H. Sheh Shamia” z. Kujtim Dervishi (dt. 23.11.2018).

Literatura

- Pa autor, *Daut Boriçi, dijetar i shquar islam. Drita Islame*, korrik, 2012.
“Do mësuesia të bershëm mysliman në Shkodër”, “Përparimi” V. 1915, nr. 10.
“Enciklopedi pedagogjike”, Moskë, 1968.
“Zani i Naltë”, *Çasht Medreseja?*, janar 1931.
Agolli, Dritëro, *O tempora, O mores!*, “Drita”, 13.01.1991.
Bala, Smajl, *Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës, 1662-1945*, V. I, Shkodër, 2011.
Bushati, Hamdi, *“Shkodra dhe motet”* (Traditë, ngjarje, njerëz), Shkodër, 1999.
Çabej, Eqrem, *“Për gjenezën e literaturës shqipe”*, Shkodër, 1939.
Dibra, Zenepe, *“Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane”*, EBP “Gjergj Fishta”, Lezhë, 2016.
Enciklopedi, “100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame, shekulli XIX-XX”, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, editor: Dr. Genti Kruja, Andrin Rasha, Tiranë, 2012.
Frashëri, Sami, “Kamusi-i turki”, V. 1317 h. (1900).
Kabineti Pedagogjik: (Faik Luli, Islam Dizdari, Vehbi Hoti, Mikel Prenushi, Xhevat Repishiti, Eljaz Kraja) në “Historiku i arsimit në Shkodër” (me shaptilograf), Pjesa I, 1980.
Kasratrati, Jup, *“Kontribut për historinë e arsimit në rrethin e Shkodrës, deri në vitin 1912”*, “Arsimi popullor” V. XVIII, Nr. 2, 1963.
Kazazi, Njazi, *“Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër (Nga fillimet deri në vitet ‘20 të shekullit XX)”* (Monografi), Shtëpia botuese “Rozafa”, Shkodër, 2014.
Kolana “Zani i Naltë”, organ i Komitetit Mysliman Shqiptar, themeluar në tetor 1923, Vëllimi i Parë, vitet 1923-1924-1925. Editor Dr. Genti Kruja. Tiranë, mars, 2014.
Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, ISP *“Histori e Arsimit dhe e Mendimit Pedagogjik Shqiptar”*, (Akademik B. Dedja, Prof. dr. N. Ceka, Prof. as. dr. S. Dedaj, Prof. dr. H. Myziri, Prof. as. dr. Q. Kashari, Prof. dr. Sh. Osmaini, Dr. I. Gogaj) V. I. Tiranë, 2003.
Osmani, Shefik & Kazazi, Njazi, “Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike” Botim i MASH dhe shtëpisë botuese “Idromeno”, Tiranë, 2000.
Osmani, Shefik & Kazazi, Njazi, Njëri nga të tre... (Vështrim për abetaret e Daut Boriçit) në përmbledhjen “Daut Boriçi-personalitet i shquar i historisë, kulturës dhe arsimit në Shqipëri”, Shkodër, 1996.
Osmani, Shefik, *“Mësuesit e shkollat e para në Shkodër për gjubën e lirinë kombëtare”* në “Arsimi popullor” nr. 3, 1963.
Osmani, Shefik, *“Në gjurmët e një didakti”*, Botim i Institutit të Kurrikulës dhe Standardeve, Tiranë, 2005.
Osmani, Tomor, *“Udha e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit”*, MASH, “Idromeno”, Shkodër, 1999, “Ilar”, Tiranë, (Rib.), 2008, 2012.
Pollo, Stefanaq, *“Skematizimi-dhunë në historinë e popullit”*, “Drita”, 12.5.1991.
Prennushi, Mikel, *“Vështrim historik mbi gjendjen e zhvillimin e arsimit në gjubën shqipe e në gjubë të huaj në Shkodrën e shek. XIX”* në “Studime Historike”, nr. 1974 ,3.
Qafëzezi, Ilo Mitkë, *“Dhaskal Gjoka dhe shkollat e qemoçme korçare”*, Korçë, 1936.
Salname e Shkodrës 1213 h. (1897).

Mevlana Xhelaluddin Rumi Simbol i dashurisë (II)

Msc. Dorian Demetja
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Abstrakt

Në vitin 1244, Mevlana takohet me Shemsin, një dervish endacak, me sjellje të habitshme. Ky takim ua ndryshoi të dyve jetën. Në të njëjtën kohë, shënoi fillimin e një miqësie të fortë e të veçantë, të cilën, sufistët e shekujve të vonë, e shihnin si bashkimin e dy oqeanëve. Pas takimit me këtë mik të jashtëzakonshëm, Mevlana u shndërrua nga një dijetar me famë në një mistik të përkushtuar, poet plot pasion dhe në një simbol të dashurisë. Mund të thuhet se kjo ishte arsyeja që Shemsi e ndau Mevlanën nga të gjithë shokët dhe ndjekësit e tij. Kjo do të thotë se deshi t'i mësonte atij një qasje të re të dashurisë, me të cilën pasurohet jeta mistike spirituale. U kuptua gjithashtu, se ky ishte edhe shkakun që Mevlana sakrifikoi gjithë miqtë dhe veten e tij, duke qëndruar i vetmuar bashkë me të, deri sa e asimiloi mirë këtë dritë të vërtetë të misticizmit spiritual. Një gjë e tillë ishte një dburatë e madhe prej Zotit, të cilën nuk ishin në gjendje ta çmonin besimtarët e thjeshtë, përveç atyre që ishin të asaj rruge.

Gjendja e shekullit XIII

Shekulli i XIII shkruhet në histori si kohë e keqkuptimeve fetare dhe kulturore, si dhe e një farë pasigurie e frike ndaj tjetrit. Në kohëra si

këto, nevoja për dashuri është më e madhe se kurrë, sepse dashuria është vetë thelbi dhe qëllimi i jetës. Siç na e kujton Mevlana, ajo godet këdo, përfshi edhe ata që i shmangen, madje edhe ata që e përdorin fjalën 'romantik' në formë talljeje.

Beteja të pafundme për pushtet, zënka fetare dhe politike mbushnin shekullin e XIII, i cili që një periudhë vërtet e turbullt në Anadoll. Selxhukët, shteti më i fortë mysliman në atë kohë, ishte lodhur nga problemet e brendshme ndërmjet disa sunduesve myslimanë, që luftonin për fron, madje disa herë deri në vrasje të njëri-tjetrit. Në përfundim, kryqtarët, rrugës për në Jerusalem, pushtuan dhe plaçkitën Kostandinopojën, duke çuar në ndarjen e Perandorisë Bizantine. Në lindje, ushtritë Mongole u shtrinë në toka të gjera nën drejtimin e komandantit ushtarak Xhengis Kan. Ndërsa Bizanti përpiqej të fitonte tokat e humbura, pasuri e pushtet. Ishte koha e një kaosi të paparë, ku të krishterët luftonin kundër të krishterëve, të krishterët luftonin myslimanët, myslimanët luftonin myslimanët. Ngado ku ta ktheje kokën shihje vetëm armiqësi, ankth e frikë të madhe për atë që mund të ndodhte.

Mes këtij kaosi, jetonte një dijetar i shquar mysliman, i quajtur Xhelaluddin Muhamed, i njohur si Mevlana ose me emrin Rumi. Në Konja, në vendin ku ai jetoi, por edhe më gjerë, emri i tij qëndron në një lartësi të tillë, që edhe sot e kësaj dite, tetë shekuj nga koha kur jetoi, njerëzit nuk ia lejojnë vetes t'i drejtohen atij në emër, sepse u duket sikur ia errësojnë lavdinë. Mjafton të përmendim se sa rëndësi të madhe

ka ai ndërmjet elitës myslimane, të cilët, kur e përmendin emrin e tij, përdorin epitetin: “Mevlana”, që do të thotë “Zotëria ynë”. Ndërsa Rumi nënkupton Bizantin, pjesën lindore të perandorisë Romake.

Kush ishte Shems-i Tebrizi

Që të tregosh për Mevlanën, më përpara duhet të dimë për Shemsin, sepse nëpërmjet këtij dijetari të madh shpirtëror, Xhelaleddin Rumi hyri në rrugën e dashurisë hyjnore dhe pastaj u bë Mevlana. Emri i tij i plotë është Shemsuddin Muhammed bin Alij bin Malek, lindur rreth vitit 1180 në Tebriz të Iranit. Shemi ka qenë në shërbimin e shejh Ebu Bekr Selebaf'it për një periudhë kohore, por ka marrë pjesë edhe nëpër bisedat e shumë sufistëve të tjerë. Megjithatë, etjen për njohuri dhe përvoja më të thella nuk mundi t'ia shuante as shejhu i tij dhe as të tjerët. Ai ishte një sufist impulsiv dhe i papërmbajtur që nuk ia shtrinte dorën askujt përveç Allahut, që e thoshte haptazi pa u frikësuar atë që e konsideronte të drejtë dhe që nuk pëlqente njeri lehtë. Shemi Tebrizi kishte studiuar fusha të ndryshme të shkencës, sidomos misticizmin në nivele të larta. Ai kishte njohuri të thella për teologjinë, astrologjinë, astronominë, filozofinë dhe logjikën, por e fshihte gjithë këtë njohuri nga sytë e të paditurve. Ai kishte shkollim solid islam, në gjuhën arabe, dhe

ishite mysliman suni. Shemsi ndiqte medhhebin shafi', por shprehej me madhështi edhe për Ebu Hanifen. Ai ishte kritik ndaj disa mjeshtërvë të mirënjohur sufistë, bashkëkohës dhe më të hershëm, sepse ata nuk e ndiqnin mjaftueshëm shembullin e profetit.

Nasir Shemsi shkruan: "Shems-i Tebrizi nuk i pëlqente mistikët, ngaqë ata kishin braktisur shariatën. Ai nuk i donte fekihët, sepse ata jepeshin pas polemikave të padobishme dhe akuzimeve. Ai shmangej nga qëndrimi në seminare dhe teqe. Në vend të kësaj, Shemsi qëndronte në bujtinat e tregtarëve, duke e treguar veten si tregtar udhëtues. Ai hante shumë pak. Një porcion me bukë dhe supë ishte e mjaftueshme për disa ditë. Ai praktikisht e ngordhte urie veten e tij, si mohim ndaj unit". I biri i Mevlanës, Sulltan Veledi, e përshkruan Shemsin si njeri të ditur dhe të urtë, elokuent dhe të formuar. Ndërsa Baba Zamani, kryetar i strehës së dervishëve në Bagdad, ku dhe Shemsi qëndroi për disa muaj, në vitin 1242, e përshkruan atë si një burrë të gjatë, thatanik, me një hundë të mprehtë, sy të thellë e të zinj dhe flokë të errët, që i binin me kaçurrela të dendura përmbi sy. Baba Zamani thotë: "Nëse dervishëve të tjerë u duheshin muaj, ndonjëherë vite, për të mësuar një gjë të re, atij (Shemsit) i duheshin vetëm pak javë, ndonjëherë edhe ditë. Kishte një kureshtje shumë të madhe për

gjithçka të re e të panjohur dhe ishte vëzhgues mjaft i dhënë pas natyrës. Ai admironte simetrinë e rrjetave të merimangës, ose pikat e vesës që vareshin nga petalet e luleve. Insekte, bimë e kafshë sikur i interesonin dhe e frymëzonin shumë".

Në fakt, më mirë për përvojën e jetës së tij shprehet vetë Shemsi kur thotë: "Që kur isha djalë i vogël kam pasur vegime. Fqinjët ankoheshin te prindërit e mi, duke më akuzuar se sillesha çuditshëm dhe u trembja fëmijët. Njeriu i parë që i gjykoi keq vegimet e mia ishte im atë. Por vegimet nuk mu zhdukën as kur u rrita, madje u bënë më të dendura. E dija që prindërit merakoseshin dhe ndiheshin fajtor që i mërzisja, por e vërteta është se nuk dija si t'u jepja fund këtyre vegimeve, madje edhe po të dija, nuk doja t'u jepja fund. Kaloi njëfarë kohe dhe ika njëherë e mirë nga shtëpia. Që nga ajo kohë nuk reshta së qeni dervish endacak, gati 40 vjet. Nuk fjeta dy herë në një vend, nuk hëngra dy herë në një çanak, nuk pashë dy herë të njëjtën fytyrë para vetes. Kështu u enda në lindje e në perëndim, që të gjeja një jetë që ia vlente të jetohej dhe një dituri që ia vlente të dihej. Ngaqë nuk hodha rrënjë asgjekund, mund të shkoja gjithandej. Gjatë shtegtímeve kam ndjekur lloj lloj rrugësh, nga rrugët e mëdha e të rrahura tregtare deri te shtigjet e harruara, ku nuk shkëmbeheshe me asnjë shpirt të gjallë për ditë të

tëra. Nga brigjet e Detit të Zi deri te qytetet e Persisë, nga stepat e gjera të Azisë Qendrore deri te dunat e rërës së Arabisë, kam kaluar mes pyjeve të dendura, në kullota të sheshta dhe shkretëtira, kam qëndruar në hane të mëdha dhe bujtina, jam këshilluar me njerëz të ditur nëpër biblioteka të lashta, kam diskutuar shkrimet e shenjta dhe logjikën me nxënësit e medreseve, kam vizituar tempuj, manastire e faltore, kam medituat bashkë me eremitët nëpër shpella, kam përkujtuar Zotin bashkë me dervishët, kam agjëruar me të urtët dhe kam ngrënë me mohuesit, kam njohur popuj nga të gjitha besimet, moshat e zanatet dhe kam qenë dëshmitar i fatkeqësive, po aq sa edhe i mrekullive. Kam parë fshatra të rrënuara nga varfëria, fusha të nxira nga zjarri dhe qytete të plaçkitura ku lumenjtë ishin të skuqur dhe ku nuk kishte mbetur gjallë asnjë mashkull mbi dhjetë vjeç. Kam parë më të keqen dhe më të mirën e njeriut. Asgjë nuk mund të më habitë më. E di se po më vjen fundi në këtë botë. Nuk më shqetëson edhe aq shumë vdekja, sepse atë nuk e shoh si fund, por vdekja pa lënë pas vetes trashëgimtarë. Më duket sikur brenda gjoksit mbaj botë të tëra, histori që presin të tregohen. Dua që gjithë këtë njohuri t'ia kaloj një njeriu tjetër, i cili të mos jetë as mësues dhe as nxënës i imi. Më duhet një i barabartë me veten, një shok. 'O Zot, pëshpërita një herë mes errësirës së dhomës.

Gjithë jetën shëtita nëpër botë dhe ndoqa rrugën Tënde. Çdo njeri më është dukur si një libër i hapur që ecën. U qëndrova larg kullave të fildishta të dijetarëve dhe zgjodha ta kaloja kohën me të shtypurit, mërgimtarët dhe të dëbuarit. Tani po plas. Më ndihmo që t'ia kaloj diturinë Tënde personit të duhur. Pastaj, bëj me mua ç'të duash'. Për vite me radhë, iu luta Zotit për një shok që t'i jepja diturinë e mbledhur brenda vetes. Më në fund, në një vegim në Samarkandë, kuptova se duhej të vija në Bagdad që të përmbushej fati im". Shemsi kishte arritur në të gjashtëdhjetat dhe vazhdonte të ishte rrugëve, duke kërkuar shpirtin binjak. Dhe një natë, me këtë dëshirë të madhe, i përgjërohet Zotit kështu: "O Zot! Më trego një nga të dashurit e Tu të fshehur". Në vegimet që pati ai u pyet: Për çfarë je i gatshëm si falënderim për këtë? Shemsi, pa hezitur, u përgjigj: Kokën.

Pozita e Mevlanës para takimit me Shemsin

Bashkëkohësit e përshkruanin Mevlanën një burrë të pashëm, me trup të gjatë dhe të hollë, me sy të mëdhenj e të ndritshëm, me lëkurë ngjyrë gruri, me mjekër dhe flokë të rrallë. Mevlana ishte një njeri me mjaft ndikim në Konja që e admironin dhe e respektonin shumë njerëz. Edhe sundimtarët e asaj kohe kishin një respekt shumë të madh për

të. Kishte shkëlqyer në ligje, teologji, filozofi, astronomi, histori, kimi dhe algjebër. Me mësimet në medrese dhe predikimet në xhami, Mevlanës iu dha rasti të shprehte zotësinë e tij të madhe dhe kulturën e gjerë. Ai mori famë të madhe dhe nga ç'do anë mblidheshin njerëz e studentë për të përfituar nga dituritë e tij. Aq shumë iu shtuan ndjekësit, saqë, jo vetëm në xhami, rreth tryezës apo bankave të shkollës, por edhe gjatë rrugës nga shtëpia në medrese dhe e kundërta, ai ishte i rrethuar gjithnjë nga turma njerëzish, të cilët dëgjonin bisedat e tij të këndshme dhe e pyesnin për çdo gjë që kishin nevojë të dinin. Këta ndjekës nuk ia bënin fjalën dysh Mevlanës dhe e shihnin atë si udhërrëfyes, i cili do të sillte ndryshime pozitive dhe domethënëse në jetët e njerëzve.

Letra e Sejjid Burhanuddin

Emri i parë që të vjen ndërmend nga personat që ndikuan te Mevlana është i ati, Bahauddin Veledi, i mbiquajtur “Mbreti i Dijetarëve”. Pas vdekjes së tij, ndikim te Mevlana pati zëvendësi i të atit, njëkohësisht mësuesi i Mevlanës, Sejjid Burhanuddin Muhakkik Tirmidhiu. Ndërsa njëri nga personalitetet që ndikuan me veprat e tyre te Mevlana, veçanërisht para Shemsit, ishte imam Gazzali. Në këtë çështje, duhet theksuar ndikimi dhe rëndësia e Shemsit Tebrizit, i cili përbën një

pikë kthese në jetën e Mevlanës. Ai u bë shkak që te Mevlana të shpërthejnë urtësitë e dashurisë.

Ndërkohë që Shemsit Tebrizi vazhdonte të qëndronte te streha e dervishëve për një kohë të pacaktuar, në vitin 1243, Sejjid Burhanuddini i dërgon, nga qyteti i Kajserisë, mikut të tij Baba Zamanit, kryetarit të strehës së dervishëve në Bagdad, një letër me këtë përmbajtje:

“Bismil-lahirr-rrahmanir-rrahim. I dashur vëlla Baba Zaman, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ty...

Në Konja jeton një dijetar, për të cilin nuk e di në ke dëgjuar. Quhet Mevlana Xhelaluddin Rumi. Kam studiuar me të, fillimisht si mësues pastaj, pasi i vdiq i ati, si kujdestar i tij dhe, pas shumë vitesh u bëra nxënës i tij. Aq i talentuar dhe i mençur ishte, saqë erdhi një kohë kur nuk kisha ç'ti mësoja më dhe nisa të mësoja unë prej tij. Edhe të atin e kishte dijetar të shkëlqyer, por Mevlana ka një cilësi, që pak dijetarë e kanë: aftësinë për të gërmuar thellë nën mbështjellën e fesë dhe për të nxjerrë nga thelbi i saj atë xhevahir që është gjithëpërfshirës dhe i vazhdueshëm. Mevlanën e kam pasur si birin tim. I premtova të ndjerit, të atit të tij, se do të kujdesesha për të, por tani që jam plakur dhe më kanë ardhur ditët e fundit, dua të sigurohem që ta lë në shoqëri të mirë. Kështu pra, sado i shquar dhe i suksesshëm që është, Rumi ndonjëherë më është hapur e

më ka thënë se ndihet i pakënaqur nga vetja. Sikur i mungon diçka në jetë, ka një lloj zbrazëtie që nuk ia mbush dot as familja dhe as ndjekësit e vet. Një herë i thashë se ishte ende i njomë dhe nuk po e digjte zjarri, që duhet ta hapte portën e shpirtit dhe ujërat e dashurisë të rridhnin sa jashtë, aq edhe brenda. Kur më pyeti se si ta bënte këtë gjë, i thashë se kishte nevojë për një shok, një mik për të udhëtuar, dhe i kujtova çfarë thotë Profeti: “*Besimtari është pasqyra e besimtarit*”¹. Në fakt, nuk e di nëse gjendet ndonjë person i tillë në strehën tuaj, por nëse gjendet, ta lë ty në dorë që t’ia bësh të ditur fatin që e pret. Nëse ti dhe unë mund të luajmë ndonjë rol sado të vogël dhe t’i ndihmojmë këta dy lumenj të takohen e të rrjedhin së bashku në oqeanin e dashurisë hyjnore, nëse mund t’i ndihmojmë këta dy miq të Zotit të takohen, unë e quaj veten të bekuar...”

Shejh Sejjid Burhaneddin

Bashkimi i dy oqeaneve

Nuk ishte shumë e vështirë që Baba Zamani ta kuptonte se për kë bëhej fjalë në letër për të cilin kishte nevojë Mevlana. Ai e kishte kuptuar me kohë se Shemsi kishte një mision të veçantë në rrugëtimin e tij të vështirë. Gjithashtu e dinte shumë mirë se Shemsi po e priste një rast të tillë, sepse ai i kishte folur që në fillim

1. Ebu Daud, nr. 4918.

Baba Zamanit për qëllimin e tij dhe lutjet që i bënte Zotit për një shok, ashtu si thoshte ai, të barabartë me veten. Dhe me të marrë njoftimin nga Baba Zamani, Shemsi nisete për në Konja.

Mevlana, duke ushqyer gjithnjë idenë dhe dëshirën për të plotësuar brenda vetes boshllëkun shpirtëror që po e mundonte, në vitin 1244 rastis një dervish endacak i quajtur Shemsuddin Tebrizi. Takim si ky ndodh njëherë në jetë. Për Mevlanën, njëherë në 38 vjet. Këtë dervish me pamje të çuditshme, Mevlana e rroku me dashuri të madhe. Me lutje e përgjërime, e ftoi Shemsin në shtëpinë e tij dhe kuvendonte me të ditë e natë. Vetëm me të rrinte, me askënd tjetër nuk shihej e nuk takohej. Mësimet, predikimet dhe medresenë i braktisi. U largua nga shoqëria dhe filloi të shëtiste fushave, bashkë me dervishin, duke biseduar gjithnjë për njohuritë e brendshme dhe frymën mistike spirituale. Mevlana nuk i hiqte nga duart librat e të atit. Ai e donte shumë divanin e Mutenebbiut² dhe përparonte me Mesnevitë e Senait³ dhe Attarit⁴. Mirëpo këto ishin

2. Ebu Tajib Mutenebbiu është një nga emrat më të rëndësishëm në poezinë arabe që ka jetuar në shekullin e 10.

3. Hakim Senai është një poet dhe sufist pers që ka jetuar në shekullin ۱۲. Ai është themeluesi i stilistikës së mesnevisë mistike perse.

4. Feriduddin Attari është një poet dhe sufist i njohur pers që ka jetuar në shekullin 12. Ai

librat dhe fjalët e të tjerëve. Shemsi nuk duronte që Mevlana të flasë me fjalët e të tjerëve dhe të merrej me librat e tyre, sepse e shihte mirë potencialin shpirtëror që ai kishte. Mevlana ishte si një vullkan gati në shpërthim, prej të cilit njerëzit mund të përfitonin më shumë. Mjafton që ai t'i kthehej vetvetes dhe të dëgjonte zërin e zemrës. Shemsi ushtroi mbi Mevlanën një efekt të fuqishëm dhe transformues. Ai e shkëputi Mevlanën nga admiruesit, pastaj nga paria sunduese dhe e bashkoi atë me njerëzit e thjeshtë. Me besimin se çdo “idhull” që qëndron mes njeriut dhe Zotit duhet shkatërruar, përfshi famën, pasurinë, shtresat shoqërore, etj. Shemsi ia preu Mevlanës të gjitha lidhjet me jetën që ai njihte më parë. Pas një shoqërimi që vazhdoi me muaj në këtë mënyrë, Mevlana ndryshoi. Tashmë kishte veshur pelerinën e sufizmit dhe recitonte poezi, i dhënë në ashkun ose pasionin mistik. Në një nga bisedat me Shemsin, Mevlana kuptoi se sufistët nuk i motivon as frika e ndëshkimit në ferr, as dëshira e shpërblimit në parajsë. Ata e duan Zotin thjesht sepse e duan, pastër dhe thjesht, pa kushte dhe pa pretendime. Dashuria është arsyeja. Dashuria është qëllimi. Kur e do Zotin kaq shumë, kur e do secilën nga krijesat e Tij vetëm për shkak të Tij dhe vetëm falë Tij, pjesët e dukshme thjesht treten në ajër. Duke u nisur nga kjo pikë, nuk njihet edhe si doktor e farmacist.

ekziston më fjala ‘unë’. Gjithçka që mund të jesh atëherë është një zero aq e madhe saqë mbulon të gjithë qenien tënde. Mevlana tregon: “Që kur u fut Shemsi në jetët tona, njerëzit më pyesnin se çfarë më duket kaq e veçantë tek ai. Po nuk kam si të përgjigjem. Në fund të fundit, ata që bëjnë pyetje janë ata që nuk e kuptojnë, sepse kush e kupton nuk bën pyetje të tilla. Si mund t’ua shpjegoj dhe si t’ua mbush mendjen familjes, miqve dhe nxënësve të mi që të kuptojnë të veçantën e Shemsi Tebrizit?! A ka ndonjë mënyrë për ta kapur kuptimin e dashurisë pa rënë së pari në dashuri? Ajo vetëm jetohet. Dashuria nuk mund të shpjegohet, por ajo i shpjegon të gjitha”.

Në një kohë fanatizmi të thellë dhe përplasjes, Mevlana mbështeste spiritualitetin universal, u hapte dyert njerëzve nga çdo lloj shtrese. Në vend të një xihadi të orientuar nga jashtë, të përkufizuar si luftë kundër mohuesve, ai mbështeste xihadin e orientuar nga brenda, qëllimi i të cilit ishte beteja kundër sundimit të egos. Jo të gjithë i mbështetën këto ide, njësoj siç ndodh kur jo të gjithë njerëzit i hapin zemrat për dashurinë. Kur e do aq shumë dikë, pret që edhe të tjerët ta duan njësoj, duke iu bashkuar gëzimit e ngazëllimit tënd. Kur ajo nuk ndodh, habitesh, pastaj ndihesh i fyer e i tradhtuar. Kështu ndodhi me ata të dy. Lidhja e fuqishme shpirtërore mes Shemsit dhe Mevlanës u bë shënjestër zërash,

talljesh dhe sulmesh. I keqkuptuan, i patën zili, i fyen dhe së fundi, edhe më të afërtit i tradhtuan. Atëherë, Shemsi, të cilit i ishte thyer zemra nga fjalët dhe sjelljet e tyre, një ditë prej ditësh u largua papritmas nga sytë dhe ashtu i dëshpëruar, në vitin 1245, iku në Sham.

Kthimi i Shemsit

I biri e Mevlanës, Sulltan Veledi, thotë në librin e tij se miqësia e Mevlanës me Shemsin i ngjason shoqërisë së Hz. Musës me Hizrin. Hz. Musa a.s. megjithëse ishte profet, pati një kohë kur kërkonte një shoqërues shpirtëror, që t'i hapte "syrin e tretë". Dhe ky shoqërues doli se ishte Hizri, ngushëlluesi i të shtypurve dhe të përjashtuarve. Shoqëria e shkurtër me Hizrin ishte një përvojë që ndikoi shumë te Hz. Musai gjatë gjithë jetës. Njësoj si kjo, edhe Mevlana e ndjente nevojën e Shemsit. Këtë miqësi njerëzit e thjeshtë nuk e kuptojnë, por në fakt në të përfshihet mençuria më e thellë.

Ata që shpresonin se pas ikjes së Shemsit, Mevlana do të kthehej në gjendjen e mëparshme, që do të bëhej ai i cili kishte qenë më parë, u gabuan! Qëllimi për të cilin u përpoqën njerëzit ta ndanin Mevlanën nga dervishi, ishte që ta kishin për veten e tyre, por përsëri kjo masë nuk dha asnjë fryt, sepse Mevlana, jo vetëm që nuk i afrohej

atyre, por si i dërrmuar shpirtërisht dhe si një i dashuruar, e kërkonte Shemsin andej këndeje, recitonte poezi dhe nuk e zinte vendi. Sado që ata e larguan dervishin prej tij, dashuria spirituale midis tyre ishte aq e madhe, sa nuk mund të rrinin të ndarë nga njëri-tjetri.

Atëherë ndjekësit u bindën se kishin vepruar gabim dhe i kërkuan ndjesë Mevlanës. Ai e pranoi ndjesën e tyre. Dhe kur pas 15 muajsh, më në fund, mori lajmin se Shemsi ndodhej në Damask, e dërgoi të birin, Sulltan Veledin, së bashku me disa të afërm, për ta ftuar në Konja. Djali arriti ta gjejë dhe pas shumë lutjesh, mundi ta sjellë përsëri në Konja. Kthimi në Konja i Shemsit, të ndezur nga ndjenjat e dashurisë dhe miqësisë, e gëzoi jashtëzakonisht Mevlanën. Studentët e Mevlanës i kërkuan falje Shemsit dhe ai i fali. Çdo ditë dikush e ftonte Shemsin me Mevlanën diku. Pothuajse të gjithë përpiqeshin, me sa kishin mundësi, të shtronin gosti për ta. Por kjo gjendje nuk vazhdoi gjatë. Si për të kompensuar kohët e humbura, Mevlana u mbyll përsëri disa herë të tjera në kuvend kokë më kokë me Shemsin. Nisën përsëri thashethemet kundër tij. Në këtë intrigë të dytë, shumë më të ashpër se ajo e para, u përzije edhe djali i dytë i Mevlanës, Alaeddin Çelebiu. Në vitin 1247, një grup i përbërë nga studentët dhe të afërmit e Mevlanës u hodhën në veprim për ta zhdukur Shemsin. Kur dikush e njoftoi

Shemsin për komplotin që kishin ngritur për të, Shemsi i ktheu këtë përgjigje: “Bota është e ndërtuar mbi parimet e të ndërsjellave. Mos ki frikë nga komplotet, mashtrimet apo dredhitë e të tjerëve. Nëse dikush po ngre një kurth, mbaj mend se edhe Zoti po ngre kurthin e tij. **‘Allahu është planifikuesi më i mirë’**”. As edhe një gjethë nuk bie nga pema pa dijeninë e Zotit. Besoje pa pikën e dyshimit këtë. Çfarëdo që bën Zoti, e bën për mrekulli”. Shemsi e kuptoi urrejtjen që kishte mbërthyer një grup njerëzish, u mërzi shumë dhe u zhduk fare nga sytë e tyre. Askush nuk e mori vesh se ku shkoi, sepse nuk la asnjë gjurmë. Këtu u përhap fjala se dervishin e vrau djali tjetër i Mevlanës, Alauddini, por vëllai i tij, Veledi, në librin e vet e përgënjeshtroi kategorikisht këtë gjë. Zhdukja e dytë dhe e papritur e Shemsit, ndodhur në vitin 1247, ka mbetur një pikëpyetje deri në ditët tona.

Mevlana pas zhdukjes së Shemsit

Zhdukja e papritur e Shemsit e çorientoi Mevlanën. Vetë ai shkoi në Sham dhe shëtitu lagje më lagje duke e kërkuar Shemsin shtëpi më shtëpi, por më kot. Ky kërkim zgjati gati dy vjet dhe pastaj Mevlana filloi ta pranojë këtë gjendje. Ai e kuptoi që ndarja përgjithmonë nga Shemsi ishte një sprovë, apo një

5. Kur’an, El-Enfal, 8:30.

hap tjetër që duhet të ndërmerrete në rrugëtimin e tij drejt Zotit. Mevlana e dinte mirë se çdo gjë që ndodh, pavarësisht e vogël apo e madhe, dhe çdo vështirësi që del përpara, është pjesë e një plani hyjnor që punon në këtë drejtim. Nuk ka asgjë rastësore në kaderin e Zotit. Nuk qe rastësi as kur Shemsi i Tebrizit i doli përpara në 1244. Pavarësisht kësaj, ai natë e ditë recitonte poezi, s’e zinte vendi, s’gjente dot prehje e qetësi asnjë çast. Shumicën e vargjeve të Divanit të Madh prej afro 40 mijë vargjesh, e përbëjnë ato të recituara pikërisht në këtë gjendje shpirtërore. Për nderin e Shemsi Tebrizit, Mevlana filloi të shkruajë poezi mistike, të cilat të grumbulluara së bashku përbëjnë divanin e madh. Kësaj vepre nuk i vuri emrin e vet, por përdori në çdo gazel emrin e udhëheqësit shpirtëror, Shemsi Tebrizit. Ndërsa, kur me ndikimin e Shemsit, Mevlana arriti në një pozitë të lartë shpirtërore, filloi të shkruajë “Mesnevinë”, e cila nga pikëpamja mistike, njihet si një kryevepër.

Në 23 vitet e fundit, pas zhdukjes së Shemsit, Mevlana vazhdoi të mos merrej me nxënësit dhe këtë detyrë ia ngarkoi miqve të tij të formuar në pikëpamje shpirtërore. Në fillim argjendarit Salahuddinut dhe me vdekjen e tij, këtë detyrë ia ngarkoi kryetarit të fisit Ahi, Husameddin Çelebiut.

Mevlana ndërron jetë

Nga fundi i vitit 1273, Mevlana u sëmur rëndë dhe zuri shtratin. Doktorët nuk mundën t'ia ulnin dot temperaturën dhe as nuk mundën t'ia përcaktonin diagnozën. Në fakt, ai vetë nuk kishte dëshirë më të jetonte. Këtë gjë e kishin vënë re edhe mjekët, të cilët dalëngadalë po i humbnin edhe shpresat. Të gjithë njerëzit e qytetit të Konjës prisnin të shqetësuar, ndërkohë që Mevlana ishte i kënaqur në gjendjen e vet. Një ditë, shejh Sadreddin Konevi⁶ i vjen për vizitë dhe kur i uron shëndet, ai i thotë: “Tashmë shërimi dhe shëndeti qoftë i mbarë për ju, ndërmjet dashuruesit dhe të dashuarit ka mbetur shumë pak”. Edhe kur të tjerët vinin dhe i uronin jetë e shëndet, atij nuk i vinte mirë. Një herë kur gruaja e vet i thotë: - Ah sikur të jetoje nja 400 vjet dhe ta mbushje botën me dritat e së vërtetës, ai i përgjigjet: “Po pse, Firauna apo Nemruta jemi ne që të kërkojmë jetë të gjatë?! Ne nuk kemi ardhur në burgun e botës për të jetuar gjatë. Dëshira jonë është që një orë e më parë të mbërrim në kuvendin e Profetit a.s.”

Para se të ndërronte jetë Mevlana i la këto porosi atyre që

6. Sadreddin Konevi është një sufist i madh, nxënës dhe pasues i shejhut Muhyiddin Arabiut. Ai është themelues i misticizmit teorik dhe ka jetuar në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin qytet me Mevlanën.

kishte përreth: “Frikësojuni Allahut kudo që të ndodheni. Ju porosis të hani pak, të flini pak, të flisni pak, të ruheni nga mëkatet, të vazhdoni me namaz dhe agjërim, të shmangeni gjithmonë nga dëshirat trupore, të tregoheni të duruar ndaj mundimeve të njerëzve, të qëndroni me njerëz të mirë e të mëdhenj nga shpirti, si dhe të qëndroni larg njerëzve të ulët. Më i dobishmi prej njerëzve është ai që u sjell dobi atyre, ndërsa më e dobishmja e fjalëve është ajo që është e paktë dhe e saktë. Lavdërimi i përket vetëm Allahut. Paqe njerëzve të teuhidit”.

Varrimi i Mevlanës

Kur u dëgjua lajmi për vdekjen e Mevlanës, e gjithë Konja u ngrit në këmbë. Të gjithë, i madh e i vogël, fshatarë, qytetarë, grekë, hebrenj, turq... vrapuan në xhenazen e tij. Sipas porosisë së lënë nga Mevlana, namazin e tij të xhenazes do ta falte shejh Sadreddin Konevi. Por kur këtij të fundit i ra të fikët, pak para namazit, atëherë faljen e drejtoi njëri prej dijetarëve të mëdhenj të asaj kohe, Kadi Siraxhedin Urmeviu. Përveç myslimanëve, në varrimin e tij morën pjesë edhe njerëz të besimeve të tjera. U mblodh një turmë shumë e madhe saqë myslimanët kërkuan që njerëzit e besimeve të tjera të shpërndareshin. Mirëpo jomyslimanët dolën kundër kësaj kërkese duke thënë: “Nga fjalët e tij

ne kuptuam të vërtetat për Musanë, Isanë dhe të gjithë profetët e tjerë...”
Dhe: “Mevlana është si buka. A ka njeri që të mos ketë nevojë për bukë? A keni parë ndonjë të uritur që të ikë nga buka?!” Pas namazit të xhenazes, trupi i Mevlanës u varros

pranë të atit, në Konja, në vendin e quajtur Trëndafilishte. Në Kubenë e Gjelbër, ku është varrosur Mevlana, qëndron i shkruar ky epitaf: “Kur të vdes, mos e kërkoni varrin në tokë, por e gjeni atë në zemrat e njerëzve”.

Disa thënie të përzgjedhura të Mevlanës

- Eja, eja. Kushdo që të jesh, përsëri eja!
Edhe po të jesh mohues, zjarradhurues apo idhujtar, përsëri eja!
Selia jonë nuk është seli e pesimizmit!
Edhe njëqind herë ta kesh prishur pendimin, përsëri eja!
- Bëhu si ujëvarë në bujari dhe ndihmë!
Bëhu si diell në dhembshuri dhe mëshirë!
Bëhu si natë për t’i mbuluar të metat e të tjerëve!
Bëhu si i vdekur në nervozizëm dhe zemërim!
Bëhu si dhé në thjeshtësi dhe përulësi!
Bëhu si det në mirëkuptim!
Ose duku ashtu si je, ose bëhu ashtu si dukesh!
- Prej dashurisë ndaj trëndafilut, do i gëlltis gjembat.
- Dashuria nuk është në epërsi, në aftësi, në dituri, në fletore, në faqet e librave. A nuk bëjnë njerëzit thashetheme? Ajo rrugë nuk mund të jetë rruga e të dashuruarve.

Jo vetëm ata që flasin të njëjtën gjuhë, por edhe ata që ndajnë të njëjtat ndjenja e kuptojnë njëri-tjetrin.

➤ Fillo një projekt të madh, pa mend, si Nuhu⁷ (nga syri i të tjerëve) dhe do ta shihni se njerëzit do si do prapë do të flasin për ju, në të mirë dhe në të keq. A duhet të më shqetësojë kjo?! Asnjëherë. Le të shqetësohen ata që humbin kohën duke më gjykuar mua.

7. Profeti Nuh (a.s.), kur po ndërtonte një varkë në tokë, të gjithë filluan ta quanin të marrë, sepse kujtonin se përmytja që Hz. Nuhu i paralajmëroi më përpara, nuk do të ndodhte.

➤ Detyra juaj nuk është që të kërkon dashuri, detyra juaj është të jepni dashuri. Vetëm atëherë do të shihni se si do të largohen pengesat në rrugën tuaj, askush nuk mundet ta injorojë dashurinë për shumë gjatë. Përmes dashurisë gjithçka që është e hidhur do të bëhet e ëmbël, përmes dashurisë gjithçka që është e bakrit do të bëhet prej ari, përmes dashurisë e gjithë dhimbja do të kthehet në melhem.

➤ Vazhdoni e gërmoni në zemrën tuaj. Dhe mos harroni, kur dikush godet një qilim, goditjet nuk janë kundër qilimit, por kundër pluhurit në të.

➤ Nëse fjalët dalin nga zemra, ato do të hyjnë në zemër.

➤ Duke bërë si më thanë të tjerët, u verbova. Duke shkuar ku të tjerët më kërkonin, humba. Më pas u largova prej të gjithëve, edhe prej vetes. Kështu i gjeta të gjithë, edhe veten.

➤ Mos vajto. Çdo gjë që ti humbet, të vjen përsëri në një tjetër formë.

➤ Kur i bën gjërat nga shpirti, ndien një lumë që lëviz brenda teje, gëzimin.

➤ Mos u kënaq me histori, se si gjërat kanë ndodhur me të tjerët.

Shpalos mitin tënd.

➤ Injoroni ata që të bëjnë të ndjesh frikë dhe trishtim, që të degradojnë e të shpien drejt sëmundjes e vdekjes.

➤ Atje ku ka rrënoja, ka edhe shpresë për një thesar.

➤ Gjithçka në univers është brenda teje. Kërkoje gjithçka nga vetja.

➤ Kur kryen një gjynah menjëherë pendohu. Njeriu nuk mbytet kur bie në ujë, por kur nuk del prej tij.

➤ Në këtë botë, sprova jote është ajo çfarë dëshiron më shumë.

➤ Sa bukur e shpjegojnë flokët e dëborës mundësinë e bashkëudhëtimit pa dëmtuar njëri-tjetrin.

➤ Njeriu, ose duhet të ketë fjalë për të thënë, ose moral për të heshtur.

➤ Injoranti i ngjanë punës së daulles. Zhurmë ka shumë, por brenda është bosh.

➤ Njeriu me moral hesht prej moralit të tij, i pamoralshmi kujton se ishte ai që e bëri të heshtte.

➤ Mos e gjyko të kaluarën e askujt, mos harro se edhe elmazi, përpara se të përpunohej, ishte një copë qymyr.

➤ Mos e harro kurrë këtë o bir; drejtësia është një pasuri e shtrenjtë, nuk gjendet kurrë te njerëzit e lirë.

Literatura

- Abdulkaki Gölpınarlı, *Mevlana Celaleddin*, İstanbul 1959.
- Abdullah Hamiti-Urata Agagiyshi, *Interpretimi i këngës 'Neji' te Mevlana Xhelaluddin Rumi*.
- Ahmed Eflaki, *Ariflerin Menkabeleri*, çev. Tahsin Yazıcı, İstanbul 1986.
- Annemarie Schimmel, *Ben Rüzgarım Sen Ateş/ Mevlana Celaleddin Rumi'nin Hayatı ve Eseri*, çev. Senail Özkan, İstanbul 2000.
- Bediüzzaman Füzuanfer, *Mevlana Celaleddin*, çev. Feridun Nafiz Uzluk, İstanbul 1986.
- Cihan Okuyucu, *Mevlana*, İzmir 2007.
- Elif Shafak, *Dyçzet rregullat e dashburisë*, Përktheu Taulant Hatia, Tiranë 2011.
- Feridun b. Ahmed Sipehsalar, *Mevlana ve Etrafindakiler* (Risale), çev. Tahsin Yazıcı, İstanbul 1977.
- Irene Melikoff, *Batı Humanizmasının Karşısında Mevlana'nın Humanizması*, Mevlana: Yirmi Altı Bilim Adamının Mevlana Üzerine Araştırmaları (Haz. Feyzi Halıcı), Konya 1983.
- Mehmet Önder-İsmet Binark-Nejat Sefercioğlu, *Mevlana Bibliyografyası*, Ankara 1974.
- Menduh Bamja, *Mevlana, poet i dashburisë*, Referatë, 2013
- Mevlana Xhelaleddin Rumi, *Fibi ma Fib*, Çev. Meliha Ülker Tarkahya, 1954.
- Mevlana Xhelaleddin Rumi, *Mecalis-i Seba*, Türkçesi M. Hulusi, İstanbul 2001.
- Mevlana Xhelaleddin Rumi, *Poezi të zgjedhura nga Divan-i Shamsi Tabrizi*, përktheu Baba Qazim Bakallı, përshtati në shqipen e sotme nga Vehap Shita, Tiranë 2011.
- Mevlana Xhelaleddin Rumi, *Poezi të zgjedhura nga Masnavi Ma'navi*, Shqipëroi Dhori Qiriazı, Tiranë 2007.
- Mevlana Xhelaleddin Rumi, *Mesnevi*, Shqipëroi Mithat Hoxha, Shkup 2010.
- Nexhat Ibrahimı, *Mevlana Xhelaludin Rumi*, Referat, 2011.
- Nurettin Topçu, *islam ve insan/ mevlana ve tasavvuf*, İstanbul 1998.
- Reşat Öngören, *Mevlana Celaleddin Rumi*, DVIA, 2004.
- Said Türkoğlu, *Aşk Yolcusu/ Mevlana ile Aşk Yolculuk*, İstanbul 2008.
- Sultan Veled, *İbtidaname*, çev. Abdulkaki Gölpınarlı, Konya 2001.
- Şefik Can, *Mevlana/ Hayatı Şahsiyeti Fikirleri*, İstanbul, 1995.
- Şems-i Tebrizi, *Makalat* (Konuşmalar) çev. M. Nuri Gencosman, İstanbul 1974.
- Vahit Göktaş, *Mevlana-Şems Münasebetinde İnsan-ı Maşuk Felsefesi*, Tasavvuf İlmı ve Akademik Araştırma Dergisi, Ankara 2005.

Historia e personaliteteve shqiptare të Vilajetit të Janinës (1859-1909)

Syrja bej Vlora

Abstrakt

Libri i Syrja bej Vlorës “Historia e personaliteteve shqiptare të Vilajetit të Janinës (1859-1909)” është një punim enciklopedik me vlera të padiskutueshme për historiografinë shqiptare. Kjo për faktin se: e para, përbën përpjekjen e parë në këtë drejtim, në një kohë kur institucionet tona shkencore nuk ishin themeluar ende, e dyta, informacioni që ofrohet për disa personalitete historike përbën një risi.

Në një shënim të faqes një të dorëshkrimit shqip të këtyre biografive, përkthyesi Jonuz Tafilaj shkruan se ato janë përgatitur si aneks i veprës së Syrja bej Vlorës të përkthyer më parë nga Ali Asllani. Megjithatë, për nga volumi i tyre, këto biografi përbëjnë një libër më vete. Prandaj, duke pasur parasysh se ato nuk janë integruar më parë në asnjë version të librit tashmë të botuar të Syrja bej Vlorës, e sjellim për botim për herë të parë në revistën shkencore “Zani i Naltë”.

Ky dorëshkrim është shkruar në gjuhën osmane dhe, së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe, gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit-Tiranë. Ai ka 78 faqe në osmanisht dhe 120 faqe në gjuhën shqipe, të cilat janë përkthyer nga orientalisti Jonuz Tafilaj. Në inventarin e hartuar nga përgjegjësi i sektorit të dorëshkrimeve osmane në arkivin historik, orientalisti Haki Sharofi, shkruhet data e marrjes në dorëzim të këtij përkthimi (26 qershor 1963). Ndërsa për kohën se kur është shkruar nga Syrja bej Vlora, ende nuk kemi asnjë të dhënë.


Megjithëse ky përkthim në dorëshkrim është në dialektin verior dhe përmbante një sasi të konsiderueshme gabimesh, ne jemi përpjekur që të ndërhyjmë vetëm aty ku ishte domosdoshmërisht e nevojshme. Kjo, sepse dialektet, së bashku me përkthimet e realizuara në një periudhë të caktuar, janë një pasuri e jashtëzakonshme dhe mbajnë vlerën e kohës.

Në libër jepen të dhëna mbi personalitetet më të shquar të Shqipërisë së Jugut, e cila, nga pikëpamja administrative, në këtë periudhë, përfshihet në Vilajetin e Janinës. Aty flitet

shkurtimisht, e ndonjëherë edhe më gjatë, për formimin, rolin dhe kontributin e emrave të njohur të botës shqiptare. Madje, nuk mungojnë edhe detaje, të cilat, duke pasur parasysh se janë shkruar si pjesë integrale e një libri me kujtime, nuk gjenden në asnjë libër tjetër. Kjo e pasuron dhe e bën më të bukur për lexuesin, por edhe më të vlefshëm si burim historiografik për studiuesit.

Pavarësisht nivelit të përkthimit dhe gabimeve, botimi i këtij libri pjesë-pjesë të “Zani i Naltë” mendojmë se është i nevojshëm. Kjo si homazh për autorin e barruar dhe anatemuar padrejtësisht, për përkthyesin e nderuar, orientalistin Jonuz Tafilaj dhe, në fund, për historiografinë dhe memorialistikën shqiptare.

Dr. Hasan Bello



Syrja bej Vlora

1. Këtu bëhet fjalë për librin *Shqipëria pasosmane 1912-1920*, i cili tashmë është botuar në versionin origjinal i transkriptuar nga osmanishtja në Stamboll në vitin 2009. Në gjuhën shqipe ky libër është botuar në dy versione, me titullin *Kujtime-Nga fundi i sundimit osman në Lushitën e Vlorës*, (përgatiti për botim dhe redaktimi i përkthimit Akad. asoc. Marenglen Verli dhe Dr. Ledia Dushku) Tiranë: ICEBERG, 2013 dhe *Shqipëria pasosmane 1912-1920*, (përktheu nga turqishtja Rubin Hoxha) Shkup: Logos-A, 2015.

2. *AQSH*, F: S. Vlora, D. 8.

3. *Po aty*.

III

63. Ferit Pasha⁴

64. Fazli Pasha, Alizoti, gjirokastrit, grada Mirmiranë. Është djali i Fejzo bej Alizotit, pari e Gjirokastrës. Mbasi shërbeu nëpër shumë vende t’Anadollit si nënprefekt, u emënuë në Limnos si prefekt. Vdiq në Stamboll. Në kulturë që i kufizuem, dhe i cektë ndër gjykime. Çifligjet e Delinës dhe të Grykës, lan shkret, prej të cilëve kishte një t’ardhun prej dymbëdhjetë lirash në vjetë, m’i pat shitë mue për një mijë e treqind lira të verdha; dhe gëzohej se në këtë tregti ishim gënjye unë e jo ai. Kurse këto çifliqe prej pesmbëdhjetë mijë dynymësh, në vendin ma me randësi t’Adriatikut, në vjetin e parë dhanë një prodhim prej dyqind lirash të verdha; dhe vetëm atëherë Fazli Pasha mbeti për ballë një deziluzioni. Qe i butë në natyrë, por i shrrëgulltë në jetë.

4. Ky personalitet do të botohet veçant në revistën “Zani i Naltë”.

65. Fehim Efendi, Molla Demo, gjirokastrit, grada. Kadi prej Gjirokastre, biri i Molla Demos. Vesin e dredhisë dhe t'interesës personale e ka trashiguar nga i ati. Kënaqësia e tij qe me i thye zemrën të tjerëvet. Kryet e madh, trup të madh, konstrukcion atleti. Pak këndoj, por shumë dijt. Fjalët e sjelljet i pat t'ashpra. Fehmi Efendi qe Nënprefekt në Jenipazar kur Dervish Pasha erdhi në Kosovë me u ra shqiptarëvet. Shërbeu ashtu si e deshtën patronët e tij, dhe kështu rregulloi punët e veta. Kur Dervish Pashën e afroj Sulltani prej vedit tue i dhanë gradën e Komandantit të Përgjithshëm të Rumelisë, Fehim Efendinë e bani dhe ma për vehte Pashën me dhurata gjithfarësh. Mandej me mënyrat e veta hipokrite mbërrijti të bahet zëvendës-vali në Xhidde. Tash ma Dervish Pashën e ka prijës dhe me ndërmjetësimin e këtij u pranue, në mënyrë të veçantë n'audjencë prej Sulltanit. Në midis t'urdhnaveqë i dha Sulltani i tha edhe këto fjalë: "Njenin çelës të zemrës s'ime t'a dorëzova ty. Amaneti nuk tradhtohët, dhe shqiptarët nuk i dalin besës". Me këto fjalë Sulltani kishte dashtë me i thanë Fehim Efendiut provat e simpatisë që ushqente për të dhe për randësinë që i jepte. Fehmi Efendi në Xhidde gjet vali Topall Osman Pashën. Por me këtë s'mujt me da trofenë, megjithse qëllimi i të dyvet ishte i njëjtë, i përqendruem në një pikë të dobët; prandaj u hidhnun njeni

me tjetrin. Fehim Efendi u ftue në Stamboll. Si duket në Xhidde u kthye me urdhna ma të qarta e ma të gjana që mori nga Stambolli. Mu në këtë kohë u bashkue me Beqir Pashën, kur në Taif u vra Mid`hat Pasha me shokë prej duarve kriminale të një çete t'organizuar!! Por mbas kësaj ngjarje, Fehim Efendi u smue në Xheddak, kush e di nën përshtypjet e ç'farë ndisinash të trishtueshme dhe erdh në Stamboll gjallë. Sulltani çoj dy herësh njeriun e vet Besim bejnë për t'a pyetë hatrin, një herë me një dhuratë pesëqind lirash e herën tjetër me treqind lira. Kjo nderë e kjo përkëdhelje dhe kurat ba prej shumë mjekëve, nuk mundi me ia zgjat jetën. Fehim Efendi u da kësaj jete.

66. Jevzi Efendi, Janinas, grada Ula-Sinifi-Sani. Shum kohë qe Mektupçi (Drejtori Korrespondencës i vilajetit) në Janinë, dhe një kohë prefekt i Qendrës. Pat famë si njeri i mirë. Nuk mori pjesë ndër çështje kombëtare, as të mira as të dopta, sa me i lanë një emën vedit. Qe vetëm një ndër punësa të dalluem.

67. Fejzi bej Alizoti, prej Gjirokastre, grada Ula-Sinifi-Sani. Stërnip i Alizot Pashës prej Gjirokastre, djali i Hasan Beut. Fejzi beu kreu në Stamboll Mylqyen u gradue si atashe pranë valiut të Bejrutit. Mbrapa u gradua si prefekt në Korçë, në Prizren, në Pakëz (Kjos) dhe n'Ajdin. Në Bitlis qe

zëvendësvali. Kudo u provue i zoti dhe u njoft si një administrator i mirë. Në qeveri t'Ismail Kemalit qe një kohë Ministër i Brendshëm: por megjithëse akreba (farefis) i afërmi i tij, s'mujt të durojë feblesen e tij me tolerue ndërhyrjen e atij e këtij ndër punë qeveritare, dhe kështu e zemëroj Ismail Kemal in me kundërshtimet e tija.

Në qeveri të Princ Widadit si Drejtor i Përthshëm i Punëve të Brendshme, u orvat me ia kufizue Esad Pashës dorën e keqbasë dhe i qiti vedit trazojë e belana tue i dalë zot me inatë interesave kombëtare. Ndër persona që internoi Esad Pasha në Podgoricë bashkoj edhe Fejzi bejnë. Malazetët këta t'internuem i lanë t'unët, dhe ia mërzhitën jetën megjith farë torturash. Këta fatzezë qëndruen n'internim deri sa Austriakët zaptuen Shkodrën.

Në qeverinë që formuen në Shkodër Austriakët i ngarkuen drejtimin e financavet, për të fitue nga dijenia e eksperiencia e tij. Mbrapa u emëruë Ministër i Financavet prej Kongresit Kombëtar që u mblodh në Durrës.

Fejzi beu njeh mirë gjendjen e përgjithshme të Shqipnisë dhe psikologjinë e çdo klase të popullit. Të jep drejtime për çdo gjë, qoftë nga pikëpamja administrative qoftë nga ajo politike si me qenë një dikcionar i gjallë i përsosun. Ndjenjat kombëtare i ka të sinqerta e të vjetra. Në këtë rrugë nuk asht

si këpurdhat që mbijnë mbas shiut. Vuajtjet e tridhjetë vjetëve të jetës së tij politike, janë që të gjitha përfundimi logjik i ndjenjavet të tija kombëtare. Kur qe në Korçë e në Prizren prefekt përbuzi jetë e pozitë dhe tue marrë parasysh gjithfarë sakrificash i shërbeu interesave kombëtare. Në Korçë zhvilloi në popull dashurinë për atdhe dhe përkrahu formimin e një partie të krishtënësh botënisht. Me fjalë tjera ndihmoj së tepri në zgjimin kombëtar për rilindjen e një Shqipnie kundra rrezikut grek. Kur qe n'Ajdin si prefekt nxorri një fotografi, nën kontroll të xhonturqeve, bashkarisht me të birin Hasan begun, tue pasë ky në dorë një tabelë me fjalët "Rroftë Shqipniaa". Kjo provë e ndritun e patriotizmit ekstrem të Fejzi beut asht e pa imitueshme dhe ndoshta e teprueme, megjithatë për personin e Fejzi beut asht një dekoratë e madhnueshme.

Fejzi beu në fjalë e në punë asht i ashpër, por i rregullt e i disiplinës. Rrugës së shtrembët nuk ecën, punës s'i mërzhitet. Kënd s'ka frikë. Ndër mendime asht independent; pak dhe me natyrë...(e palexueshme- H. B.). I rregullt dhe në punë ekonomie, sa me mujtë me përballue ngushticat e jetesës. Jo gjeneroz, ndër shokë i shendshëm, por dhe zemërthyes.

68. Fejzi Pasha, Janinas, gjeneral Divizioni. Është djali i një notabli prej Janine. Karriera e tij

fillon prej Bylyk Eminit (intendanjer në Kompani) dhe dalë kadalë asht ba Kolonel. Në luftën turko-greke më 1897 ndodhej si Komandant në Prevezë, dhe me një qëndrim e guxim për t'u lavdue u bani ballë mësymëvet të grekëvet prej toke e prej deti. Në ushtarët shqiptarë kishte një besim të madh dhe sillej gjithmonë ndaj tyne si një babë me dhimbsuni. Mbas luftës u ba gjeneral brigade e mandej gjeneral divizioni. Shpërblimin landuer të vepravet të veta e gëzoj dhe la mbrapa një formë të mirë e të madhe. Në kuvend ishte i kandshëm, dhe i dashun me gjithken.

69. Kahrem Pasha, Vrioni, Beratas, grada Bejlerbej i Rumelisë. Është i biri i Omer Pashë Vrionit, i cili qe ba vali i Janinës, tue qenë nderue dhe me titull veziri më 25 Rabiulahor 1237 h (19 janar 1822) dhe i Ruh-Hajat hanëmit të vejës së Jahja beut, një ndër memelukët e Egjyptit që qe vra prej shqiptarit Mehmed Ali Pashës. Në vitin 1261 h (1845) plasi një kryengritje kombëtare, e provokueme prej Gjolekës nga Kuçi. Kjo kryengritje në dukje bahej kundra Tanzimatit, por kishte për qëllim me manifestue ndjenjat kombëtare. Në këto luftime u vranë Jusuf beu i vëllai i vogël i Kahraman Pashës dhe Islam beu e Sylejman bej Juga (Sylçe), t'afërm të tij që kishin marrë anën e qeverisë. Kështu dhe Kahrem Pasha, me shumë parësi të Toskënisë të cilët,

edhe këta, ishin me qeverinë e partizanë të shtypjes së kryengritjes. Kahreman Pasha (aso kohe bej) kishte fitue me këtë akt dhe ma tepër besimin e qeverisë. Kahreman Beut e Dervish Alimed Nasib Beut, parësi e Janinës i qe dhanë poja (titulli) Istabli -Amir; Hajredin beut, pari e Janinës dhe Naim beut e Fejzi beut, pari e Gjirokastrës poja e Kapëxhë-Bashit; Zenelabedin Efendiut, Myftiut të Gjirokastrës poja e Myderrisslëkut. Mbrapa Kahreman beu u ba prefekt i Janinës, me pojen e Mirmirranit e mandej si antar i Këshillit të Shtetit, formue së pari, me pojen e Bejlerbej i Rumelisë. Kahreman Pasha, tue ç'mue randësinë që do të kishte Fieri si pozicion në t'ardhmen e shtini në dorë dhe e bani, si mbas kohës, një qendër tregtie. Nuk dinte me këndue e me shkruue, por kishte mjaft prespektiva në jetë. Prej natyre qe i zgjuem dhe pati një karakter të fortë. Qe fort i pasun dhe fatin e pati gjithmonë të çmuet. I dhanun në dashuni ndaj të birit e t'afërmit e vet, qe modest e gjeneroz, diji me përfitue nga vendi dhe nga koha dhe ia kaloi shokëve në pasuni e në pozitë dinjitoze. Në Berat hapi një mulli të madh dhe me ujët e tij bani një bahçe në shembull paradizi. E shijoj jetën mirë dhe e jetoj në gëzime. Larg thanë-thacavet, kërkoj gjithmonë një jetë qetësie. Veçohet si krah i qeverisë. Simpatik në shoqni, dinte të ruente në çdo shoqni e kuvend nderen e dinjitetin e vet.

70. Konmenos bej Jorgaqi, prej Preveze, grada Ula-Simfi-Evvel. Qe një njeri që pati nderë e të mira prej Ali Pashës e Ferid Pashës. Me përkrahjen e këtyne mbërrijti deri ne kambën e të Ngarkuemit me Punë të Petersburgut. Mbas vdekjes së tyre, qe çue në Korfuz me kërkesë të vet si Kryekonsull. Lëvizjen e organizueme të Likursit ia lajmëroj që ma parë qeverisë dhe porositi nevojën e shpejtimit të një përgatitjeje ushtarake. Por qeveria s'ja vu veshin dhe s'besoj në fjalët e tij, tue thanë se janë fjalët e një kauri. Qe i zoti në njohuni politike, besnik ndaj qeverisë, dhe i dalluem në mes të shokëvet me virtytet e tija. Ishte i mendimit që Shqipnia të kishte një formë regjimi autonom, por nën kunorë të Perandorisë. Dhe për këtë qëllim përgatite pretekste dhe u mundonte me ia mbushë mendjen Portës së Naltë. Por nga ky shkak u nxuer në pension dhe u muer me përmirësimin e çifliqeve që kishte ne Prevezë deri ndër ditët e mbrame të jetës së tij. Grekët s'vonuen me ja zaptue pasuninë dhe me marrë nëpër kambë familjen e tij. Këto provuen se ishte i sinqertë e serioz në besnikrinë që tregonte ndaj shtetit dhe ndasinat që ushqente ndaj shqiptarëvet. Prandaj si një detyrë çmimi ndaj një ortodoksi midis personaliteteve të shtetit otoman, kujtoj me të mirë dhe emnin e Konmenso beut.

71. Qazim bej, Nureddin aga Zade prej Konice, grada Ula-Sinifi-Evveli. Fama e tij fillon ç'prej kohës që qe shef sigurimi në Stamboll. Shpesh bastiste qytetin dhe e bani të njohun personin e tij. Si autoritet policor fitoi simpatinë e të famshmit Marshall të Xhandarëmërive Hysni Pashës, u shtini drojën gjith subalternëvet të vet, me bastun në dorë me trup imponant, si një aga i vjetër i Ihtisabit (shef i Policisë Bashkiake dikur, sh. i përk.) Megjithse injorant në kulm, mujte me ja mëshef vehtes këtë mangësi dhe me largue të keqen prej vehtes. U internue në Janinë si Kryetar i Divanit t'Apelit. Në Gjirokastër e në Prevezë qe si Prefekt, dhe këtu pak a shumë ç'faq i ndjenjat e tij kombëtare dhe mbrojtje interesat e kombit. Me shumë parësi qe internue në Çanakkala. Këndonte me za të naltë disa fraza e vjersha që kishte mësue përmendësh turqisht e greqisht dhe mendohej me u dëftue i madh. I shkruante lutje Qemal bej Konicës, poetit të madh në za, dhe këto i shitëte si kapital të truvet të veta, tue vu në habi gjithkënd!! I tmerrshëm ndaj armiqve të vet, vendikatf dhe llafazan. Në krushqi me familjen e Dinojvet fitoj titull fisnikrie dhe bani pasuni. Vdiq n'Izmir ku qe prefekt. Në kuvend ishte i vrazhdë, por gjithmonë i shendshëm e burrë.

72. Qazim Pasha, Musa, Bendo, Gjirokastrit, gjeneral divizioni. Musa Qazim Pasha, agë nga një familje e mesme në Gjirokastrë, u edukue n'ushtri pa pasë një shkollë. Qe ndërmjet karidëvet (këtë fjalë të nënvizueme se kupton përkthyesi dhe as se ka gjetë ndër fjalorë) në za të regjimentave të Kalorisë t'Armatës IV. Qazim Pasha qe i zoti si i vëllaj Hilmi Pasha, por jo si ky me vese të dobta. Megjithse i randë ndër sjellje veti kjo e nderueme për një shef ushtrie qe prap i pajtueshëm me shokë, i drejtë dhe i arsyeshëm. Nuk pat ndonjë kulturë të naltë ushtarake dhe ndonjë eksperiencë të gjanë. Megjith këtë njeri fort i disiplinës dhe i zoti me ia ba tjetrit hatrin. Qe i ruejtun në të çfaqun të ndjesivet kombëtare, kujt s'i bani mirë dhe as që pa mirë prej tij ndonjë shqiptar. U rrit e u shkri porsi një mand!!

73. Qazim Pasha, prej Konice, gjeneral Divizioni. Bir i Hysejn bej Konicës, prej parisë së Konicës. Musa Qazim Pasha, lindi në Konicë në vitin 1237 h (1822), dhe bashkë me t'an shkoi në Stamboll ku kreu dhe mësimet. Ndërkohë shërbeu në zyrën sekrete të Divani-Humajumit (Oborrit mbretëror) dhe në Konicë e mandej hyni n'ushtri ku mbërriti dalë-kadalë me u ba deri gjeneral divizioni. La emën të pa harrueshëm me ndere e dinjitet të vedin. Vetëm uniforma që barte jepte provën e lidhjes që kishte me ushtrin, pse nuk

solli ndonjë shërbim ushtarak serioz. Qe poet, dhe në poezi imitoi Nefi-në dhe Fuzu-li-në. Pati vërtetë një vend të çmueshëm midis poetëve të lindjes. Si shumë poetë kishte një natyrë epikuriane, i lirë ndër koncepcione fetare dhe pijanec. Megjith këtë të varfnit i shikonte, jetimat i ndihmonte dhe u vinte atyne ndër nevojë që kishin; kurse ai vetë jetonte ndër ngushtica e ekononike. Prej gjuhës së tij trembeshin dhe eprorët e tij, dhe në çdo kuvend flitëte ashtu si i pëlqente. Ju lut një herë Ali Saib Pashës, Ministër Luftë, me i pague rrogat e mbrapambetuna. Ministri i Luftës urdhënoi Marshall Hasan Pashën, Ministrin e Shpenzimevet të Përgjithshme ushtarake t'i paguente dy rroga. Hasan Pasha e kishte ftue që t'i shkonte në zyrë. Vetëm për me i pague një rrogë. Qazim Pasha iu drejtohet atyne të dyvet me këto fjalë përbuzëse: ç'ka me ba, një muej e jep e një muej s'e jep⁵. Vdiq në Stamboll në vitin 1305 h (1888) dhe u varros ndër varrezat e Ebu-Ejub-Ensarit.

74. Qazim Efendi, Cipi, prej Gjirokastrë, grada Ula-Sënëfi-Seni. Mbaroi shkollën Mylqye (shkollë e naltë politiko Administrative, sh. i përk.). Memduk Pasha Ministër i Brendshëm, e pati me vedi si

5. Këtu ka një lodër fjalësh. Muejit i thanë turqisht "aj" dhe ariut "aji". Tue thanë se "një muej i jep e një muej s'e jep" "iu thonte atyne pashallarëvet njëkohësisht se "njeni ari e jep e tjetri s'e jep". (Sh. i. përk)

atashe kur qe vali n'Ankara, fitoi simpatinë e tij, u ba Mektupçi (Drejtor i Korrespondencës) i vilajetit të Ankarasë, e mandej prefekt n'Artugrull. Qe në midis të nëpunësavet korrekt e me kulturë, dhe la kujtime të paharrueshme nëpërmjet disa veprave që botoi.

75. Qani Pasha, prej Leskoviku, Jakup Agalliu, grada Bejlerbej. Djali i dytë i Rustem Pashës, Leskoviqarit, dhe po me mbrojtjen e tij pati funksione, deri sa u vu prefekt në Gjirokastër. Kështu qe dhe në punë administrate. Mbasi u doq Leskoviku nga dorë të mallkueme të grekëve, zgjodhi si vend banimi Selanikun dhe këtu jetoi me nderë. Vendit si bani as mirë as keq dhe nuk ia pa kush dobinë prej asaj, mori pasuni që iu grabit prej grekëve. Por as zemrën nuk ia thej kujt. Ndër ditë e mbrame të jetës së tij vuji dhe qe i smut. Nuk ushqej për kënd mëni. U varros në Selanik.

76. Qemal bej, Namik, Konica, nga grada Bala. Qemal beu që krenohej me qenë Shqiptar, qe një reformator i letërsisë otomane dhe yllë i ndritun i karvanit të letravet. Pati titullin e shkëlqyeshëm "Letrar i madh" dhe i etshëm për liri, muji me i dhanë gjith qartësinë stilit të vet me fjalët ma të reja e të spikatuna dhe me provue kulturën e tij të thellë. Në poezi qe ma i fortë se në prozë, stili i tij i pa imitueshëm

dhe shumë efikas. Ndër veprat e tij provohej patriotizmi i tij. Me veprat e veta të zgjedhuna që janë prodhimi i lirivet dhe i pendës së tij, i hapi gjuhës letrare turke një udhë të re, u ba simbol i letërsisë dhe bani që t'i njëhej ndera e fama ndër ata pjestar të kombit dora e të cilëve dihte me mbajtë pendën. Midis xhonturqve që u mblodhën për herë të parë në Paris, Qemal beu me qëndrimin e tij konstant, u ba shprehja e dëshirave të kombit dhe ndoshta flamurtari i shokëve të vet. Vdiq në Midili (Mytelenë) ku qe prefekt. Qe një letrar i nderuem që ia çmoj gjithkush vlerën. Asht shkruie aq tepër për Namik Qemalin, sa për mue do të qe pak sado që të shkruiejshem për të.

77. Maliq, Naili Pasha, Arslan Pashalliu, prej Libohove, grada Bejlerbej i Rumelisë. U njoftë në Shqipni për zotnues i një karakteri të ngultë dhe si pasanik. Megjithse analfabet, qe inteligjent e i kuptueshëm. Marrë zakonet e një shevaljeje. I rritun në një kështjellë të Libohovës, urreu kulturë e art jo vetëm për personë të tij por dhe për njerzit e shpisë, ato e konsideronin si një barrë. Shum pak e integrojnë ato që njeh, dhe rrin larg punëvet të qeverisë. Ka një natyrë të hollë sarkastike, dhe asht guximtarë. Kurrë gjat s'i bam përshtypje dhe për çdo gjat asht indiferent. Në shpenzime asht i ndalun, kështu dhe dhurata s'i ban kujt. Arin që futë një herë nder

qypa, s'e nxjerr ma andej. Kujtë pare si huante as nuk merrte prej kujt hua. Besim nuk kishte te kërkush. Në shpi ushqente një shumicë njerzë-bisha për t'u mbrojtë prej brigandash, dhe e kish zakon me u ndej larg njerzëvet të qeverisë. Kjo natyrë e tij rridhte, siç u thonte miqëvet të vet intim, nga ngjarjet e fundit që kisht psue daja i tij, Ali Pashë Tepelena e që ai i kishte pa me sy. Megjith këto ndisina e urrejtje që kishte ndaj qeverisë e qeveritarit, ushqeu n'ambicje me qenë i pajisun me ndonjë gradë qeveritare, dhe për me pasë një këso grade bante sakrifica. Kur Mustafa Asim Pasha Gjiridi (asht shqiptar, por mori këtë emën pse qe vali në Gjiridi- sh. i përk.) ishte vali në Janinë kërkoi ndihma prej pasanikësh me ba një ndërtesë shkollore, Maliq Pasha, tue dashtë me shfrytze këtë rast, kishte dhanë njëmij lira ndihmë, me kusht që t'i jepej (naltohej) paja në Bejlerbej prej asaj që kishte si Mirmiranë. Mbas vdekjes së tij kam shkue në Libohovë për kryeshëndoshë e ngushëllim të birëvet dhe me u ndihmue në çashtje trashigimi djalit të tij të madh dhe vjehrrit të Ferid Pashës, Adem beut. Në një vend ma në sy të dhomës ku qeshë përbutun më ranë në sy suazë prej një dërrase të thjeshtë e të pa botueme të varuna në mur. Ndër këto suaza ishin ngjitë dy fletë të salnames që përmbajshin gradat e titujt e disa personavet të shtetit.

Për djalin e madh, Adem begun, mendonte se do të jetë një trashigimtarë debamche që do t'ia qettë fundin trashigimit. Neki beun donte ma tepër ndër djelmë të vet. Trashigimin ua la baraz gjith djelmëve dhe thoshte se në mos ai vetë s'donte me u ba shkaktar grindjeje në mes të trashëgimtarëvet. Mbas vdekjes i kanë gjetë nd'arkë 64.000 lira të verdha dhe shum sende të kushtueshme. Ndër këto gjana të kushtueshme ndodheshin një bazubend dhe një hajmali që barte mbi vedi Ibrahim Pashë Vlora, megjith këllëfat e tyne të praruem si dhe një musaf (Kur'an) i lidhun me një mblojë të prarueme dhe ky bashkë me disa sende artistike që kishte pasë ble prej Sabri beut e Servet beut të birëvet të t'Ahmed beut. Në mes të plaçkavet të lanuna i asht gjetë dhe një fletore, ku kishte pasë shënue emënat e gjith atyne që i kishin pasë lypë hua e s'u kish pasë dhanë megjith shumat e kërkueme. Asht për tu çuditë se këto të holla kanë dalë krej baraz me sasinë e shumës së të hollave që ka lanë!! Maliq Pasha ka vdekë në vitin 1892 dhe asht varrosë në Libohovë, në Teqe të Sheh Mahmudit. Teqes i ka lanë disa dhurata; dhe birt e nipat e tij do t'i gëzojshin pasunie që ka lanë në Libohovë me kusht që të banojshin në këtë qytet. Maliq Pasha qe një njeri suigeneris me krejt kuptimin e fjalës, dhe një njeri që nuk u gabue ndër porosi e gjykime të veta për të zbulue të ardhmen.

78. Mehmed Ali Pasha, Selim, prej Delvine, Bejlerbej i Rumelisë. Mehmed Ali Pasha qe adjutant i Sulltan Abdylazizit që ditën që hyji ky në fron e deri që u shfronzue. Ditën që hyji në fron Sulltan Muradi doli nga pallati me gradën e Kolonelit. Në Vlonë, në Tarsos e n'Ajvallëk qe prefekt dhe për shërbime të çmueshme që dha ndër këto vende, u dërgua prefekt në Resmo e në Kandojë e ma mbrapa në Jenipazar, në Tokat e n'Amasja, gjithnjë si prefekt. Kaloi me vullnet të vet në Këshillë t'Evkafit si antar, tue shërbye në këtë post ma së miri, e mandej, prap me kërkim të vet u emënue prefekt n'Ajdin. Me çpallje të Konstitucionit dha dorëheqjen dhe kaloi në pension. Mbas proklamimit të Shqipërisë më vehte u largue prej Stambolli dhe u kthye në Shqipni, tue iu pre pensioni që ishte një e drejtë e tij. Në çdo funksion zyrtarë që pati u tregue një administrator i mirë, la një tok veprash të mira dhe si shpërblim pati prej Shtetit shkallë shkallë grada deri në Bejlerbej i Rumelisë dhe u nderue me dekoratat Osmani e Mexhidi. Qe nderue gjithmonë midis funksionarëve me virtyte të nalta. Mehmed Ali Pasha pati merita të nalta në sa që fitoi nderimin e dashuninë e gjithkujt. Qe dhe pjestar i një sekti fetar, një plak zemër mirë. U varros në Delvinë në Tyrben e Beqir Efendiut, në varr ku e pat pregatit në gjallni të vet. Kur vdiq qe në një moshë afër tetëdhjet

vjeç. Shkroi një vepër me shënime të ngjarjevet me randësi i të cilavet ishte qenë vetë dëshmitarë në jetën e tij; dhe aty n'atë vepër inseroj dhe shumë të vërteta historike. Qe i shoqi i motrës s'ëme ma të vogël Melek Hanëmit dhe djali i madh i Abdyl bej Selimit nga pari e Delvinës.

79. Mehmed Ali Pasha, Vrioni, Beratas, grada Mirmiranë. Është djali i madh i Hyjsen Pashës të birit Omer Pashë Vrionit dhe i Merjem Hanëmit të së bijës së Sulejman Pashë Toptanit. Qe një ndër të mdhajt të kombit t'onë, i çquem për kulturë e për patriotizëm kombëtar. Pranoj me qenë Serqerde (komandant) i bashibuzukvet (ushtarë vullnetarë të parregullt) që u mblodhën në Toskëni me qëllim që të shtypej kryengritja që shpërtheu në Hersekë në vitin 1293 h (1876). Në shpërblim të patriotizmit e të shërbimit të jashtëzakonshëm që tregoi me një herë fitoi titullin "Rutbei sanije Sënëfi Mytemajiz". Hoq shum mundime e vështirësi, dhe mbasi Bosnja-Hersegovina u pushtua prej Austriakëve mujti të kthehej shëndosh e me plaçka lufte bashkë me ushtarët e vet. Në vitin 1880, në mbledhjen Kombëtare që u mbajt në Prevezë, u dërgue n'Evropë me mision për të mbrojtë kërkesat t'ona kombëtare pranë Kancelarivet të huaja, dhe për të lehtësue barrën e randë që na kishte ngarkue Traktati i kobshëm i Berlinit; dhe ia arrijti sa

qe e mundun, me ia dalë me sukses misionit tij. Dikur qe prefekt ad interim në Vlonë e në Berat, mbrapa shkoj në Stamboll prej aty prefekt në Bajazid. Si u kthee prej andej provoj një fatkeqësi të madhe. Iu rrëzue prej kali dhe vdiq shoqja e jetës së tij Hysnije Hanëmi, e nderumja bi e Mehmed bej Vokopolës. Mandej u emënuë prefekt në Sakëz (Kio). Mehmed Ali Pasha kreu kudo me zotësi shërbimet e veta zyrtare, la kudo kujtime të paharrueshme. Qe gojtar (orator) e poet, dhe i dhanun mbas letërsisë së perëndimit e të lindjes. Recitonte shpesh vjersha që ishin të tija dhe që kishin një frymë kombëtare. Më tepër se me u marrë me punët zyrtare dëshronte me shpreh ndjenjat e tij poetike. Poezia tek ai kishte përmbajtje të ndryshme. Aq e mprehtë e pasun ishte fjala e tij sa që po të donte bante të qajë njerinë e po të donte e bante të qeshte. Ngjarjen ma të thjeshte e përshkruante me fjalët ma të kandëshme, dhe mund t' i jepte shpirt një gjajë të vdekun, kaq e fortë ishte fjala e tij. Në fytyrë ishte gjithmonë i qeshun dhe ndër sjellje tërhjekës. Nuk mburrej me pasuni, por dhe ngushtica ekonomike nuk e trembte. Nuk ishte tahmaqar dhe kapriçoz me pasë pasuni. Thanethashat nuk ia kandëte, bile ankohej për ambjentin ku merreshin nëpër gojë punët e tjerëvet. Beratasit i recitojnë pra vjershat kombëtare të Mehmed Ali Pashë Vrionit dhe kallzojnë ngjarje

që lidhen me personin e me jetën e tij private. Kena të drejtë me kërkue prej Eljas beut që të mbledhë veprat që ka lanë të shkrueme Mehmed Ali Pashë Vrioni, mbasi Eljas beu ka trashigue dhe kulturën e tij. Me një fjalë Mehmed Ali Pasha qe një presonalitet i çquem që nderoj kombin me virtytet e tija të nalta dhe me vepra që janë fryti i kulturës dhe i frymëzimevet të tija mendore. Vdiq në Serfixhe në vjetin... dhe u varros në varrezat e atij qyteti. Zoti e pastë mbulue me mëshirën e vet të pambarueme.

80. Muhtar bej, Mehmed, Tepedenli-zade, grada Ula-Sënëfi-Ula. Mehmed Muhtar bej, djali i vetëm i Selim Pashë Tepelenës lindi, u rrit dhe vdiq në Stamboll. Qe sekretar në Tophane, i zgjuet e i zoti dhe një shkrimtarë i mirë. Pati një gjuhë elegante, të mprehtë e sarkastike. Qe i kandëshëm e simpatik në kuvend. Mori një rrogë, e cila i qe pague prej pasunisë së tij së konfiskueme, sa me i mbyllë gojën dhe me i dhanë mundësinë me jetue varfënisht. La një vajzë vetëm dhe vdiq në vitin 1911.

81. Mustafa bej, Pasha, Shefqet, Janinot, grada Ula-Sënëfi-Evvel. Është i biri i Ahmed Pashës të birit Ismail Pasho Pashës, i cili qe përkrahë një herë prej Halit efendiut dhe i qe lëshue në shpindë si shemër (rival) Ali Pashë Tepelenës por që mandej

qe vra në rrugë të Filibesë dhe i qenë marrë nga dora sanxhaqet e Janinës e të Delvinës me shkas se vu në pozitë të keqe ushtrinë e Janinës më 25 të Muharremit të vitit 1237 (22 tetor 1821). Në Shqipni u lidh në krushqi me shumë familje të para, në Janinë i shkoj fjala, për këdo qe një person me autoritet mbasi fjala i ndërëgjohej. Në të parin parlament otoman u zgjodh deputet dhe fitoj famë, por mandej, si u mërgue Mid`hat Pasha dhe u mbyll parlamenti u dëbue dhe ky prej Stambolli. Qe njeri me kulturë, administrator i mirë dhe i zoti. Dhe ky ishte bashkë me pari të Shqipnisë që u internue në Çanakkala dhe pati pjesë ndër të tana mbledhjet kombëtare. Qe një gastronom i madh dhe njeri dëfrimesh. Por kah fundi i jetës vuejti shumë dhe bile u çmend. Me trup qe i madh, në bisedë i kandëshëm. Vdiq në Janinë dhe u varros në varrezat e familjes së tij. Tue qenë Mirmiranë u naltësue në gradën Ula-Evveli, prandaj morri titullin Pashë.

82. Mustafa Pasha, Psura (Psara), Janinot gjeneral Divizioni. Kur qe n'Elbasan major batalioni e kaloi kohën midis sazevet e çingjijevet!! i ardhun në Stamboll gjeti rastin me fitue dhe ma fort simpatinë e Serasqer Ali Sabri Pashës e ma mbrapa Serasqer të Riza Pashës, dhe kështu, i përkrahun prej këtyne u ba i hartueshëm. Mandej si Indendant i ushtrisë u ba një autoritet që i

drejtoheshin i madh e i vogël. Ndër veprime të zyrës që pat u tregue njeri i disiplinës, ndihmoj atë që njofti, veprat i pat të mira dhe u provue një administrator i mirë. Qe ushtarë i karrierës (regjimenterë), por ma fort se me punë ushtarake direkt u muer me çashtje administrative t'ushtrisë. Me gjithse prej Janine, shqipen e flitte krejtësisht bukur dhe thonte se është lindun shqiptar. I kandej me qenë me shqiptarë gjithmonë në kontakt. Në jetën private e në sjellje qe i lirë, s'la konditë, ceremonitë, dhe u njoftë për një gjeneral, të cilit i pëlqente të jetonte në qetësi e i dizenteruesem!!

83. Mustafa Efendi, Budo, prej Gjirokastre, grada Ula-Sënefi-Evveli. Qe mjek i dalun prej fakultetit të Mjeksisë së Stambollës. Inteligent e i zoti në profesionin e tij. Në Janinë i doli fama për zotësi. I mbrojtun prej Tatar Osman Pashës, u ba njeri me autoritet në Janinë dhe mandej iu shtue fama e ndera kur u emënuë Inspektor i Shëndetësisë në Stamboll. Pati ndjenja kombëtare, qe i kujdesun në punë dhe patriot. Prej të lodhmes e prej vujtjevet u kthye në Gjirokastër me duer thatë, dhe luji mëndsh. Vdiq në Gjirokastër.

84. Mustafa Pasha, Neshet, Çeço, Janinas, grada Bejlerbej i Rumelisë. Mustafa Pasha, i një familjeje me za të Janinës, qëndroi shumë kohë në Gjirid si mektupçi (Drejtor Korrespondence vilajeti)

dhe prefekt ndër disa prefektura. U tregua një administrator i zoti. Me sjelljet e tija arrogante i theu zemrën kujdo që njofti, dhe qe skrupoloz në punë. Megjith këtë në çdo nëpunsi që pati ruajti dinjitetin e vet, njofti mirë punët e veta; dhe la një pasuni të konsiderueshme. Qe i internum në Çanakkala me parinë shqiptare, por ma tepër për shpifje që i ban se sa për interesimin që tregoj ndër çashtje kombëtare.

85. Mustafa Pasha, Kolonja prej Kolonje, gjeneral brigade. Në kohët e fundit të sundimit të Sulltan Mahmudit u regjistruar në muzikën mbretnore dhe prej këtu përparoi. Mbasi shërbeu ndër shumë funksione ushtarake dhe dha kontribut të mirë, u emënuar ma në fund Koloneli i Redifëve (rezervistëve) të Gjirokastrës. Mori pjesë në luftën turko-greke të 1897-ës, ia mbrini si Hizri të Pes-Pusat ku pësoj një disfatë armata e Lorosit dhe me shpatë në dorë dhe me fjalët “o burrani djem,, në gojë u hodh me një shkathtësi djaloshi e me një eksperiencë plaku në luftë, tue shkatruar ushtrinë greke e tue i dhanë një jetë e guxim të ri ushtrivet otomane. Me një fjalë qe një nder krenë shqiptarë të guximshëm t’ushtrisë otomane. Kultura e tij qe e kufizuar. Në bisedë qe i kandshëm pat sjellje të mira dhe disiplinë n’administratë ushtarake. I ndershëm e gojë-ambël, fjalën fjalë e me karakter burri. Tue qenë në moshën tetëdhjetë vjeç e në pension vdiq.

86. Mustafa Bej, prej Konice, grada Ula-Sënëfi-Evveli. Detyra e tij zyrtare qe Drejtor i Bonovet të Trezorit, por u mor dhe me astrologji. Famën e pat vetëm nga i ati, pse qe i biri i Namik Kemal beut. Ishte nip i Abdyl Latif Pashës. Qe i ndershëm e zemër mirë. Rrnoj shumë, por gjithmonë me zemër të mjerume nga vujtjet e të birit. Fukaranë e shikonte; qe një bamirës me cilësitë e një njeriu të mirë.

87. Mustafa Pasha, Nuri, Vlora, prej Vlore, grada Bejlerbej i Rumelisë. Mustafa beu rrin indiferend kundrejtë ngjarjeve të ditës dhe veprimeve administrative e merret vetëm me mësimet e veta. Megjith këtë mbas disa kohe në Shqipni pëlçet një kryengritje për me kundërshtue zbatimin e vendimeve të marruna me rastin e proklamimit të Tanzimatit. Mustafa beu, i vëllai e nipat me tjerë të parë shqiptarë internohen në Konjë si organizator të asaj kryengritje. Mustafa beu vjen në Konicë plot njëmij e tridhjet e tri ditë. E vetëm fill mbas emënimit të Ismail Rahmi Pashë Tepelenës. Si vali në Janinë për të parën herë me ndërmjetësimin e tij falen e lirohen prej internimit një herë Mustafa beu e mandej tjerët. Ismail Pasha, i cili në personen e Mustafa beut sheh njeriun inteligjent e t’aftë, i jep këtij për shoqe Naile Hanëmin bijën e Aishe Hanëmit, të cilën Ismail Pasha e ka motër. Kështu Mustafa beut i hapet

rruga e një fati të bardhë. Bejlerët që u internuen në Konicë, për pasunitë e tyne që kishin në zotnim si ajanë (notable, fr.) të Vlorës s'kishin pague të dhetat për gjasht vjet në Vlonë, dhe qeveria kundrejtë detyrimevet të tyne që kapeshin gjashtqindmij e sa grosh, u kishte zaptue pasunitë dhe administrue nga ana e saj. Mustafa beu ma së pari iu hyni punës që të shpëtonte pasunitë e konfiskueme. Prej kësaj pasunie vetëm një mulli në Gremenicë kishte mbetë i lirë, jashtë konfiskimit. Këtë mulli e kaloj mbi të shoqen. Shiti mandej çiflikun e Radhotas që ishte mbi të shoqen dhe paret e tij, dy treqindmij grosh, ia çoj Hurshid Pashës, vali i Rumelisë që kishte selinë në Manastir. Kështu shpëtoi pasuninë nga konfiskimi. Mandej Mustafa beu ngrahi një konak madhështor në Janinë dhe këtë qytet zgjodhi për vend banimi. Këtu Mustafa beu u ba njeri me influencë dhe fitoj famë. Por paria e Janinës e shikonte me sy rivali dhe s'pushonte s'atakuemi. Dhe ky rivalitet i sollë mjaft trazime Mustafa beut. Pse paria e Janinës imituen vulën e tij, dhe sendergjuen një sened. Por për fund, gjykatorja e naltë në Stamboll nxorri në dritë të vërtetën, dhe Mustafa beu shpëtoi nga një gajle të madhe. Në vitin 1278 h (1861) u emënuë prefekt në Gjirokastër, një vit mbrapa në Korçë e prap mbas një viti në Nartë. Por prej këtu dha dorëhjekjen e shkoi në Stamboll. Në vitin 1283 h (1866)

u krijua rishtas valillëku i Tunës, ku u emënuë vali Mid`hat Pasha e Mustafa beu ndihmësi i tij. Deri në vitin 1286 h (1869) Mid`hat Pasha e pat Mustafa bejnë shokë e përkrahës ndër të gjitha reformat e veprat e tij. Kur Sulltan Abdylazizi kthehej prej udhëtimit të tij t'Europës nëpër Rusxhuk e emënoj në Mabejnë (në Pallat) n'emën të vilajetit. Kryeministri Emin Pasha që çmoj cilësitë e vetitë e Mustafa beut, e emënoj në Resmo prefekt tue i dhanë dhe gradën e Bejlerbeut të Rumelisë, ku qëndroi tri vjet; dhe tri vjet e gjysëm tjera si prefekt në Kandje, një vjet si prefekt në Hersekë e në 1296 h (1879) mori kryesinë e mbledhjes që u ba në Prevezë dhe provoj veprën e vet patriotike tue shpëtue Janinën me lëshim të Jenisherit në vend të saj. Muhtar Pasha ishte në Prevezë aso kohe si komisar. Mbasi u kryen formalitetet e këmbimit, të Jenisherit në vend të Janinës, u formue valillëku rishtasi i Manastirit ku Muhtar Pasha u emënuë vali e Mustafa beu, në saj të relacionevevet të mira që kishte me të, u dërgue prefekt në Korçë. Por prej këtu dha dorëhjekjen mbas shtat muajsh dhe vajti në Stamboll. Me t'ardhun këtu u emënuë Komisar i caktimit të Kufijvet në Shkodër mision ky të cilin, dashtë e pa dashtë e pranoi, por tue vu disa kushte. Stambolli kishte da me ia lëshue Malit të Zi pesë-malet e Shkodrës në vend të Plavës e të Gucisë. Mustafa Pasha, që çmonte pozicionin e fortë

të këtyne malevet për Shkodrën dhe rrezikun që do t'i vinte Shqipnisë në rasë se këto i lëshoheshin Malit-Zi, pa nevojën me lëshue një copë tokë kahë Kraja si shpërblim për pesë-malet dhe kështu me përfundue caktimin e kufijvet. Mbi autorizimin që mori për këto motiv kuvendi si i shkroi drejtëpërdrejt zyrtarisht Princit të Malit Zi dhe mori pëlqimin e tij. Por ambasadori Rus në Stamboll e kishte bindë Portën e Naltë për një ndrrim të pesë-malevet me Ulqinin, dhe i ishte ba komunikimi Mustafa Pashës; por ky nuk e pa të zakonshëm këtë vendim të Portës së Naltë dha dorëhjekjen dhe nguli kambë që t'i pranohej kjo. Në vend të tij u dërgue me të shpejtë gjenerali i Shtat Madhnisë Veli Riza Pasha. Tue pas ngurue edhe ky në çashtje të dorzimit t'Ulqinit, u ngarkue Dervish Pashë Lofçëja. Ky kuptoj se akti i Mustafa Pashës në refuzim të dorëzimit t'Ulqinit mbështetej në ndenjat e tij kombëtare, dhe këtë e mori për shkas me shfrye mëninë e tij kundra Mustafa Pashës dhe kundra shumë krenëvet tjerë shqiptarë, tue nxjerrë urdhnin e Sulltanit për internimin e tyne në Çanakkala. Mustafa Pasha këtu ndej i internuem dy vjet, dhe mandej në Izmir, ku qe transferu gjithnjë i internuem. Mbas gjashtë muejshë u fal dhe me insistim të Ismail Pashës, vali i Izmirit, pranoj kambën e prefektit të Menteshës. Këtu shpartalloj një çetë brigadash që i pat shti tmerrin popullsisë së

vilajetit t'Zmirit dhe mbrrijti me rivendosë qetësinë. Sulltani në shërbim të këtij shërbimi e nderoj me medaljen "Tkinxhi Osmani". Dëshira kryesore e Mustafa Pashës ishte me u kthye një or e ma parë në vend të vet. Dha dorëhjekjen si prefekt i Menteshës megjith premtimet e sigurimet që iu dhanë se do të kishte edhe ma nderna prej Sulltanit, dhe u kthye në Vlonë mbas autorizimit që nxorri. Në Vlonë priti kohën me shkue në Qabe, për ku u nis në fillim të vitit 1302 (1884) dhe por sa mbrrijni në Mina, më 16 të gushtit, të këtij viti, të mërkurën u nda këso jete.

Mustafa Pasha qe njeri me kulturë të gjanë. I devoçëm fetarisht, ruhej prej çdo mëkati. Të tana punët e tija ishin të shestueme ma përpara e mbrenda një plani. Disa vjersha të tija arabisht dhe sa anotacione letrare stolisin bibliotekën t'ëme dhe për mue janë një kapital që më gëzon. Frengjishten dhe greqishten i zotnonte në mënyrë të përsosun. Në kaligrafi ishte mjeshtër. Bante pjesë në sektin e mevlevijve, dhe në Konja në Teqe të këtij sekti kishte selinë e vet. Kundrejtë të mdhajvet ishte krenar, por modest ndaj të voglit. Ai kisht ambicie për me pasë famë e pozitë, jeta e tij ishte fare e thjeshtë. As nuk ishte hipokrit as nuk detyronte të tjerët t'i bajshin hipokrizi. Respektonte të drejtat e shoqit, dhe ishte i prirun me ba mirë. Kundrejtë vuejtjeve e mjerimeve kishte një rezinjacion.

Memorien e kishte të fortë, gjuhën elokuyente, ishte, të thuash erudit. Dijte përmendç shumë vjersha të mesnevisë dhe gjithmonë e mbante në dorë librin e Imam Shuaran-it.

Në mbledhjen e Prevezës ia doli me sukses qëllimeve të veta kombëtare, por po këto qëllime i dhanë grusht dhe e hollën ndër vujtje. Kudo që u krenu me qenë shqiptarë. Ndër gjykime ishte i qartë dhe punët i shihte shumë larg. Në kryengritjen e Hersegovinës dhe në lëvizjen malazeze ma tepër se ngacmimevet të rusëvet shihte gishtin e Austriakëve, për çka kishte shti në dorë provën bindëse. Vetë Mustafa Pasha që i pari që ja raportoj me dërgue ushtarë para se me plasë kryengritja. Por kryeministri i atëhershëm Esad Pasha në vend t'ushtarëve i çoj porosina me zbutë kryengritsat me këshillë. Dërgimi i dy bataljonëve ushtarë siç i propozonte Mustafa Pasha, thonte kryeministri, do të bante bujë të madhe në Europë, dhe për këtë kishte arsye. Mustafa Pasha dha dorëhjekjen dhe insistoi që t'i pranohej; bile refuzoi propozimin që iu ba me shkue si prefekt në Jenipazar.

Qe shumë rigoroz ndër çashtje fetare, dhe zbatonte përpikmisht detyrimet që i vente feja. Nuk i jepte kujtë rastin me vu gojë as kundra çashtjes vet ma të thjesht fetare. S'e kishte zakon as me marrë kënd për të keq nëpër gojë. Fjalën e kishte fjalë, me t'afërm e miq ishte i shkueshëm. Që të mos ishte i detyruem me bartë

një dekoratë me kryq, gjeti ekskuzë me dalë me pritë në emën të Portës së Naltë Perandorin e Austrisë që vinte në Raguzë. Mbante një pozë serioze në çdo mbledhje a shoqni, mbrojte interesat e qeverisë dhe mbante dinjitetin personal të vetin. Në Vlonë ngrehi shkollën ruzhdie (Qytetëse). Nër vende ku pati nëpunësina la një tok veprash. Në Gjirokastër solli ujët e Sopotit, në Resmo ndërtoi një godinë qeveritare dhe një kazermë, në Kandojë mbërrijti me ngrehë rishtas Xhaminë e Madhe të Vezirit dhe Shpikorrektimi, në Trenovë të Mastarit shtroi një urë madhështore hekuri dhe në Medinë në varin e Mevlana-së bani disa përmirësime e la dhurata. Mbi gurë të varrit ka këtë mbishkrim: "Geldim sana rizanë ederek xhyrmu gjynahi, Xhanëmla sëgëndën sama ej Bajti-Ilahi".⁶

Asht i varrosun në Mina ku pat vdekun, pranë varrit të Hazreti Hadixhetul'Kubarasë. Perëndia e pastë mbushtë me mëshirën e vet të pambarueme.

88. Myfid bej, Ahmed, Libohova, prej Libohove, grada Ula-Sënëfi-Sani. Se sa ndikim të randë kanë mbi njerzë ndryshimet e kohës e të vendit!! Maliq Pashë Libohova urrente kulturën dhe për një shënim llogarie ma të vogël mbetej në nevojë t'imamit të lagjes. Kështu la të zhytun

6. Erdha te t'i tue derdhë fajet e mëkatet T'u trova ty bashkë me shpirtë t'ëm o Shpi e Zotit. (Sh. i përk.)

në pellg t'injorancës katër djelmët e vet, pse ishte i bindun se në këtë mënyrë do të mund i vazhdonte ndera e madhnia e Shpisë së vet!! Por Neki beu, biri i Maliq Pashës, pati një përshtypje të keqe nga indiferentizmi kulturorë i t'et, dhe çoj në shkollë djelmët e tij. Neki beu i kishte kuptue se malli, gjëja, ndera e madhnia mund të mbaheshin vetëm me virtyte të mira e me një perfeksionim shpirtnor, prandaj me sakrifica të mëdha u dha mësim katër djelmëvet të vet, i çoj ndër shkollat ma të mira t'Evropës, ku ata morën një kulturë të gjanë dhe mësuën shumë gjuhë të hueja. Kështu Neki beu kreu ma së miri detyrën e tij atnor ndaj të birit. Ma i madhi ndër djelmët e Neki beut por dhe ma i dashuni benjamin ash Ahmed Myfit beu. Inteligjencën e vet dhe zotësinë kulturore pikë ma së pari e provoj Myfid beu në hartim të një vepre biografike që botoj për dajën e madh të tij Ali Pashë Tepelenën.

Me zotësi përdori pendën në përshkrim të jetës dhe në mbulim të veprave të shëmtuta të këtij përbindëshi! Por tue studjue thellë jetën e dajës së vet, Myfit Beu iu ushqye zemra e trutë me një ndjenjë fisnikrie madhështore dhe me një simpati ndaj trimnisë. Kështu iu shujtnë shpirti me peripecitë e gjith jetës s'Ali Pashës. Daja i Myfit beut qe një satrap i kohës vet, dhe përbuzi armiqt, nënçmoi gjithëken, pse mendonte që kështu duhej të sillej një njeri shteti. Por sot janë

ndrue kohët. Për ta çue në vend një dëshirë ma të vogël duhet me iu përrulë vegjlisë, të cilën Myfid beu e quen "hezele-bezele" (përdoret për të poshtrua turmën, sh. i përk.). Por këtë të vërtetë Myfid beu e kuptoi vonë dhe ra në deziluzion!! Myfit beu asht guximtar dhe i zoti i gojës. E para nëpunësi e tij qe në Ambasadën otomane të Brukselit si sekretar i dytë. Aty nxorri revolverin kundra Këshilltarit Sejfedin beut dhe vu në frikë e në shqetsim personelin e Ambasadës me poteren e tij. Aso kohe Faik bej Konica nxirrte në Bruksel gazetën "Albania" dhe Ismail Qemal beu gazetën "Selamet". Të dyja këto gazeta shkruen kundra Myfid beut, por ky u detyrue me heshtë. Por Myfid beu, edhe i ri tue qenë filloj me folë me një gjuhë të qartë rreth rivendikimeet legale shqiptare, dhe me guximin që tregoj i thirri një nderë e lavdi emënit të vet! Fill pas çpalljes së Konstitucionit, u zgjodh deputed i Gjirokastrës, e këtu pati një pozitë me randësi. Një ditë bamë një mbledhje në shpi t'Eqerem beut, vëllait të vogël të Myfid beut ku morën pjesë Ahmed Riza beu, Xhavid e Talat beu. U vendos në këtë mbledhje me gjetë një afrim në mes të Myfid beut e të krenëvet t'Ittihadit. Njëni ose pari ndër kushte t'afërimit që paraqiti Myfid beu qe sjelljen në shkallë të Kryeministrit t'Isamil Qemal beut. Krenët e Ittihadit jo vetëm që nuk e pranuen këtë kusht, por çfaqën nevojën

që Myfid beu duhej të këputtë relacionet me Ismail Qemal bejnë. Kështu Myfid beu la mbledhjen dhe doli prej shpie të vëllasë. Diskutimet që u banë ne mbledhjen që u tha më sipër, provuen se Ittihatçijtë s'do të ishin të zotët me zbatue parimet e medodat e nevojituna në një regjim konstitucional dhe që ata do t'a vejshin absolutisht në tiraninë e tyne sundimin e shtetit. Prandaj, Ittihatçijt sa n'Ismail Qemal begun kishin çfaqë urrejtjen dhe kundra Myfid beut, tue e manifestue herë mbas here këtë urrejtje. Kur Myfid beu lajmoj me një gjuhë të qartë politike dhe të mbatun aleancën e katër shteteve të Ballkanit prej tribunës së Parlamentit, Ittihatçijt e përbuzën dhe e tallën dhe bile Ministri i Jashtëm Rifat Pasha, njeriu i Ittihatçijëve, për të nënçmue vlerën e Myfid beut përdori kundra tij fjalët përbuzëse “s'ka as furrik as voe” tue mos pa nevojën as me ba ndonjë hetim. Ndër zgjedhjet e dyta Parlamentare, qeveria e Ittihadit u përpoq mjaftë me pengue zgjedhjen e Myfid beut si deputet, tue shënue për kandidat të Xhemijetit Halil Pashë Alizotin. Myfid beu me vota dërmuese të zgjedhësëve doli prap deputet. Gjithashtu dhe këtë herë Myfid beu me të tanë zotësinë e tij politike u çfaq kundërshtarë i Ittihatçijve. Në qeverinë e përkohëshme t'Ismail Qemal beut Myfid beu qe Ministër Brendëshëm. U prish mandej me Ismail Qemal begun, dhe u emënue antar i Komisionit të Kontrollit ku

do të përfaqsonte Shqipërinë. Ismail Qemal beu donte me i sigurue vedit pozitën me një farë administrimi të butë, ma mirë me thanë donte me fitue kohë. Myfid beu përkundrazi donte me shpejtue punë, tue riorganizue xhandarmërinë, tue i dhanë një rrugë të mirë veprimevet administrative dhe tue ba sidomos që të ndigjoheshin prej kabinetevet t'Europës ankimet e Shqipënisë për t'i dhanë fund sulmevet e atrocitetevet të grekëve. Dhe një tjetër ngjarje vlen për t'u shënue, ngjarje që largoj Myfit begun prej Ismail Qemal begut. Në luftën greko-turke, në Jenishehir që mandej u pushtue prej grekëve, ushtria otomane kishte ble një sasi drithi prej Neki Beut dhe i detyrohej këtij një shumë të madhe. Në Vlonë patën dalë disa plaçka për ushtrinë otomane. Myfid beu vu sekuestër mbi këto plaçka, por Ismail Qemal beu, për të mos i dhanë shkak intervenimi ushtrisë otomane e përqëndrueme në veri e kundërshtoi me të tan forcën e tij këtë masë, tue refuzue kështu kërkimet e Myfid beut. Kjo armiqësi nuk u shue një herë me thanë në mes tyne, por vazhdoi gjithnjë. Në qeverinë e Princ Widit, Myfit beu qe ministër i Drejtësisë. Në një kohë qe dhe zëvendës Ministër i Jashtëm; por tue u gjetë përpara një pune t'ashpër të Princit dha dorëhjekjen dhe u emënue Ministër fuqiptotë në Romë. Qe dhe në qeveri të Durrësit qe dhe mori pjesë në Delegacionin Shqiptar që shkoi në Romë. Por në çdo rast

çfaq i natyrën e tij intrasigjente dhe si pasojë e kësaj natyre nuk mujt kurrë një herë me fitue simpatinë e kujt. Zotësia e pendës së Myfid beut si në turqisht ashtu në frëngjisht asht shumë e thellë si e thellë asht dhe kultura e tij në politikë ka një largpamësi objektive; në punë asht i ashpër. Fjalën e ka fjalë, asht vendikatif, ka natyrë aventurjeri dhe zemërohet shpejt. Punët e dëshirat nuk i mshefë, s'e ka frigë as mikun as armikun, ka vullnet e qëndrim në punë.

89. Namik bej, Ahmed, Vlora, grada Bala. Është vëllau i jem i vogël. Ka dalë i pari prej Sulltanijes (Liceu perandorak) dhe prej Mylkies (shkollë e naltë administrative-politike), asht dërgue me bursë n'Europë për të zgjanue mësimet. Njeri me kulturë, zemrak dhe në gjuhë i ashpër. Në çast zemërimi s'dallon as t'afërmin as të largtin dhe poteres s'din me i vu kufij. Si superjorët ashtu inferjorët gati-gati e kanë frikë, dhe domosdo do t'ia shikojnë hatrin. Nëpunësia e tij e parë qe një seksion përkthimesh në Ministri të Botores. Ky seksion nxirrte një të përkohshme mujore shkencore. Namik beu botoi në këtë të përkohshme artikuj të vlefshëm. Mandej u transferue në doganë të Sirkexhiut si drejtor i saj dhe mbrapa si ndihmës-këshilltar. Prej këtu kaloi në Këshillin e shëndetësisë si antar, e pak mbrapa u ba antar i këtij Këshilli tue pasë në ngarkim dhe rangun e

llogaritarit e të kryetarit. Shokët e tij të huaj që ishin antarë në Këshill të shandetsisë çmojshin vlerën e tij kulturore, dhe pranojshin çdo gjë që ai propozonte mbrenda kuadrit të ligjës. Veç dekoracioneve Osman e Nexhaidi ka dekoracione dhe prej qeverivet t'Iranit, të Greqisë, të Ruisë, t'Austrisë, t'Italisë dhe të Serbisë. Dallohet si njeri i ndershëm dhe i drejtë. Memorien e pati shumë të fortë. Mbante mënd çdo gjë që kishte pa e ndëgjue dhe i rrëfente me një gjuhë elokuede. Mërzitej me këndue libra. Nuk hudhte sy veçse ndër Salname e ndër urdhëna emënimesh. Me vjetë ka qenë si profesor në Sulltanie dhe gjith mësimet e konferencat i jepte përmëndësh. Në vitin 1906 u prek prej paralize, dhe i dolën zorrët jashtë. Qe pre shpresa se mund të jetonte. Familja e gjith qe e bindun se nuk kishte mundësi me i dalë para kësaj fatkeqsie dhe pritshin se po vdes me të nesërmen, tue u pregatit për me e kallë në dhe. Unë i dëshpëruem vrapova te mjekët, te Xhemil Pasha e të Konburogllu. Këta e tjerë mjekë të gjith i solla në shpi. Këta një herë, të tanë një gojë, ia lanë Zotit në dorë punën, tue e gjykue vetëm një torturë e asgja tjetër operacionin. Por Kanburogllu ndërroi mendim, tue pa dëshpërimin t'em, dhe dashtë e padashtë vendosi m'e operue, makari me një sukses një në mij. Dhe ia ban operacionin, pa aplikim t'anestezisë, pse i ngrati Namik beu e kishte humbë

vehten krejt, kaluen disa orë mbas operacionit. Mjekët u mblodhën prap. Namik beu përveçse një të marrunit frymë, të dobtë s'tregonte kurrëfarë shej gjallënie. Xhemil Pasha midis një shqetsimi të madh, donte me i shkepë domosdo vendet e qepuna. I kishte ra në mend Xhemil Pashës se kishte harrue në bark t'operuemit havllinë (peshqir i vogël) e fytyrës kur kishte mbyllë zorrët e futë në barkë, mbasi me gjith operacionin e banun ai kishte hjekë shpresën prej tij. Ia nxorri havllinë dhe e qepën prap. Namik beu shtatëdhjet e dy orë ndej si i vdekun. Mandej filloj dalë-kadalë me i çel sytë, me marrë pak ushqim, dhe ndër dyzet ditë u shërue. Xhemil Pasha këtë gabim m'a veshi mue, pse un, i fikun e i mekun disa herë gjatë operacionit paskemi shkaktue shqetësim Xhemil Pashës e unë qenkemi ba shkak me harrue ai havllinë në bark të t'em vëlla Namik beut. Xhemil Pasha këtë ngjarje e mori si shkas me u largue nga unë dhe me u bashkue me t'em vëlla të madhin. Namik beu shkonte në çdo vjetë n'ujnat e Vitllit dhe më 1903 u ndal në Vlonë dhe lypi të falun prej meje; dhe pranoj fajin e vet, tue dashtë që të harrohej e kalumja.

Namik beu s'ashtë marrë kurrë me punë politike kombëtare, s'ka marrë pjesë ndër mbledhje kombëtare. Ka vdekë në Stamboll, dhe ashtë varrosë në varrezat e Maçkës. Dritë pastë.

90. Nexhip Pasha, Kajca, grada Bejlerbej. U dërgue në Stamboll si një fëmi i vogël katundar, dhe një bamirës e futi n'Enderuni Humajunë, ku kreu mësimet dhe, dalë prej atij, u emënuë n'prefekt në Jemen. Këtu ndër shumë Nënprefektura qëndro si Nënprefekt. Mësoi gjuhën arabe dhe shumë kallzime arabësh, përzi me hiperbolë si e kanë zakon arabët. Mbrapa u transferue prapa si Nënprefekt në Vlorë e në Loras e mandej prapa Arabistan si prefekt i Jizanit. Në Jizan mblodh pare, bani tregti, dhe erdhi në Stamboll mbasi ia kishte sigurue vehtes jetesën. Në Shqipni i preu marrëdhëniet, mbasi këtu s'kishte pasuni. N'administratë mbajti një qëndrim t'egër. Megjith këtë ishte i ndershëm. Valiu i Janinës Ahmed Hifzi Pashë Manastiri deshtë t'a bante vegël për të mëshefë të kqijat e tija, por ai Nexhip Pasha, sikur e rrëfen ky vetë, nuk u ba vegël me gjith premtimet e thana, dhe mbajti sjelljen e vet të drejtë. Vetëm tue ndigjue fjalët e vendasavet u soll shumë keq me popullin e Dukatit dhe u çue me zaptue n'emën të shtetit pyjet që i përkitshin katundit.

91. Nedim bej, Mahmud, Leskoviku, grada Ula-Evveli. U mor me iltizame (ndërmarrje) dhe me tregti, u simpatuzue për ndershmërinë e tij, dhe qe një burrë i nderuem, fytyrë qeshun shumë e gojë-ambël. Më politikë nuk u mor. Kujt s'i bani keq. Vdiq në Stamboll, la një djalë trashigimtarë të denjë, Hajreddin bejnë.

92. Nesib Efendi, Abdurrahman, Libohova, , Shehislam. Djali i njaj shpie fisnike e njohun për kulturë, Adurrahman Nasib Efendiu, qe i çquem ndër shokë si vëllaznit e tij, Ali Salih, Azmi e Talat Efendilerët. Ndër shumë vende qe Kadi ku punoi me nderë e me drejtësi. Një kohë të gjatë qe kryetar i gjykatës së Apelit të Janinës, mandej kadi i këtij vendi. Në kohën kur u shpall Konstitucioni ndodhej kadi i Selanikut. Shefat e Ittihadit kishin pa çiltas kulturën, zgjimin e karakterin e tij, dhe me ndërmjetësimin e disave prej tynë qe kishin trut në vend, u ba Kadi i Misirit, prej ku kaloi në selinë e naltë të Shehislamit. Nasib Efendiu qe një personalitet i çquem në çdo pikpamje, në gjentilencë e n'inteligjencë. Rrallë i gjendej shoqi. Në Stamboll u njoftë për një erudit. Në letërsi turke e arabe qe një za me shumë vepra, sidomos për përktimet nga arabishtja. Në vitin 1330 h (1912) vdiq në Stamboll. Me të tana virtytet e mira me moral të naltë dhe me kulturë të thellë, qe një ndër njerzë t'anë të mëdhej. Nuk qe një joboz (arrogant) si Musa Qazim Efendiu (dhe ky një herë shihislam, sh. i perk.) i cili u naltësue në shkallë të Shehislamit, pa pasë kurrfarë zotësie vetëm pse u shërbej verbnisht Ittihatçijëve dhe vetëm pse qe aventurjer e mason. Kurse Nasib Efendiu nuk iu ba kurrë vegël asaj frrote të vogël t'Ittihatçijvet, por u natësue në selinë e Shehislamit me meritat e tija, dhe kurrë një herë s'i

vuni njollë dinjitetit të tij kultural e personal. Mbërrijti me krye misionin e vet të naltë ma së miri, butë e urtë si e deshti koha e vendi. Nuk la as pasuni e as fëmi, por një emën qe do të mbetet i paharrueshëm.

93. Neshet Pasha, Mehmed, Vlora, prej Vlore, grada Bejlerbej i Rumelisë. Është djali i dytë i Mustafa Pasha Vlorës dhe vëllau i jem ma i madhi. Lindi në Janinë në vitin 1855 dhe kreu mësimet e veta në Janinë, në Rusçuk në Resmo e në Kandje. Qe njeri i pajisun me një moral të shëndoshë, me ndenja të nalta, zemër butë dhe i sinqertë. Fitoi nderimin e gjithkujt, dhe gjithkush e deshti. Rujti dinjitetin e vet, u rujt prej së këqijëvet, qe me një fjalë i dalluem për njeri të mirë. Në vitin 1878 megjithse në Janinë pat një fuqi ushtarake pak a shumë të mjaftueshme, ai ia befi në Sarandë dhe zaptojë kalanë e Likursit, dëboj dhe shpartalloj çetën greke, qetësoj të krisunit e Himarës, të Vlorës e të rrethet qe ishin gati me çue krye dhe mbërrijti me shpëtue vendin vërtetë prej një katastrofe. Punoi gjithmonë për të mirë të vendit për nderë e lumni të kombit, e për këtë shkak Ittihatçijtë e dëbuen prej Stambollit. Mbas vdekjes të të birit të tij Server'it në vitin 1901 në moshën tetëmbëdhjetëvjeç, bota iu ba burg, jeta e gëzimi iu shëndruen në një mjerim. Nuk iu qesh ma buza një herë me thanë në këtë jetë, një herë

me thanë nuk i men lotët. Mbasi mbuloi me dhe të zi të birin e vet, loçkën e zemrës, u shtrëngue me lanë Vlorën, dhe shkoi në Stamboll. Pesëmbëdhjet vjet administroi me zotësi pasunitë mbretnore si drejtor, dhe por sa mbrijti në Stamboll u emëruë me urdhën të Sulltanit antar i Këshillit të Naltë të Shtetit, në seksionin e Janinotëvet. Megjithëse ç'prej njëzet e sa vjetësh u largue prej Shqipnie, gjithmonë qe krenarë me çfaqë lidhjen e tij që kishte me kombin shqiptar, dhe dëshira e tij me ba gjithmonë vepra të mira.

94. Naim bej, Frashëri, Dumë, prej Frashërit, grada Ula Evveli. Çdo komb ka pishtarët e rilindjes së tij. Kështu dhe Naim beu asht flamurtar i rilindjes shqiptare. Çka ashtë Goethe për gjermanët, Shakespeare për anglezët, Victor Hygo për francezët, këta ishin Naim beu për shqiptarët, këtë vlerë e këtë veti ka ai për ta. Naim beu me poezinë e tij të ndritun holli ndër shqiptarë shpirtin e zgjimit, iu frymzoj atyne idealin kombëtar e dashuninë e Atdheut. Naim beut ia ruejti fatin nderën me çue në një shkallë përsosmërie gjuhën, së cilës i mungonte substanca e elokuencës dhe me i dhanë asaj një madhni hyjnore në të shprehun të ndiesinavet. Nuk ka shqiptar që të mos tronditet në shpirtë prej një entuziazmi kombëtar kur këndon veprat që janë një prodhim kulturor i Naim beut. Penda e Naimit ushqej

në dashuni për indipendencë në zemrat e ndenjat e Shqiptarëvet. Shqiptari i Toskënisë, në katundin më të harruem, i pa këndim e i pa shkrim këndoj veprat e poezisë së Naim beut. Katundari ma i varfër vari në kasolle të vet portretin e Naim beut. Naim beu nuk thuri vetëm poema shqiptare. Ky njeri i madh, ky poet i madh e i nderuem vuni në varg mendimet e tij të nalta dhe në persisht, përktheu Homerin dhe hypi në kulm t'artit të tij poetik dhe të kulturës së tij. Ndër vepra e ndër vjersha të tija Naim beu derdhi të tana ndenjat e tij të holla kombëtare dhe përkshkroi lidhjen që kishte me kombin. Përdori ndër shkrime të veta një gjuhë t'ambël e të kulluet që e shijoi kushdo që këndoi ato shkrime. Naim beu do të mbesi i pavdekshëm, si një flamurtar i kombit, në kujtimin e shqipëtarëvet. Në shqipe qe një poet i vetëm, në turqishte një hartues i pa shoq, në persishte një njohës i thellë. Por dhe greqishten e arabishten i zotronte me të tana hollësitë e këtyne dy gjuhëvet të gjana. Qe një mjeshtër në letërsi të lindjes e të perëndimit. Naim beu qe një krijaturë që lind krye një shekulli një herë! Një prodhim i jashtëzakonshëm i natyrës. Virtyti që mëshefej në të, çfaqej me të tanë madhëninë ndër sjelljet e tija, dhe bante gjithëkënd për vedi. Me kujdesin e Abdyl beut kreu mësimet në Janinë në shkollën greke. Këtu mori e zgjanoi kulturën e tij. Kur

Abdyl bejnë e detyrojë qeveria me caktue si vend banim Stambollin, të tanë familja u bartën në kryeqytet të Perandorisë, ku i takoj me kalue të tanë jetën edhe Naim beut.

Naim beu me vjetë qe nëpunës në Ministri t'Arsimit, mandej antar i komisionit t'inspektimit në gji të kësaj Ministrie e ma vonë kryetarë i këtij komisioni. Nuk kishte punë ma të mërzitshme për Naim beun se me pasë një funksion qe t'i lidhi duert e gjuhën me zinxhir popullit për kapriçot e një njeriu (e ka fjalën për Sulltanin, sh. i përk.) dhe të censurojë fjalë për fjalë veprat e shtypuna; për Naim begun gjeni i cili ishte i djegun për liri të fjalës e të gjuhës. Një filozof mysliman thotë: "Dënimin e ferrit e vuen në këtë botë një njeri i përsosun kur asht i detyruem mos me thanë atë qe din e me thanë atë qe nuk beson". Një ditë kur po bisedojshëm me Naim begun ia kujtova këtë të vërtetë dhe mu gjegj: "Veprat qe i paraqiten Komisionit, i studjoi një herë në mënyrë të veçantë. Veprës i hedh një vrejte të kujdesëshme si mbas famës qe ka autori i saj. Mbi një paragraf ose fjalë qëndroj me ditë dhe ma në fund gjej rrugë si me bishtnue". Nën peshën e këtyne vuajtjevet shpirtnore Naim beu u smue seriozisht, dhe ma në fund e rrëmben nga kjo jetë në një moshë qe mund të cilësohej edhe i ri. Naim beu megjithse mizantrop, prap qe i rrethum prej njerzish të përsosun qe adhurojshin. Shpesh kalonte ditët i

smut e në dobësi fizike. Por megjith këtë kundrejtë miqve e dashamirëve qe kishte pranë qëndronte gjithmonë bujarë i pritun e i sjellshëm. Nuk i thyu zemrën kërkujt, nuk pati ambicie me qenë mbi të tjerët, por për kundra qe modest ndaj kujdo. Në sjellje qe fort serioz dhe i çveshun prej kapriçovet. Rregullën e disiplinës në jetë ia kandëte fort, fukaranë e ndihmonte. Ata pak të holla qe mund të kursente, i prishte me botue veprat e veta. Ishte i heshtun, por gjithmonë mbrojtës i së drejtës. Kur flitej për Shqipni, gjuha e tij bahej elokuent, në detin e gjanë të kulturës së tij fillojshin atëherë me buçitë tallazet.

Vdiq në vitin 1315 h (1899) në Stamboll dhe u varros në Teqen e Bektashijëvet të Merdiven Kojit, aty ku asht i varrosun dhe vëllai i tij, Sami beu. Perëndia derdhtë mbi të mëshirën e vet të pambarim.

95. Naim Pasha, Ahmed, Moulla, Beratas, gjeneral Divizioni. Naim Pasha qe nga një familje e njoftun e Beratit. Persona e tij qe simpatizue fort prej popullit. Kahreman Pashë Vrioni, parësi e Beratit e çoj në gjimnazin ushtarak të Manastirit bashkë me djalin e vet të madh Omer begun. Mbaroi gjimnazin shkoi në Stamboll, dhe këtu kreu mësimet në Akademinë Ushtarake, nga e cila doli oficer në vitin 1860. Përparoi shkallë shkallë dhe në vitin 1897 u ndodh në krye

të së parës brigadë të Divizionit të katërt që ndodhej n'Allasonjë, në luftën kundra Greqisë. Mahmud Myftar beu i Myftar Pashës desht ta përdorte gjeneral Naim Pashën si shërbëtorin e tij ndër llogoret (fortifikimet) e Veleshinit. Luftimet që u zhvilluan në këtë sektor e që mbaruen me shkatrimin kryekëput të një regjimenti të kalorësie, vërtetë ia zbardhën faqet kolonelit grek Jemolenskit, por Naim Pasha me zellë dhe guxim të tij qëndroi, siguroi zmrapijen e fuqivet të veta dhe për hirë të manovrimit të mirë nuk i la vend zgjimit të gabimëvet të Mahmud begut. Naim Pasha nuk qe një ushtarak i madh. Por dihte me përdor trimërinë e tij të natyrshme, dhe kështu u tregue i zoti në të rujtun të nderit të tij ushtarak. Në çdo vend që ndodhi siguroi rregull e disiplinë, dhe kreu me nderë e me atdhetarizëm detyrën e vet. Për hirë të guximit që dëftej në ... (nuk kuptohet se ç'asht emni që përmendet këtu, sh. i përç.) u gradue në dinjitetin e gjeneralit të Divizionit. Vdiq në vitin 1916.

Naim Pasha pati veti të mira, nuk qe i dhanun mbas tantanasë. Ishte një ushtarë i provuem dhe bamirës e i sjellshëm ndaj këdo. La dy djelm, me emna Zija e Qemal.

96. Nurullah bej, Alizoti, prej Gjirokastrë, grada Ula-Sënëfi-Sani. Rrjedh prej një familjes fisnike të Alizotëvevet. Nga i ati nuk trashgoi ndonjë pasuni. Në saj të përpjekjes së

tij rroj në begati, u dha kulturë djelmvet të vet, s'u lodh nga puna, s'pritoj me ia dalë qëllimit dhe me çue në vend fjalën. Qe njeri i gojës, ambicies me pasë pasuni; inteligjent dhe i njohun për njeri tallës. Flitte shumë, ishte dhe vendikatif. Tue qene nëpunës në Kadastër vdiq në Stamboll ku la dy djelmë.

97. Nevzad Pasha, Alizoti, prej Gjirokastrë, Mirmiranë. Është djali i vogël i Naim beut, pari e Gjirokastrës. Mbas mbaroi shkollën e Mylkijes, shërbeu si Nënprefekt ndër shumë vënde t'Anadollit. Kur ishte nënprefekt në Bejrud për një herit iu dha titulli i Mirmiranit. Vdiq në Stamboll në një moshë të re. Pati sjellje fisnike e qe fort i ndershëm. I shkueshëm shumë me shokë në bisedë i ambël e inteligjent e gjithmonë në shënd, dhe një home d'esprit. E peshoj mirë botën, besoj se vuajtjet e lumëniya, skami dhe pasunia janë si një hije që vijnë e zhduken shpejt në sy të njeriut. I dizinteresuem në jetë dhe i çveshun prej ambicies me pasë famë e pozitë. Shokët e tij hypën ndër nëpunësi të nalta, shokë të cilët qysh prej bankavet të shkollës kishin pasë nderë prej tij. U përpoq me ndalue të keqen për sa i erdhi prej dore. Nuk u martue. Kaloj jetën në qetësi e në gëzim.

98. Nikollaqi Efendi, Çanaka, prej Janinë, grada-Sënëfi-Sani. Në Janinë jetoi me zakone e tantana të një osmanlliu, ndër grekë pat emën të

mirë e famë, që në medis t'antarëvet të Këshillit Naltë të Shtetit që qenë marrë nga notablët e Janinës, dhe që zgjedhë deputet i vilajetit të Janinës në të parin parlament otoman. Në mes të biografisë së personalitetetve, kam detyrë me ia kushtue dy rreshta dhe Çanak Efendisë, mbasi i meriton. Pse ky nuk u tregue një shoven në medis të nacionaliteteve grekë, por mbajti në Janinë përherë një qëndrim moderat, iu bind çdo urdhni të qeverisë dhe pati një edukatë otomane.

99. Vexhihi Efendi, Kasimati, prej Libohove, grada, Meqqe Pajehisi. Lindi në Libohovë, studimet i bani në Stamboll, që i sinqertë e fatin e pati të quiet. I thellë në shkenca tradicionale e racionale dhe njohi krejt mirë gjuhën frënge. Kudo që ndodhi Kadi u dallue me drejtësinë e tij, nuk u kursye me thanë fjalën e drejtë kur e donte puna. Fitoi mirëbesimin e simpatinë e gjithkujt. Qe një ndër personalitete me kulturë. Kur Nexhi Efendi ishte Kadi në Serfixhe, këtu prefekt qe Halil Pashë Gjyrokastër. Për një punë të këtij të pa drejtë e qortoj, u keq me të u ankue kundra tij. Kjo çashtje proukupoj me vjetë zyrat qeveritare deri sa ma në fund u konstatare dobësia e Pashës dhe e drejta e Kadiut. Por mbrapa me ndërmjetësimin dhe lutjen e disavet, Vexhihi Efendiu ia hoq thojt qafës Halil Pashës.

Qe fetar, por i sinqertë në besim. Njeri poteraxhi, por me njohuri të thella ndër punë të njerzisë. Mbrapa u dha

fort mbas studimevet të misticizmit, gati gati u ba i çmendun, dhe në këtë gjendje vdiq. Qe një shkrimtarë i pashoq dhe i ndjeshëm. Kam parë rastin me ba disa dorëshkrime letrare të tijat, por këta kanë humbë ndër duer të trashëgimtarëvet të tij.

100. Vehib Pasha, Leskoviku, Bejlerbej i Rumelisë. Është djali i madh i Rustem Pashës. Pasunia që trashëgoi prej t'et i siguroi një pozitë nderi dhe një jetesë të kandëshme ne Leskovik. Nuk u përzi ndër punë të vendit as ndër çashtje kombëtare. Por pasuninë nuk mujti t'a administroi mirë, s'i bani as mirë as keq kërkuj, jetoj në punë të vet. Qe një njeri me natyrë dervishi (askete).

101. Vehib Pasha, prej Janine, gjeneral Divizioni. Është vështirë me shkruë siç lypset jetëshkrimin e Vehib Pashës, idetë e qëllimet e veprat e tija. Disa këtë Vehibi-Muhibë (Vehib të tmershëm), i cili u ndodh në krye të shumë ngjarjeve të mdhaja dhe me randësi, e din një ushtar trim e t'aftë, të pamëshirshëm, një tip burri si luan. Disa tjerë e tregojnë një ambicioz që kërkon me pasë pozitë të naltë, që fugon mbas interesave të veta, të tmerrshme e fort atik (s'e kupton përkthyesi). Mbas mendimevet t'ona Koloneli Vehib beji asht komandant i zellshëm e trim, që mprijti me një guxim të pa shoq në Janinë dhe bile u tregua një patriot i ekzaltuem aq sa s'kurseu jetën e sa e sa ushtarëve që pushkatoj pse dojshin

t'arratiseshin. Në Çanakala, sidomos në mbrojtje të fortifikimevet të Anafortës tregoi një zellë e trimëri të madhe sa që u ba shembull për tjerët; në frontin e Erzurunit komandoi me sukses ushtrinë osmane megjith mungesat që kishte kjo dhe fitoi simpatinë e gjithkujt sidomos pse qe shmirak i Enver Pashës, i cili iu vu tarnagopin temelevet të Perandorisë Osmane. Mbas të vemë përpara sysh këto të vërteta, duem të japim një pasqyrë të jetës së tij, për qëllime për me plotsue kështu detyrën tonë si historiograf.

Në vitin 1914, në dhjetor, ishim në Hotel Imperial të Vjenës. U lajmova se në këtë hotel kishte ra Khedivi i Misirit Abas Hilmi Pasha. Me një herë u takova me Naltësinë e tij dhe një kohë të gjatë pata nderin me qenë i mirëpritun nga ai. Ndër ato ditë Khedivit i vjen një letër nga Sherifi i Mekes Hysen Pasha, i cili me një gjuhë shumë të preکشme ankohej kundra Vehib Pashës aso kohe vali i Hixhazit, se ka mbetë në një gjendje shumë kritike, mbasi ai i kërcënohet në një mënyrë fort tragjike. Ashtë sjellë kundra tij fort egër, s'ka dashtë me ja njoftë gradën e pozitën dhe si pasojë epërsinë e tij si sherif i Mekes, ka dashtë me suprimue prerogativat e tij fetare që gëzonte dhe ma në fund ka dashtë t'a helmatosë me anë të gjelltarit të vet, të cilin e ka bindë e mashtruar, për me krye këtë atentat. Kur ishëm në Këshillën e Naltë të Shtetit dhe mandej mbrapa pata rastin e lumtun me u njoftë me Sherifin Hysen Pashën s'afërmi dhe me çmue vetijat e tija të

nalta e fisnike. Prandaj formova idenë se s'kishte kurrëgjja të shtueme e shpifje në letrën që i dërgonte Khedivit të Misirit. Por ma hëngri mendja se Vehib Pasha kishte veprue si ushtar i bindun porosivet t'Ittihatçijëvet. E mbas do kohe ia hapa këtë çështje. Ai më tha: Qëllimi i tij kishte qenë me i dhanë fund ndërhymses së tij ndër punë të qeverisë. Halifin e përfaqësonte ai, Vehbi Pasha, e jo Sherifi, e pra ky ma tepër se një Meharacë bindjen s'duhet të kishte tjetër privilegj, kështu që kishte urdhën m'e njoftë atë gjithmonë nën vali. Mirpo koha s'ishte oportune grindjesh për karrike. Privilegjet i qenë njoftë ç'prej shekujsh Emirit (shefit) të Mekes. Sulltan Abdyl Mexhidi iu kishte puthë dorën vetë ma i pari Sherifit (Emirit) të Mekes, Abdyl Muttalibit, dhe kishte qitë atë ndër ceremonina përpara të gjith Ministravet. Mandej, ai ishte dhe makëmbës i Halifit, i autorizuem me da gjyqet n'emën t'Emaretit. Nuk ishte aspak e arsyeshme m'e vu atë në të njoftën shkallë me një Mihraxhe të Hindisë. Vehib Pasha ma mbrapa e kishte kuptue këtë realitet, dhe i kishte lypë të falun Shejtnisë së tij Sherifit. Mbas luftës Vehib Pasha erdhi n'Itali. U muer me punët e veta. Në tren të Janinës u vra gabimisht një Italian. Vehib Pasha u muer në proces si i akuzuem për këtë vrasje. Vujeji do kohë në burg, por mandej u lirue si i pa faj. Këtë shpifje kundra Vehib Pashës e bani Qemal bej Dinoja. Ky pat ngelë ngushtë n'Itali. Vehib Pasha e ndihmoi këtë. Por ky i hëngri Vehib Pashës

gjashtëmij franga, paret e disa hallijavet. Pasha e qortoi. Ai i zemëruem, e paditi Vehbi Pashën si organizator i kësaj vrasje. Në burg Vehib Pasha u njoftë me një kapiten italian; ra në kurthin e tradhtisë së tij dhe ai i hangri treqindmij lira. Me një mijë mundime mujti me shpëtue një pjesë të këtyne të hollavet. Prej Italie kaloi në Rumani për t'u marrë me punët e veta që të siguronte jetesën e familjes. Vehib Pasha, me thanë të drejtën, që i shkathtë, njeri me dinjitet, me një kulturë të thellë ushtarake dhe i zoti me krye çdo punë që i dilte nga dora. Dhe në shkrim që i fortë. Vehib Pasha që i biri i Mehmed Efendiut të Vehib Efendiut të Janinës, dhe vëllai i vogël i gjeneral Esad Pashë Janinës. Qe i dalun nga Akademia Ushtarake e Stambollës. Shum kohë shërbeu dhe ndër zyrë ushtarake me randësi. Flitte frëngjisht, italisht e greqisht. Si për digresion dhe me qëllim për t'a kalue në histori, e shoh t'udhës me përmendë këtë ngjarje: Ishte, më duket, në mars të vitit 1915, kur erdhi në Vjenë Perandori i Gjermanisë Wilhemi II, i shoqënuem prej Kryeministrit Bethmann Holleveg dhe prej Ministrit të Jashtëm Jargovv. Khedivi i Misirit Abas Hilmi Pasha, i cili ç'prej njëzetepesë vjetësh ndodhej në seli khedivnore, nuk kishte pasë rasën me i ba vizitë Perandorit të Gjermanisë, megjithse shpesh kishte ba udhtime n'Europë; dhe nuk e kishte pa me udhë t'a vizitonte kur ai, Perandori, kishte ardhë në Vjenë si mik. Vetëm i shkoj në banesë dhe i la, si donte rregulla e protokollit kartë-vizitë

tue pranue mbrapa Khedivi vizitën e dy diplomatëve që shoqënojsin Perandorin. Para 4-5 ditësh t'udhëtimit të Perandorit në Vjenë, kishin ardhë këtu kapidani dhe ekuipazhi, 60-70 vetë gjithsej, i kryqëzorit Amden i famshëm për vaporët që kishte mbyttë. Kapidani dha në Muzik-Holl një konferencë shumë kurajoze mbi aventurat e ekuipazhit të kryqëzorit në fjalë. Publikun e interesuem ma tepër këto aventura sesa vizita e Perandorit gjerman dhe s'flitej tjetër veçse rreth këtyne aventuravet. Jagovv-i e Bethmanni i kishin folë rreth kësaj çashtje Khedivit dhe ishin ankue kundra Sherifit të Mekes, Hysen Pashës! Mbase u zhduk Amdeni nga skena, Kapidani i dytë megjith ata që kishin teprue nga ekuipazhi i saj, kishin dalë me një varkë, emnit Ajishe, në brigjet e Kunfude-s, dhe kishin da me ardhë nëpër rrugë të Mekes në Medinë e prej këtu ne Stamboll. Naltësia e tij sherifi u kishte qitë këtyne para djalin e vet. Naltësinë e tij Sherif Fajsalin me treqind kalorës edhe për tu thanë mirëseardhjen edhe për t'i mbrojtë nga një sulm i çetave arabe. Mirpo çetat arabe ashtu si e kishte paramendue Sheifi Hysen Pasha, kishin sulmue ata dhe rrethue. Por gjermanët, të cilët kishin pasë me vedi 4 mitroloza, kishin xanë pozita dhe ishin mbrojtun, tue lanë të dekun nga arabët tre vetë dhe tue plagosë disa tjerë. Në këtë çast ia kishte mbërritë Fajsalin dhe shpëtue gjermanët nga një katastrofë, pse arabët të ndezun ma tepër në hakmarrje nga shkaku që iu vranë

e iu plagosën shokët, do t'i kishin çfarue për fund gjermanët. Fajsalli i ka marrë këta, i ka përcjellë deri në garë të hekurudhës së Medinës shëndosh e mirë, tue iu dhanë kështu gjithë ndihmën për t'u nisë për në Stamboll. Por gjermanët ishin zemëruar ndaj Sherif Hysen Pashës pse ky s'i kishte vra të gjithë arabët që kishin guxue me iu pre rrugën dhe pse ky s'e kishte sakrifikue për ta personën e pozitën e tij, dhe si për sadisfaksion kishin lypë prej Portës së Naltë pushimin e tij!! Khedivi ishte orvatë me qetësue gjermanët, tue iu thanë se ndër këto kohë ka qenë e pa mundur me shtrua atë çetë arabe dhe se pushimi i sherifit në një kohë si kjo do të ftohtë ndaj qeverisë tonë popullin e Hixhazit. Mirpo këta dy diplomata s'ia kishin vu veshin fjalëvet të Khedivit, kishin insistue në mendimet e veta, dhe Porta e Naltë ma në fund kishte ba gabimin me pushue sherif Hysen Pashën, dhe me vu në vend të tij si sherif Naltësinë Ali Hajdar Pashën. Por Sherifi i ri u tregue i dobët, dhe këtë e kuptoj Porta e Naltë. Shetet e Antantës dhe sidomos Anglia përfituen prej kësaj politike të marrë të Portës së Naltë, dhe ndër këta Anglia, ia ngjiti menjëherë dorën Hysen Pashës dhe i njofti këtë dinjitetin e Meliql'Hexhazit (Mbret i Hixhazit). Zoti i dhashtë shëndet personës auguste të Sulltanit e familjes së tij të nderueshme, dhe jetë të gjatë e pushtet shteteve islame.

102. Vejsel Pasha, Dino, prej Preveze, Bejlerbej i Rumelisë. Me origjinë asht prej Lopsi; djali i madh i Mehmed aga Dinos që u pasunue në saj t'Ali Pashë Tepelenës dhe vëllau i madh i Abedin Pasha Dinos. Ishte zhel në veshmbathje, një farë epikurjani. I çuditshëm ndër sjellje, por shpirtë mirë. Jelek, pantallon, e gjithkohë shbërthye, pjesa më e madhe e trupit çveshë, mjekra e kryet si flokët e harapit. Deri në moshën pesëdhjet vjeç u mor me punët e veta në Janinë dhe fati i dha grusht dhe e hodhi në Stamboll. Në këtë kohë ishte në Saraj të Sulltanit Sejfulla bej zavalani, pari e Përmetit, një njeri si elefant i bashëm por dhe me zemër të një divi. Dhe këtij i shkonte fjala pranë Sulltanit, Vejsel beu me ndërmjetësinë e Sejfullah beut, me të cilën ishte njoftë kishte dalë deri n'audjencë pranë Sulltanit. Vejsel beu bahet me një herë Pashë. Dhe i hypi fort në qefë Sulltanit me sjelljet e tija bixarre. Kështu që Vejsel Pasha bahet mik me Sulltanin!! Tashti Vejsel Pashës, që asht i afërmi i sulltanit, i drejtohen i madhi e i vogël. Bile një ditë Vejsel Pasha, në bisedime intime me Padishahun i sugjeron këtij idenë me sjellë në seli të Kryeministrit ase së paku të Ministrit të Jashtëm të vëllanë e vet Abedin Pashën, pse ky do të mund të mposhte të gjithë difikultetet nëpër të cilat përshkohej shteti dhe do të mund të sillte përmirësime në gjendje. Abedin Pasha, i cili ndodhej vali në Selanik me titullin bejlerbej i Rumelisë, u sull në Stamboll si Ministër i Jashtëm

me titullin veziri. Por ashtë për tu çudit se Abedin Pasha, njeri i kulturës, nuk mund e këndaqi Sulltanin, për më tepër humbi menjëherë simpatinë e besimin e tij, mbi lajmet që i qenë dhanë se ishte një bashkëpuntor i Mid`hat Pashës dhe në hartim të statutit të shtetit ishte çfaqë njeri i mendimesh të lira. Mirpo Veysel Pasha e kishte sigurue të vëllanë se pa tjetër do të bahej kryeministër. Kur një ditë, në saraj depërton lajmi i përfrigueshëm se shqiptarët janë mbledhë në shpi të dy Pashallarëvet të Dinjovet. Vërtetë shqiptarët ishin mbledhë në shpi të tyne, por me pritë urdhënin mbretëror t'ëmënit t'Abedin Pashës si Kryeministër dhe me marrë pjesë në ceremoninë gazmore që do të zhvillohej në këtë rasë. Veç çka se ndodhi e kundërta: Veysel Pasha u dëbue prej Stambolli dhe u dërgue në Sinop si prefekt e Abedin Pasha në Sivas si vali. Veysel Pasha qëndroi në Sinop dhjet vjetë, tue lanë në dorë të këtij e t'atij administrimin e vendit. Po kaq vjet u end edhe Abedin Pasha nëpër Sivas, Adana e Ankara si vali. Veysel Pasha u suell prap në Stamboll dhe vijoi me marrë rrogën si i afërmi i Sulltanit, por s'e pat ma rëndësinë e përparshme, megjithëse nuk humbi krejt, pse pak shum prap i ndigjohej fjala në Saraj. Të dy vëllaznit ishin shumë të lidhun në familje të vet. Veysel Pasha qe naiv, mashtrohej me një herë


dhe i besonte çdo fjale. Kultura e tij ishte e kufizue, por fjala e biseda e tij filozofo-mistike ndëgjohej prej çdo kujt e në çdo mexhlis (kuvend). Shqiptarët i ndihmonte me të tanë fuqinë e tij e përgjithësisht të varfrit. Dëshironte t'i shërbente atdheut, tue përfitue nga çdo rast, e sidomos përpiqej me da Shqipërinë zyrtarisht në një vilajet, tue përshti në këtë dhe Çamërinë e Prevezën. La dy djelmë, Shahin begun e Ahmed begun. Shahin beu qe deputet i Prevezës në të dytën perjodë të zgjedhjevet parlamentare. Para zgjedhjevet qe me Itihatçijt, por mandej u bashkue me kundërshtarët e tyne, kur konstatoj qëllimet e veprat që ata fillojnë të zhvillojnë kundra shqipëtarëvet e Shqipërisë. Dhe vërtetë këtu Shahin beu u tregua patriot. Në një kohë qe Ministër i Brendshëm në qeverinë kukull t'Esad Pashës. Në Selanik u ba shemër me Esad Pashën në dashuni të një vajze donme. Esadi desht t'a vriste, por me një mijë lutje i shpëtoi kthetruvet të tija, dhe atëherë e internoi në Midilli (Mytelenë). Djali tjetër i Veysel Pashës, Ahmed beu u ndodh në Korfuz kur Itajlanët (?) zaptuen Janinën. Shkoi në Çamëri, kur prej andej po këthente në Korfu e xun Francezët dhe mbas shumë vujtjevet u shpëtoi doret. Me zi që u hodh në Romë me një pasaportë italiane, dhe aty u detyrue me qëndrue.

Recensë mbi librin “Tarikati Halveti te Shqiptarët” të studiuesit Dr. Alban Dobruna

**Dr. Ilirjana Kaceli
Kolegji Universitar Bedër**

Abstrakt

Gjatë periudhës postkomuniste në historiografinë shqiptare hynë një sërë studimesh të reja veçanërisht në fushën historike, por edhe fetare bazuar mbi dokumente arkivore dhe burime autentike. Në fushën e religjioneve historiografisë shqiptare i ka munguar një studim i mirëfilltë për sufizmin dhe tarikatat islame. Monografia që ne po trajtojmë është hartuar për njërin prej këtyre tarikateve islame, atë Halveti te shqiptarët. Studiuesi Alban Dobruna vjen para lexuesit me fakte dhe vlerësime të reja, si nga pikëpamja shkencore, duke hedhur dritë faktorët historikë, socialë dhe kulturorë, që ndikuan në zhvillimin dhe përhapjen e veprimtarisë së këtij tarikati, që nga themelimi, deri në ditët tona. Në këtë vepër autori për herë të parë e pajis lexuesin me një këndvështrim tjetër nga ajo çfarë jemi mësuar të lexojmë deri më tani për historinë e religjioneve. Nëpërmjet të dhënave dhe burimeve arkivore ndriçohemi më thellë, nga analiza e tyre, puna e kryer nga vetë autori, si hartues i veprës tregon që përpilimi i saj kërkonte njohuri të thella për historiografinë shqiptare në përgjithësi dhe veçanërisht historinë e çështjeve fetare te shqiptarët. Kontributi i krerëve Halveti në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, në formimin dhe konsolidimin e shtetit shqiptar, sjell përpjekjet e të gjithë shqiptarëve pa dallim feje në lëvizjen për autonomi dhe pavarësi në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, si dhe kontributin e tyre në përmirësimin e gjendjes sociale të shqiptarëve.



Gjatë periudhës së dy dekadave të fundit në historiografinë shqiptare hynë një sërë studimesh shkencore bazuar mbi dokumente të reja arkivore dhe burime autentike në fusha të ndryshme të shkencave shoqërore-humane veçanërisht në fushën e historisë së religjioneve. Deri më sot lexuesit nuk i është paraqitur një studim i mirëfilltë mbi tarikatet islame, sofizmin, apo edhe mbi tarikatin halveti.

Ky punim ka si objekt studimi, historinë shqiptare dhe historinë e religjioneve. Si bosht qendror i zhvillimit të monografisë do të jetë trajtimi i zhvillimit dhe përhapjes së këtij tarikati te shqiptarët, duke filluar nga paraqitja e tij, esenca e doktrinës, mënyra e organizimit, depërtimi

te shqiptarët, kushtet e përshtatjes së veprimtarisë së tij në shoqërinë shqiptare, etj.

Lënda e pasur e shkruar me shumë kujdes, gjatë zhvillimit dhe trajtimit të saj në formën e një monografie, i ofron lexuesit njohuri të reja shkencore mbi jetën dhe veprimtarinë e tarikait halveti, që nga lindja e deri në ditët e sotme. Duke shqyrtuar monografinë, vëmë re se vështirësitë për kërkime dhe hulumtime rreth këtij tarikati ishin të mëdha, por jo të patejkalueshme. Autori është përpjekur të analizojë mjaft qartë dhe në një distancë relativisht të largët kohore lindjen, rritjen dhe veprimtarinë e këtij tarikati. Studimin e vështirësonte edhe mungesa e burimeve herë të pamjaftueshme dhe herë të pasistemuara për periudha të ndryshme, duke krijuar në disa raste pamundësi për një trajtim sa më koherent dhe kompetent ndonëse analiza dhe metoda krahasuese e përdorur kanë plotësuar këto mangësi.

Në periudhat historike të kaluara, janë dhënë në formë fragmentare disa nga anët e veçanta të historisë së këtij tarikati të botuara në fletoret dhe revistat fetare të kohës, apo janë trajtuar edhe në kumtesa dhe artikuj botuar nga studiues të ndryshëm. Disa prej tyre e kanë trajtuar tarikatin halveti në mënyrë të pjesshme, të tjerët e trajtojnë atë nën hijen e bektashizmit, si tarikati më i njohur në trevat shqiptare.

Për të pasqyruar sa më mirë dhe me vërtetësi historike në këtë monografi studiuesi ka bërë

përpyqje ta paraqesë tarikatin halveti në tërësi, ta krahasojë atë me tarikatat e tjera si: kadiri, sa-adi, rifa'i, shazeli, bektashi, melami, etj., duke analizuar të dhënat e mbledhura dhe duke nxjerrë përfundime të cilat vijjnë natyrshëm, mbështetur jo vetëm në burimet, por dhe në analizën e tyre.

Islami u përhap në tokat shqiptare, jo vetëm në variantin kryesor, sunit, por edhe në formën e tarikateve të ndryshme, siç ishin bektashizmi, kadirizmi, halvetizmi, rufaizmi etj¹. Dëshmi të pranishëm të këtyre tarikativave mistike në territorin shqiptar janë teqetë e ndërtuara në një numër vendbanimesh. Teqetë janë ndërtesa të posaçme ku jetojnë shehlerët dhe dervishët e rendeve të ndryshme nën drejtimin e një shejhu² dhe ku kryhen shërbesat dhe ceremonitë fetare³. Gjendja e teqeve shqiptare, në përgjithësi

krahas studiuesve ka tërhequr edhe vëmendjen e udhëtarëve të huaj, që kalonin në viset shqiptare. Por në përshkrimet e tyre, tarikatit halveti nuk ka qenë objekt trajtimi i drejtpërdrejtë. Ata me penën e tyre më tepër i kanë kushtuar një vëmendje të madhe tarikativave bektashi dhe bektashizmit në Shqipëri, duke shkruar artikuj dhe libra mbi ta, për shkak të rolit, që luajti në zhvillimin e nacionalizmit shqiptar, por edhe për shkak të shfaqjes së tyre në rrethana të caktuara në Perandorinë Osmane.

E gjithë monografia është e organizuar në mënyrë kronologjike. Punimi nis me vendin që zë tarikatit halveti në fenë islame, ku analizohen faktorët historikë, politikë e shoqërorë, të cilat vepruan brenda shtetit osman dhe që ndikuan në themelimin e këtij tarikatit dhe në përcaktimin e pozitës së tij brenda shoqërisë islame. Në këtë kapitull janë bërë përpyqje të shpjegohen dhe analizohen shkaqet, që çuan në degëzimet e tij të shumta e bënë atë më specifik në krahasim me tarikatat e tjera, si dhe ekzistencën e teqeve, si institucione të posaçme, ku jetojnë shehlerë dhe dervishë të tarikatit halveti dhe kryejnë shërbesa fetare. Gjithashtu në këtë kapitull do të kenë hapësirë halvetitë në Perandorinë Osmane, duke filluar nga shkaqet, që çuan popullatën selxhuke për të përvetësuar këtë kulturë, që do të ishte edhe preludi i përhapjes së këtij tarikatit në Ballkan dhe te shqiptarët.

1. *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. I, (Illirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI -vitet 20' të shek. XIX, botimet "Toena", Tiranë, 2000:593.

2. Në aspektin gjuhësor shejh do të thotë, plak i moshuar, kryesues i një teqeje ose zavijeje (teqe e vogël) me ihtarë të konsiderueshëm; Shejh bëhet dervishi më i aftë, por gjithëherë këtë e emëron ndonjë shejh tjetër më i vjetër. Shejhun, dervishët e nderojnë shumë, kështu kur ai vjen dhe hynë në teqe dervishët dhe anëtarët e tjerë të teqesë ngrihen në këmbë dhe thëllësisht e nderojnë dhe duke i drejtuar epitete të ndryshme, që e lavdërojnë.

3. Mustafa Kara, *TEKKE*, Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi, yil: 2011, cilt: 40, sayfa: 368-370.

Monografia vazhdon me kreun e dytë ku pasqyrohen në mënyrë të përgjithshme harta rajonale e përhapjes së teqeve halveti në territorin shqiptar. Kur u themeluan, kush i themeloi dhe kush i trashëgoi ato, si dhe zhvillimin dhe specifikat e tyre, paraqitur këto në sajë të faktorëve dhe rrethanave ekonomike, politike, kulturore-historike, që ndikuan në jetën e shqiptarëve.

Më pas autori na shpjegon rolin që luajtën halvetitë në Lëvizjen Kombëtare shqiptare në formimin e shtetit shqiptar 1878-1945. Në këtë kapitull trajtohen përpjekjet dhe vështirësitë me të cilat u ndeshën shqiptarët në lëvizjen për autonomi e pavarësi në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, kjo falë situatave ndërkombëtare të krijuara, si dhe gjendjes në të cilën ndodhej vendi. Duke u mbështetur në të dhënat arkivore dhe bibliografike shtjellohet roli i tarikatit halveti në konsolidimin e shtetit shqiptar (1912-1939), përpjekjet për organizimin e vet institucional si: Kongresi I Alevian në Shqipëri (1921), Kongresi II (1930) dhe Kongresi III (1936). Gjatë periudhës 1939-1945 krahas ndryshimeve territorial, u bënë edhe ndryshime në organizimin e bashkësive fetare. Në këtë kohë teqetë halveti u lidhën me kryeqendrën e re në Tiranë, si dhe u intensifikuan përpjekjet për ripërtëritjen e lidhjeve të vjetra të teqeve të Shqipërisë dhe Kosovës, në kuadrin e një riorganizimi të ri të tarikateve aleviane.

Nëpërmjet analizës dhe argumenteve autori përpiqet të na shpjegojë vendin që zuri ky tarikat në trevat shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitet e para të qeverisjes regjimi komunist në Shqipëri u përpoq të krijonte përshtypjen e një regjimi që respektonte dhe garantonte zbatimin e standardeve demokratike në fushën e besimit fetar dhe të lirive dhe të drejtave të njeriut. Por kjo fasadë politike zgjati deri në nëntor të vitit 1966 në Kongresin e V-të të PPSH-së, ku lufta kundër fesë u cilësua, si një pengesë me rëndësi e luftës klasore dhe më pas u synua zhdukja e saj, që sipas Partisë në pushtet frenonte përparimin e vendit. Lufta kundër fesë mori karakterin e një lëvizjeje të madhe dhe përfshiu të gjitha shtresat e popullit.

Në kohën e zhvillimeve demokratike në Shqipëri, pas vitit 1990 pati ndryshime të mëdha në të gjitha fushat në aspektin e përgjithshëm shoqëror, politik, ekonomik, por edhe në rrafshin fetar, përkatësisht në rihapjen e objekteve të kultit në përgjithësi dhe e tarikatit Halveti. Veçanërisht u pasqyrua rigjallërimi i aktivitetit të këtij tarikati në krye të cilit u vu Sheh Muamer Pazari.

Ndërsa në Kosovë, si të gjithë shqiptarët edhe anëtarët e këtij tarikati janë trajtuar në bazë të memorandumit famëkeq të Vasa Çubriloviçit të vitit 1937, ku theksohej mosrespektimi i

vullnetit të popullit për vetëvendosje, mosrespektimi i ritualeve të teqeve, që gjatë kësaj periudhe shërbyen në gjysmë ilegalitet. Vetëm pas plenumit të Brionit (1966) fillon një fazë e re në historinë e shqiptarëve në Jugosllavi, në përgjithësi dhe për ata të Kosovës në veçanti, ku gradualisht tarikatet filluan të realizojnë disa të drejta politike dhe ekonomike. Më 1974 filluan të organizohen në një organizatë të vetme të quajtur “Bashkësia e Radhëve të Dervishëve Islamë Alice”. Kjo organizatë për herë të parë bëri legalizimin e të gjitha teqeve në Jugosllavi dhe pas dhjetë vjetësh u formua shoqata e Shelerëve të “Meshajhëve” për Republikën e Serbisë-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, me seli në Prizren. Nëpërmjet saj u evidentua tipari dallues i teqeve që ndodhën në Kosovë, veçanërisht të teqeve në Gjakovë, Prizren dhe Rahovec, që u përkasin tarikateve të ndryshme. Në Kosovë kanë qenë të ndërtuara monumente të ndryshme halvetiane, që më vonë në disa qytete, filluan të shkatërrohen, për mos thënë që nuk ekzistojnë fare.

Si përfundim, mund të themi se ky tarikat u njoh në popull, si krah i rezistencës kombëtare shqiptare, u angazhua në forma të ndryshme si ushtarake, politike dhe kulturore për bashkimin etnik shqiptar, duke

dhënë kontribut modest, por shumë të çmueshëm në çështjen shqiptare.

Studimi në fjalë fillon me hyrjen në të cilën është paraqitur motivi i autorit për të ndërmarrë një punë të tillë hulumtuese, kërkimore shkencore. Analizohet objekti, qëllimi, metodologjia e studimit, si dhe synimin për të sjellë një punim të paraqitur me një këndvështrim të ri dhe më realist. Më pas punimi do të vazhdojë me 4 kapituj dhe përfundime të rëndësishme dhe koherente. Autori është përpjekur që në çdo segment kohor, që ka evidentuar historinë e tarikatit halveti, të bëjë analiza sasiore dhe cilësore, duke treguar me shembuj të shumtë e të larmishëm gjendjen e këtij tarikati dhe të fesë islame në ato periudha historike.

Kombinimi i analizës me rrëfimin e qartë dhe bindës ka bërë që punimi të jetë i kuptueshëm, i pasur në argumente dhe i arrirë për sa i përket synimit për një paraqitje shkencore të tematikës së trajtuar. Duke u nisur nga vlerat, origjinaliteti dhe rëndësia, që ka botimi i një monografie të tillë mbi njohjen “Tarikati Islam Halveti te shqiptarët”, standardet e arritura dhe parametrat shkencorë me të cilat autori, e paraqet veprën e tij, mendojmë që lexuesit po i vjen në dorë një monografi e historisë fetare me vlerë.

Salih efendi Myftia (1891-1978)

Myfti i Zonës Shkodër dhe Kosovë (Gjakovë) Prijsë i shqiptarëve myslimanë në SHBA

Abstrakt

Salih Efendi Myftia lindi më 1891 në Shkodër, në një mjedis familjar, intelektual, fetar dhe shoqëror të shquar. Mësimet e para i mori në Medresenë e Shkodrës e më pas i plotësoi në Vlorë, tek intelektualit dhe teologu i mirënjohur, Haxhi Vehbi Dibra, myfti i atij qyteti në atë kohë, duke treguar një përkushtim të veçantë ndaj diturisë fetare. Që në moshë të re zotëronte mirë gjuhët orientale: arabishten, persishten dhe turqishten. Shpejt ai fitoi simpatinë e banorëve të vendlindjes së tij dhe me sjelljen e përkushtimit në punë lartëson figurën prej prijësi fetar të shquar. Një kujdes të veçantë tregon për pasurimin e bibliotekës së familjes, që e kishte trashëguar nga paraardhësit. Për këtë bibliotekë është shkruar në mjaft organe shtypi, por mund të theksohet se ajo ishte ndër më të vjetrat e më të kompletuarat me vepra fetare, filozofike dhe të shumë degëve të tjera të shkencave, ku Salih Efendiu studionte e plotësonte formimin e tij kulturor e fetar. Për fat të keq, kjo bibliotekë 300 vjeçare është zhdukur plotësisht nga vala e shkatërrimeve dhe përndjekjeve politike ateiste.

Salih Efendi Myftia lindi më 1891 në Shkodër, në një mjedis familjar, intelektual, fetar dhe shoqëror të shquar. Ai u rrit në këtë qytet duke hyrë në fillim të shekullit XX me një edukatë të shëndoshë islame. Mësimet e para i mori në Medresenë e Shkodrës e më pas i plotësoi në

Vlorë, tek intelektualit dhe teologu i mirënjohur, Haxhi Vehbi Dibra, myfti i atij qyteti në atë kohë, duke treguar një përkushtim të veçantë ndaj diturisë fetare. Që në moshë të re zotëronte mirë gjuhët orientale: arabishten, persishten dhe turqishten. Shpejt ai fitoi simpatinë e banorëve të vendlindjes së tij dhe me sjelljen



Sali ef. Myftija

e përkushtimin në punë lartëson figurën prej prijësi fetar të shquar. Një kujdes të veçantë tregon për pasurimin e bibliotekës së familjes, që e kishte trashëguar nga paraardhësit. Për këtë bibliotekë është shkruar në mjaft organe shtypi¹, por mund të theksohet se ajo ishte ndër më të vjetrat e më të kompletuarat me vepra fetare, filozofike dhe të shumë degëve të tjera të shkencave, ku Salih Efendiu studioje e plotësonte formimin e tij kulturor e fetar. Për fat të keq, kjo bibliotekë 300 vjeçare është zhdukur plotësisht nga vala e shkatërrimeve dhe përndjekjeve politike ateiste.

Kultura e tij e gjerë dhe aftësitë

1. Revista “Njeriu”, “Almanaku”, “Shkodra” etj.

personale e afirmuan si një drejtues fetar të merituar, prandaj edhe emërohet drejtor i Medresesë së Epërme.

“Shpejt mbas Pavarësisë së Shqipërisë u pat hapë në Shkodër një medrese e re zyrtare në drejtimin e Salih Efendisë me mësues të aftë fetarë e me disa mësues civila të cilët jepshin mësimë suplementare. Kjo medrese, krahas lëndëve fetare punonte në bazë të një programi modern, për sa i përkiste shkencave të tjera në analogji me shkollat e shtetit”.² Kjo medrese nën drejtimin kompetent të Salih Efendi Myftisë do të bëhej një nga qendrat e rëndësishme kulturore dhe arsimore për fëmijët e të rinjtë e besimit islam në Shkodër.

Më 14 janar të vitit 1931, Salih Myftia emërohet Kryemyfti i Zonës Shkodër.³ Emërimi i Hirësisë së tij bëhet me Dekretin nr. 19 të Mbretit Zog dhe përveç tij është firmosur edhe nga Kryeministri Pandeli Evangjeli dhe Ministri i Drejtësisë.

Pak kohë më vonë juridiksionit të Salih Efendisë si Kryemyfti, përveç Prefekturës së Shkodrës, i shtohet dhe detyra e Prefekturës së Kosovës, që përfshinte zonën Kukës, Krumë, Has, Gjakovë (Tropojë). Kjo qe një detyrë me rëndësi jo vetëm për shtrirjen e gjerë, por për vetë problemet administrative, fetare,

2. Bushati, Hamdi, “Shkodra dhe motet”, dorëshkrim, f. 535.

3. Dekreti Nr. 19, dt. 14 Kallnuer (janar) 1931, ruhet në arkivin e familjes Myftia.



Xhamia e Parrucës gjatë ndërtimit,
Salih ef. Myftia dhe prefekti i Shkodrës Javer Hurshiti, 1936

kulturore dhe ekonomike. E duhet theksuar se këtë detyrë e kreu me përkushtim të veçantë dhe u shqua si një drejtues i aftë e kompetent.

Gjatë kësaj periudhe mund të vëmë në pah disa veprimtari, ku u përqendrua puna e Salih Efendi Myftisë:

Kryemyftinia e Zonës së Shkodrës dhe Kosovës riorganizohet dhe funksionon më mirë si institucion fetar.

Zëri i kryemyftinisë, i hoxhallarëve të nderuar dhe i intelektualëve të shquar myslimanë dëgjohej i qartë e i fuqishëm në të gjitha strukturat organizative të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe në veprimtaritë që organizohen prej tij.

Për të gjithë hoxhallarët e shquar krijohet një klimë e shëndoshë pune.

Ka një lëvizje të madhe kuadrosash nga qytete të tjera në Shkodër.

Meremetohen shumë xhami dhe emërohen kuadrot më të aftë për shërbimet fetare.

Riorganizohet mësimi i besimit islam në shkollat shtetërore, emërohen për të dhënë mësim hoxhallarët më të nderuar dhe mësuesit më të devotshëm.

Nxiten familjet shkodrane që djemtë e vajzat të ndjekin shkollat e të gjitha kategorive.

Fillon një traditë e bukur botimesh fetare islame, sidomos në shtypshkronjën “Ora e Shkodrës”, ku edhe botohet revista “Zani i Naltë”, organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Ka një lëvizje interesante të intelektualëve shkodranë në shërbim të fesë e të kulturës fetare.

Ka një lëvizje të gjerë kulturore, fetare dhe kombëtare.

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, Salih Efendi u internohet në Gjirokastrë. Lidhur me këtë fakt z. Adem Hodo shkruan: "...Në lëmin kombëtar, me zaptimin e Shqipërisë më 7 prill 1939, qe vënë në shenjë nga zaptontjesit dhe u internua në kalanë e Gjirokastrës për një kohë relativisht të gjatë".⁴

Periudha gjatë okupimit fashist zgjon te Salih Myftia shpirtin luftarak dhe e kalon atë nga një besimtar me Kur'an në dorë në një atdhetar dhe me pushkë në krah organizon rezistencën nacionaliste shqiptare, duke u bërë një nga inspiruesit më të dalluar të luftëtarëve të lirisë e duke u vënë plotësisht në shërbim të çështjes kombëtare.

Në prag të ardhjes në fuqi të pushtetit komunist në Shqipëri, Salih Efendi Myftia me zemër të lënduar mori rrugët e mërgimit për të mos u kthyer më kurrë në atdheun e tij të dashur, për të cilin jetoi e punoi gjatë gjithë jetës së tij pothuajse shekullore.

Largimi nga atdheu për Salih Myftiun nuk kishte kuptimin e shpëtimit, por kishte për qëllim vazhdimin e luftës së pandërprerë

4. Hodo, Adem, Fjala e rastit në vdekjen e Sali Myftisë, gazeta "Atdheu", (organ i Organizatës Kombëtare "Lëvizja e Legalitetit"-O.K.L.L.), New York, vjeti XXVIII, nr. 2 (53), maj-qershor 1978: 4.

antikomuniste dhe rikthimin e lirisë së humbur popullit të shumëvujtur shqiptar, luftë të cilën e vazhdoi deri në minutat e fundit të jetës së tij.⁵

Në rrugën e mërgimit filloi një etapë tjetër e veprimtarisë fetare dhe politike të Salih Myftisë. Që në ditët e para kur ishte në kampin "Grumo" të të mërguarve shqiptarë në Bari, edhe në kushte të vështira morale e të një hidhërimi të thellë, ai më 28 nëntor 1944, Ditën e Flamurit, organizon me të gjithë emigrantët shqiptarë një ceremoni atdhetare dhe fetare. Më pas nga Bari e internojnë për dy vjet në një zonë tjetër, Rexhio Emilia.⁶

Filloi kështu një periudhë e re në jetën e Salih Myftisë, e ngjeshur me vuajtje dhe të panjohura. Ishte një odise e mirëfilltë. Kaloi nga njëri vend i huaj tek tjetri, nga Italia në Egjipt, Siri e Liban.⁷

Gjatë qëndrimit të tij në Aleksandri jo vetëm që u njoh dhe u çmua nga njerëzit më të lartë të rangut të vet fetar, por u pa kurdoherë me nderime të posaçme dhe në rrethet më të zgjedhura të aristokracisë së vendit e të personaliteteve më të njohura të botës arabe.⁸

5. Mulosmanaj, Hysen, "Koha dhe vepra e tij", gazeta "Atdheu", New York, Vjeti XXVIII, nr. 2 (53), maj-qershor 1978: 4.

6. Kupi, Nderim, Intervistë dhënë Radio Shkodrës me rastin e 100 vjetorit të lindjes së Salih Efendi Myftisë, tekstin 11 faqe në dorëshkrim e ruan familja Myftia.

7. Vani, Shaban, Udhëheqës shpirtëror i Myslimanëve shqiptarë në Botën e Lirë, gazeta "Drita Islame", nr. 6, 1992:3.

8. Mulosmanaj, Hysen, "Koha dhe vepra e tij", gazeta "Atdheu" New York, Vjeti

Në mërgim që ndër këshilltarët më të afërm të Mbretit Zog dhe njëri që e ndihmoi më tepër në realizimin e lidhjes midis mbretit Zog dhe krerëve të mërgatës politike shqiptare, e njohur si “Marrëveshja e Aleksandrisë”.⁹

Pas një përvoje të hidhur të jetës së mërgimit, që e detyroi atë të kalojë prej një vendi të huaj në tjetrin, më në fund Salih Efendia gjet prehje e paqe në rrethin familjar të djalit të tij, Fuadit dhe të Bashkësisë Shqiptare të Washingtonit në SHBA, deri në ditët e fundit të kësaj jete.

Atje fillon aktiviteti i Salih Myftisë në fushën fetare dhe pa humbur kohë merr iniciativën për themelimin e Qendrës Islame Shqiptare-Amerikane për shtetet New York-New Jersey dhe së bashku me Imam Isa Hoxhën dhe me ndihmën e intelektualëve shqiptarë hapën të parën shkollë fetaro-kombëtare, ku Salih Myftia, edhe pse tashmë në moshë, asistonte në çdo orë mësimi që mbahej, pavarësisht kushteve atmosferike.

Ngritja e xhamisë, krijimi i Komunitetit Mysliman për shqiptarët e Amerikës, hapja e shkollës së parë fetaro-kombëtare për fëmijët e shqiptarëve myslimanë të Amerikës, janë dëshmi e një përkushtimi të lartë fetar e atdhetar.

Salih Myftia, krahas punës së madhe në fushën e edukimit fetar të

XXVIII, nr. 2 (53), maj-qershor 1978: 4.

9. Deda, Zef Pashko, “Jeta dhe vdekja e tij”, gazeta “Atdheu”, Organ i Organizatës Kombëtare “Lëvizja e Legalitetit” (O.K.L.L.), New York, Vjeti XXVIII, nr. 2 (53), maj-qershor 1978:3.

shqiptarëve në Botën e Lirë, zhvilloi edhe një veprimtari të dendur politike atdhetare.

Për meritat e tij fetare dhe kombëtare trashëgimtari për fronin mbretëror, Leka Zogu e dekoroi Salih Myftiun me Dekoratën “Kordoni i Madh i Skenderbeut”.

“Urojmë me gjithë zemër Hirësinë e Tij, Salih Myftiun, për dekoratën ma se të meritue me dhe ta mbajë për shumë vjet në gjoksin e Tij krenar, si shpërblim për veprat e Tij të nalta për: Fe, Atdhe, Komb e Mbret”, thuhet në një artikull të gazetës “Atdheu” në SHBA, në vitin 1977.¹⁰

Salih Myftia ndërroi jetë në moshën 87 vjeçare, pas një pune dhjetëra vjeçare si dishepull i atdhetarizmit dhe i Fesë islame.

Gazeta “Atdheu” i kushtoi një numër special kësaj ngjarjeje të dhimbshme. Në ballë të këtij numri shënohej:

“Ndrroi jetë në New York, me 19 maj 1978 Hirësia e tij Salih Myftija, ish-kryemyfti i Shkodrës dhe i Kosovës dhe udhëheqësi shpirtnor i myslimanëve shqiptarë në botën e lirë, njeni nga figurat ma të shkëlqyeshme të përpjekjeve fetare kombëtare”.¹¹

10. Dekorim i merituem, Gazeta “Atdheu”, nr. 50-51, New York, nandor 1977:1.

11. Deda, Zef Pashko, “Jeta dhe vdekja e tij”, gazeta “Atdheu”, Organ i Organizatës Kombëtare “Lëvizja e Legalitetit” (O.K.L.L.), New York, Vjeti XXVIII, nr. 2 (53), maj-qershor 1978:3; për më tepër shih: gazeta “Drita Islame”, nr. 6, 1992; Luli, Faik; Dizdari, Islam; Bushati, Nexhmi, “Në kujtim të brezave”, Rozafat, 1997.

Nisjativa te reja për bashkëpunim midis feve II

Abstrakt

Mbassi shoknimi universal është një qëllim i dëshëruar, njerzitet e fës dubet t'i drejtojnë forcat e tyre drejt zhvillimit të këtij shoknimi e të përmbledhen rreth realizimit të tij me seriozitet e besim të plotë. Ky seriozitet dubet t'i drejtohet vetëdijes fetare, për të cilën kemi folë ma sipër edhe të përfitojë nga influenca e fuqishme që kjo vetëdije i bën shpirtit të besnikëve e nga gjanësija e qëllimit të saj si edhe nga instinkti që ka skalitë natyra në shpirt të njeriut. Këtu dubet me e fillue zhvillimin e shoknimit universal.

Plotsimi i këtij qëllimi të madh për vëllaznin universale e zhvillimin e saj mund të kryejt me anë të vetëdijes fetare të të gjitha feve dhe nëpër mjet të virtytit praktik e të parimeve të mira shoqërore që gjinden në çdo fë.

Në të gjitha fët gjinden principe hyjnore që shërbejnë për të mirën dhe dobën e njerzsis e me këtë mënyrë çdo fetar dubet të jetë një organ i dobishëm për shoqni.

X.

Objektet në të cilat njerzitet e fës duben drejtuar.

Objektet, në të cilat njerzitet e fës duhen drejtuar janë dy kategorie: Intelektuale dhe praktike.

a). – Objektivat Intelektuale janë për të hequn shkaqet që penguen

vetëdijen fetare prej lozjes së rolit të saj për të afrue popujt shoq me shoq. Kjo sëmundje rrjedh ose nga të përlyemit e kësaj vetëdije me elemente antagonizmi, ose nga dobësija dhe dis-integrimi (shperndarja) i saj. Njeriu asht dy dyersh: a) ose një besues i vërtetë, besimi i të cilit është mjaft i fortë që të qëndrojë dhe të lëtojë të këqijat e jetës, porse ai mund të jetë në të

njëjtën kohe, gadi të dali nga rruga e vërtetë tue mos qenë i durueshëm për njerin i cili ka një opinion fetar të ndryshëm nga ai i tija – Nji person i atillë nevojitet të drejtonjë besimin e tij në kanale të duhura, tue pastëruem atë prej gjith fëlliqësis; ai ka nevojë për kuptimin e drejtë të esancës së fës, një kuptim i cili asht i lirë pre gjith fundimeve materiale. – b). Ose është një njeri, besimi i cilit është dobësuar, ose zemra e të cilit është zbrazur prej fes. Njerëz të këtij lloji i takojmë ndermjet klasave t'ashtuquajtur t'edukuar dhe gabimisht quajtur të kulturuar. Kjo vjen nga shkaku i konfliktit ndermjet fës dhe ditunis empirikale (eksperimentale) ose nga kundërshtimi që shifet midis fës e shkencës, ose nga tendenca e filozofis letrare për të formuar disa koncepte të mirësis edhe të virtutit të pa sanksionuar prej di feve ose nga shkaku se feja nuk ka mundë me pajtue me format e studimeve shoqnore të drejtueme kah qëllimi i jetës.

Lidhja e këtyne njerëzve me shkencë, sisteme dhanë morale edhe doktrinën shoqnore të jetës aktuale u dha këtyne njerëzve fuqi kundër fës edhe i inkurajuen që t'i prishin lidhjet e saja. Kundërshtimi i pamjaftueshëm e foshnjarak i njerëzve të fës i dha shkak smadhimit të kësaj gremine edhe j'u a shtoi vetëdijen fetare nga zemra e popullit të edukukëm dhe e paksoj ketë vetëdije nder të tjerët.

Tuej qenë se çashtja kështu qendron, asht e urdhnueshme që njerëzit e fës duhe të bashkëpunojnë për të forcuar dhe për të ringjallur të vetdijes fetare edhe të mbushin shpirtat e njerëzvet me friken e Zotit e zemrat e tyre me dashuri për Krijuesin e tyre. Asht detyrë e fundit për njerëzit e fës të mbajnë pozitën e fës para shkencës, filozofis, korrentevet të modernizimit dhe mejtimeve të lira. Nuk ka dyshim se te forcuarit e kësojë vetdije dhe lartsimi i fës ruajnë njerëzimin prej rrezitkut t'inflektimit të së keqes së intetelegjencës dhe prej fuqis së tyre kuer materjalizma ja kalon dhe mundohet të ju prijë dëshirave të tyre harbute.

Njerëzit e fës po të fitojnë të këtyllë njerëz n'anën e tyre dhe po të zgjuajnë vet-dijen fetare, do të bëhen faktori më i fortë për zhbëllimin e vllaznimit njerëzuer. Kjo rrjedh nga shkaku i sensibilitetit ekstrem të tyre dhe kuptimi i imët i idealeve shpirtnore të naltë të propozuar ndër fë, të cillat paraqesin veshhtërsi të madhe për shumicë të paedukuar, që s'janë zhvilluar as në shkencë as në filozofi.

Objektivat praktikë pergjithësisht janë:

Me e bënë një vegël të fortë për edukimin e shoqnis. Faktorët idealë që janë të përbashkët në çdo fë me i forcue që të pregatisin fuqinë e duhur për të bënë efektin e nevojshëm në jetën aktuale të njerëzsis. Virtytet praktikë të porosituna prej fevet të sistemohen e të rrgullohen

Principet e këtilla paksojnë fuqin e të keqes e të ligsave qi veprohen ndër popujt e kombet e botës.

Atëhere pikpamjet e kombeve do të jenë mâ pak divergjente e kështu njerzit do t'i afrohen mâ tepër qëllimit të dëshiruar qi është vëllaznimi universal.

XI.

Asht shumë e mahnitshme dhe për të qarë qi pasusat e fevet të mobilizojnë forcat e tyre për t'a atakuar njeni tjetrin. Ky është shkaku qi i ka dobsuar para armikut të tyre të përbashkët. Në luftrat e tyre, ata adaptuan mjete, të cilat qenë në kundërshtim me rregullat mâ të thjeshta t'arsyes e të cilat i bënë ata qesharakë në sy të shkenctarve e të fillozofvet edhe mâ së fundi shkaktuan që mundimet e tyre të dështojnë vajtimisht. Ata e lanë mas doret influencën e tyre ndaj njeriun nepër mjet të arsyimit të tij qi asht i vetmi shkak për nderin e dinjitetin e tij – dhe vunë në punë forcën, shtrëngimin, prirjen në të keqe dhe mjetet tjera qi t'arrinin qëllimet e tyre. Disa nga këta bile për forcën materjale paten ndihmen e kombeve duke haruar se besimi nuk zen vend në zemër me anën e forcës, edhe dituriya kur nuk mund të pranohet përveç se me anë të argumentit qi na sjell konvinkcion. Ata kanë haruar se anmiku i tyre i përbashkët është duke përdorur çdo mjet për të rrezuar prej pozitës qi me meritim okuponjë. Ata kanë haruar

qi tallazet të mdha kanë shkatruar njerzin dhe kanë fshirë prej shpirtnave të tyre gjithë gjurmat e frikës dhe të reverencës për Ligjet Hyjnore. Në vend qi t'angazhoheshin në konflikte midis tyre pasusit e fevet duhet të kishin bashkpunuar për të luftuar pasjonet e pafrenuar dhe libertizmin të paturpshëm qi e zemrojnë me të drejtë dhe e largojnë të mençmin e të urtin. Ata duhet të kishin luftuar materjalizmin qi rritet pa kontroll e qi bije fatkeqësi pas-fatkeqsije mbi popullin e paqshëm dhe të bindur. Ata duhet t'a luftojnë materjalizmin qi na ndjell të ligat e tija nën emnat e rejshe: civilizim, rregull e liri. Por çka tjetër do të pritesh kurse faktoret e mosmarrveshtjes janë në veprim tuej hedhur poshtë. Njerzit e Fës ashtu siç janë tuej hedhur poshtë të tjerët; kurse kotsit e jetës mundohen t'u prinë në të keqe njerëzvet fetarë ashtu sikurse mundohen t'u prijnë tjerëvet; edhe kurse fetarët kërkojnë fuqi dhe autoritet ashtu sikurse tjerët edhe kurse fetarët fabrikojnë genjeshtra kundra njeri tjetrit sikurse bejnë tjerët?

Me gjithë këto, n'ërsirën e rrethuar të natës, një shkëndí e vogël drite akoma xixillon për të drejtin. Zotit i vjen shumë keq t'i leri krijesat e tij n'ërsirën e së keqes; gjithashtu është i zoti të krijojë mjete, me anën e të cilavet prap mund t'i këthejë në pozitën e nderit e të virtytit.

Zotrinj!

Juve jeni shpresa e fundit të një botës së dëshpruar!

XII.

Si të realizojmë objektivat t'ona.

Tashti un po propozoj këtu shkurtas disa mjete, të cilat do të ndihmojnë për të realizuar këtë objektivën t'onë të madhe: Tash unë tue lanë detajet n'antarët e ndershëm të këtij kongresi edhe n'iderat, të ndryshme të reja, të cilat bashkpunimi i vërtetë ndërmjet t'antarvet dhe të dishirusavet tjerë të njerzimit mund t'i prodhojnë po propozoj këtu shkurtaz disa mjete qì ndihmojnë për të realizuar këtë objektivën t'onë të madhe:

a) Krijimi i një organizate qì të veprojë për pastrimin e vetëdijes fetare nga urejtjet dhe zhalusit e vogëla me anën e mjeteve që posht vazhdojnë:

1) Predikimet në fera të ndryshme për prirjen e njerzimit n'atë që thamë mâ naltë duhen caktue prej çdo fes për predikuesit e saj.

2) Me mbledht të gjitha iderat fetaret tue përmbledhun mirësi dhe dashuni kundrejt gjith popullit si individual të racës njerzore, pa marë para syshë dallimet tjera, edhe me i proklamue ato me të gjith mjetet në tërë gjuhrat.

3) Me stabilizuar propaganda fetare dhe misjonare në bazë të arsyes së thjeshtë, të dashuris për të vërtet dhe të dëshirës së sinqertë për të avitur në ato të vërteta, tue u dhanë kryekëput sicili në deklarimin e të mirave të fës së vet.

Funksioni i kësaj organizate është të vendosi në një mënyrë honorablë, të ndershme dhe të paqshme gjith ndryshimet që sjellin prej agrecioneve të propagandistavet.

b) Krijimi i një organizate, detyra e së cilës të jetë veçanrisht për forcimin e vetëdijes fetare në klasat intelektuale. Këjo organizatë duhet të ketë kujdes të veçantë për të mbajtur pozitën e fës me vezhgimet shkencore dhe me mendimin e lirë në një mënyrë qe të jenë të bazuar në lidhje me arsyen edhe t'i njofti asajë plot të drejta e liri për të kërkue dituni. Këjo përkrahje qì do t'a ngrejë naltë prestigjin e fës nevoisht lypse të varet mbi paraqitjen e provës për me ja mbushë mendjen e popullit me arësye tue largue edhe masat koercive (mundojse) e keqpise, si edhe tue heqë dorë nga mjetet qì kanë për qëllim me përqendruë forcat despotike të autoritetit shpirtnuer.

Shkurt ne duhet t'u largohemi gabimeve të kohës së kalueme, të cilat njerzija i ka pague aq shtrejt.

Këjo organizatë të ketë dega. Një degë duhet të jetë për të përcaktuar ndryshimin qì sot eksiston ose që mund të shkaktohet ndërmjet dituris eksperimentale dhe fës. Këjo punë duhet bërë në rethe të ndryshme shqencore dhe organizata duhet të mari për sipër me caktue këtë ndryshim në baza të dashuris për të vërtetën në një mënyrë të taktikshme e cila nuk do t'a prishi fën e nuk do të proklamojë ndonji gjë kundra të vërtetave të vetdukshme.

Nji degë tjetër duhet të interesohet në opinjone etikale dhe në propagandën e virtyteve. Detyra e sajë duhet të jetë dallimi i opinioneve që rezikojnë jetën morale. Ajo duhet të shkonj thellësisht dhe imtësisht në vezhgimin e atyne opinioneve edhe duhet të bëjë të ditur rezultatet bindse që do të fitojnë përkrahjen e inteligencës së ndershme e kështu të mbrijnë lart idealet e jetës.

Nji degë e tretë duhet të vijojë shkencat shoqnore dhe sisteme e provueme prej tyne të këtilla si socialismen dhe komonismen. Funkcioni i sajë duhet të jetë për të treguar të mirën dhe të vërtetën në to edhe të ekspozojë gënjeshttrat, pasionet dhe dëshirat lakmuse që koruptojnë qëllimin fisnik të jetës. Kjo duhet bërë e ditur në mënyrën e duhur kështu që populli të mund të mari vesht diturin e vërtetë e cila do të jetë e pajtueshme dhe e përshtatun me fën.

Në të gjitha këto përpjekje duhet me pasë për bazë Perëndinë, të vërtetën edhe dobin e njerzís.

XIII.

Tue qenë se, si shkaktar i të ligave që me të drejtë ase pa të drejtë ka pësue njerzija duket si me qenë autoriteti shpirtnuer e njerzít e ktij autoriteti, feja edhe fetarët lypset t'i drejtojnë përpjekjet e veta kah qëllimi që t'a bindin njerzínë të besojë se tash e mbrapa ka shpëtue nga tiranija e

autoritetit shpirtnuer e se feja dhe fetarët përpiqen vetëm për lumtërinë të njerzís.

Gjithashtu lypset me forcue me fjalë e me punë njësin fetare e me u përpjekë që t'i mbushet mendja njerzís s'çoqme se njerzít e fës nuk lakmojnë gjanat materjale e nuk dëshirojnë për vehten e tyne ndonji autoritet, gradë e influencë. Njerzít fetar në jetën materjale kanë një pjesë të vogël aqë sa të munden me plotsue misjonin e tyne që është sigurimi i lumtëris njerzore edhe garancia e egzigjencave shpirtnore që i përshtaten prestizhit të njerzísë. Prandaj kleri duhet të përpiqet me e bindë popullin për këto qëllime të shenjta. Po ashtu duhet me u përpjekë që të bindet njerzija se kleri merret vetëm me spjegimin e vërtetë të ligjit hyjnuer edhe misjoni i tyne është me thirrë njerzínë në këtë ligjë e nuk kanë asnji qëllim tjetër. Atëherë njerzít e fës duhet që mâ përpara vetë ata t'i praktikojnë porosit e ritet e fës edhe t'ju a ndriçojnë rrugën atyne që e kanë humbë.

Përpjekjet e fetarëve në mënyrë që u spjegue mâ sipër do t'i sigurojnë dobinë njerzís edhe do t'i çelet një rrugë e gjanë fuqís së fës për të punue për vëllaznimin e popujve. Me këtë mënyrë principet fetare, virtytet morale e idealet e nalta shoqnore me anën e unifikimit të sistemeve praktikë të ndihmueme prej doktrinash e opinionesh të mira fitojnë energji veprimi që na shtyejnë me u përpjekë për mbrojtjen e ligjit e të rregullit.

Sikurse njerzit e doktrinave shoqnorë që krijojnë ligje të ndryshme për të forcuar bazat e principet e tyre ashtu edhe njerzit fetar lypse të j'u apin fuqi ligjëve që venë sanksione për mbrojtjen e sistemeve të përgjithëshme e të përbashkta ndër të gjitha fét. Me luftue prostitucionin (zinán) me mbrojtë familjet, me qortue e me përbuzë rrenën, kritikën tinzore, thashë e thanat, mshefjen e së vërtetës e shpifjen, vese këto, për të cilët nuk paramendohet ndeshkim materjal. Me kufizue lirin ndër veprime epshore e me ndalue kënaqat jo fisnike; me kontrollue fitimet lëndore e me ndalue të ligat; me marrë masat kundër spekulimeve, shpërdorimeve e mashtrimeve. Me këtë mënyrë me shdukë e me çranjosë këto të ligq tue vù në veprim principet morale e të urta të feve e tue pastrue njerzín nga immoraliteti.

Praktika e gabuar që është ndjekë deri sod e ka lakue e tjetërsue fytyrën e fés, ose e ka dobsue n'atë shkallë sa që s'ka mundë me i u bâ ballë atyne zemergurëve që s'kanë ndërgjegje e e kanë zemrën krejt të zbrazët nga frika e Zotit e nga mëshira për njerzi.

XIV.

S'ka dyshim se ndër ata që tue përdorë mjetet e plota dhe energjike për të realizue qëllimin e dëshiruem që është shoknimit i njerzvet të fés e i sekteve të ndryshëm, duhet të ndodhen ata që i kanë zemrat të

ndriçue me dritën e besimit edhe shpirtin e kanë të shkëlqyem me frymëzime të shenjta.

Nuk duhet harue se mjetet që do të përdoren për këtë qëllim lypset të jenë largë nga çdo influencë e sistemeve dhe konflikteve politike. Mjetet e naltpërmenduna duhet të mbështeten në të vetmin qëllim që të konsolidojnë komunitetet e të zhvillojnë vetëdijen fetare e virtytin. Duhet me ja shtue energjinë shpirtit luftar që kundërshton të ligat e korupsionin që ka mbulue botën tej për tej e që ka shti njerzinë në një greminë të rrezikëshme dhe e ka tronditë tepër. Sod njeriu në vend që duhet të mendojë gjana ideale e të shenjta, nuk mendon tjetër veçse si e si t'a shfryejë epshin e tij, të përmbushë dëshirat shtazore edhe t'a nginjë barkun e tij të zbrazët.

XV.

Pikpamja e eme për zhvillimin e shoknimit universal përmbledhet në të marrunat e masave që kam parapa e paraqitë deri këtu edhe mbështetet në baza të sakta. Mjetet që parashtrova edhe pse janë të holla, janë të praktikueshme, sadoqi kanë nevojë për një përpjekje të gjatë e të zakonshme, porse qëllimi është fisnik e situata është me randësi.

Islami mund t'i japë forcën e duhur shoknimit universal; sepse nër principet esensiale që ka fiksue Islami ka edhe një bazë ku

mbështetet «bon-sensi» e këjo bazë është «*S'ka shtrëngim në fë.*» I Madhi Zot në Kuran Resulit të Vet, Hazreti Muhammedit Alejhisselam kështu i flet: «*A ti po e shtrëngon njerzënë qi të bâben muslimanës?*».

Në një verset tjetër i urdhënon:

«*Thirr në rrugë të Zotit me mençuri, me këshillë të mirë e lufto-ji kundërshtarët me mënyrën mâ të urtë.*»

Islami i drejtohet mendes dhe i tërheq verejtjen me mejtue në krijesat e Zotit a me ngritë naltë prestixhin e diturisë e të dijetarëvet.

Ç'do dispozitë islame është edhe një princip moral. Profiti Islam urdhënon:

«Un u dergova prej Zotit qi të plotsoj vertytet moral të nalta».

Gjithashtu këtij Profiti të naltë i urdhënon Perëndija në Kuran: «Si kur të kishe qenë ti i rëndë dhe zemër ngushtë, kishin me t'u largue shokët; mos i u veshtro mungesat por fali edhe këshilloju me to në problemet e jetës.»

Feja Islame nxit e propagandon të mirën e mëshirën, porositi me përkrahun të pafuqishmin e të vobegun e na urdhënon me pasë

dhimë deri për shtazët, aqë sa në Kodin Civil të Islamit ushqimi i një shtazës qi ka humbë të zotin i ngarkohet Arkës së Shtetit deri sa të gjindet i zoti. Për të vobegët ka caktue pjesë legale nga malli i pasanikëve.

Islami krimin qi bâhet kundër jetes së një personi e konsideron krim-publik qi bâhet kundër krejt njerzís.

Islami ka vû edhe rregulla për të ndeshkue ta qi s'i binden ligjit.

Zotni, nuk po e zgjas mâ, sepse as un as Zotnija e Juajë nuk kemi qellim me shkoqit parimet islame. Qëllimi i em me sa spiegovala deri këtu, ka qenë qi t'ju bâj me dijtë Zotnin t'uajë se objektiva e këtij kongresi nuk është në kundërshtim me parime dhe dispozitat Islame.

Zotnij si mbarim të kësaj fjalës s'eme, I lutem të Madhit Perendí qi të Ju falë ndihmën e Vet për të realizue qëllimin e naltë qi keni vû para e qi është vetë e mira e njerzís. Perëndija ju a ndriçoftë udhën qi keni marrë e ju udhëheqtë në rrugë të mbarë.¹

1. Marrë nga revista «Zani i Naltë», nr. 10-11, viti XI, tetor-nëntor 1936, f. 293-312.

Abstracts in English

Islamic sciences

1. THOUGHTS

Rexhep Vokë - Tetova

Mufti of Manastir

Abstract

Prof. Dr. Feti Mehdiu

The book "Thoughts" is written in the Albanian language using the Ottoman alphabet. Vokë, like many other Albanian authors, who have written their works in Oriental languages - mainly in Turkish, Persian and Arabic - wrote this work in a rhymed prose. Obviously, such a format had a great influence in the Oriental literature. Here we will not dwell on detailed analysis because this is not our goal, but we just want to present Rexhep Vokë's work to all those who deal with studying the issues of the history of our national culture. Only in this way - since this work in its form, was not familiar to the majority of scholars so far - we think opportunities are created for a work to be truly appreciated. Understandably, this must be done by weighing it with the scales of his time and the circumstances in which this work was born.

2. Hafiz Ali Kraja, "Is religion necessary?"

Does it hamper the national unity?"

Khorphina Seferi

Bedër University College

Abstract

Hafiz Ali Kraja is considered as one of the prominent personalities of the Albanian world. He was well versed and was not only equipped with theological formation, but he also was an intellectual scholar. He contributed to the preaching of religion in relation to the needs and problems of the time. He helped in the propagation of the knowledge, the defense of the homeland, and the interest of the national cause. The oratory and the patriotism he had in his speeches had a lot of influence on the people. Hafiz Ali Kraja has given great importance to the national unity, explaining that religion is not an obstacle to

national unity. He emphasizes that humanity needs religion in a spiritual, moral, legal and social viewpoint. Hafiz Ali Kraja has given a great significance to morality, claiming that the foundation of morality should be based in the religion. He has also given a particular importance to the explanation of Islam in relation to fanaticism, atheism and secularism. He also wrote about the old civilization, which cannot be separated from religion and has tackled the world's problems after the general war. The issues discussed are explained by verses from the Holy Quran and Hadith of Prophet Muhammad (SAWS).

Studies

3. "The Discourse That Became the Keystone of Religion"

Prof. Assoc. Dr. Rahim Ombashi

Bedër University College

Abstract

The Albanian society's performance during the Albanian National Renaissance period has been accompanied by the enrichment and development of the Albanian language, which in turn has helped the development and progress of the Albanian society in not just one aspect. Critical thinking supplemented by Hegelian metaphysics helped the Albanian religious leaders to use the discerning discourse of the bookstore as a style which was used in its beginnings through publications to draw national understanding and accompanied by the tenderness that he needed so much. This kind of discourse that kept alive the hope and faith for the future, approaching the rationality that hampers the emotional decisions, harshing the patience of all who worked for national brotherhood, as a step further on the path of creating national consciousness and protecting the Albanian identity. The philosophy of gentleness and patience, the relevant vocabulary, the clenched spirit, and the context of its use, speaks of the efficiency of the style of communication, and, on the other hand, the spiritual prosperity of the Albanian speakers who came through it to compose national conscience and not least other impacts from this kind of linguistic communication, which proved to be very successful. Thin library discourse became a model and enriched the conversational discourse by weakening the claustrophobia, which massively ill with us, opening the way for the philosophy as the key to the expected integration.

Little research, their approaches, and the analysis of the findings will be complemented by models that document novelty, which was brought to light by the formation of the Albanian citizen and on the other hand, he perfected himself.

Armed with this kind of mindset and with the kind of linguistic tools needed, the exquisite library discourse was made to the side of Albanian emigrants in the places where they lived, serving there in the benefit of the national cause.

Keywords: brotherhood, preacher, mindset, claustrophobia, counselor, philosene, understanding

**4. “The Madrassahs of Shkodra”
(from the beginning to 1947)
Prof. dr. Njazi Kazazi
Department of Linguistics
University of Shkodra “L. Gurakuqi “**

Abstract

This study was carried out in order to illuminate the work of teachers and students of the Shkodra madrassahs and to point out the precious help they have provided in the national issues and the education of new generations; with the objective to put into the right place what was denied for half a century, and to give them the importance they deserve in the history of Albanian education. Such a legitimate right is made possible due to the blessed days of democracy that came to us. But, as a well-known poet has written, for us “... democracy is not just an electronic calculating machine to dig in newspapers and magazines of half a century ago, and to count phrases and expressions published by the authors and use them as accusatory arguments”.

**5. Mawlana Jalāl ad-Dīn Muhammad Rūmī
Symbol of Love (II)
Dorian Demetja, Muslim Community of Albania**

Abstract

Although nearly eight centuries have passed since his time, Mawlana’s messages never get old, still keeping their original freshness and vitality within us. Designed to convince people that they can do miracles through love, Mawlana has been studied for centuries by many universities and renowned researchers around the world. According to him, the divine love implies a mutual love: God’s love for humans and humans love for Him. Such mutual love, between God and humans has a common nature, it is a light that shines everywhere and always, it represents the sincere light of existence and the invitation to existence in reality. According Mawlana, the paths that lead to the Creator are open to all who strive hard enough. The only thing to do is throwing away the treasures of this world in order to be enriched by the Lord’s love. As he always emphasized, “Man needs two things: love and teared eyes”.

History

6. History of the Albanian personalities from Vilayet of Ioannina (1859-1909) Syrja bej Vlora

Abstract

The book of Syrja bej Vlora "The story of the Albanian personalities from Vilayet of Ioannina (1859-1909)" is an encyclopedic work of an indisputable value for the Albanian historiography. This because firstly, it was the first attempt made on this issue, at a time when our scientific institutions were not established yet; and secondly, the information provided in it regarding some historical personalities constitutes a novelty.

In a footnote of the preface of the manuscript in Albanian regarding these biographies, the translator Jonuz Tafilaj writes that they were prepared as an annex to the work of Syrja bey Vlora previously translated by Ali Asllani. However, based on their volume, these biographies constitute a separate book. Therefore, given that they have not previously been integrated into any version of the already published book of Syrja bey Vlora, we are bringing it for publication for the first time in the scientific journal "Zani i Naltë".

This script is written in the Ottoman language and, together with the translation into Albanian, is found in the Central State Archive of Tirana. He has in total 78 pages in Ottoman and 120 pages in Albanian, translated by the renowned Orientalist Jonuz Tafilaj. In the inventory compiled by the head of the Ottoman manuscript sector in the historical archive, the orientalist Haki Sharofi, it is written the date of receipt of this translation (June 26, 1963). As for the time when it was written by Syrja bey Vlora, we still have no data.

Although this manuscript translation is in the northern (Gheg) dialect and contains a considerable amount of errors, we have tried to intervene only where it was indispensably necessary. This, because the dialects, in addition to the translations done in a given period, are a tremendous asset and bear the stamp of the time.

The book provides information on the most prominent personalities of Southern Albania, who, from an administrative point of view, were included in Vilayet of Janina at that time. Here is briefly written, and sometimes even longer, about the formation, role and contribution of the famous personalities of the Albanian world. Furthermore, in this book one can find a lot of details, which, given that they are written as an integral part of a memorial book, cannot be found in any other book. This enriches and makes it more beautiful to the reader, but also more valuable as a historiographical source for scholars.

Despite the level of translation and mistakes, we think that publishing this part of the book at the “Zani i Naltë” magazine, is necessary. This is a homage to the forgotten and unjustly anathemated author, to the honored translator, orientalist Jonuz Tafilaj and, finally, to Albanian historiography and memorialistics.

Dr. Hasan Bello

Recension

7. Review on the book

“Halveti Tariqqah among the Albanians”

by the scholar Dr. Alban Dobruna

Dr. Ilirjana Kaceli

Bedër University College

Abstract

During the post-communist period, in Albanian historiography, a series of new studies - particularly in the historical, but also in the religious field - based on archival documents and authentic sources, have been carried out so far. However, when speaking about the field of the religions of Albanian historiography, we can assert there is a lack of a proper study on sufism and Islamic tariqqahs. The monograph that we are discussing about, has been compiled for one of these Islamic tariqqahs, the Halveti tariqqah to the Albanians. Researcher Alban Dobruna comes to the readers with new facts and assertions, from the scientific point of view, shedding light on the historical, social and cultural factors that influenced the development and propagation of the activity of this tariqqah, from the founding to the present day. In this work, the author for the first time provides the reader with a different view from what we have been used to read so far on the history of religions. Through various archival data and resources, we get enlightened by the analysis carried out on them. The work done by the author himself, as a writer of this book, shows that its compilation required a deep knowledge of the Albanian historiography in general and especially the history of religious affairs to Albanians. Halveti's contribution to the Albanian National Movement, in the formation and consolidation of the Albanian state, brings the efforts of all Albanians regardless of religion in the Movement for Autonomy and Independence at the end of the 19th century and early 20th century, as well as their contribution in improving the social situation of Albanian people.

Personality

8. Salih efendi Myftia (1891-1978)

Mufti of Shkodra and Kosovo (Gjakova) Leader of Muslim Albanians in the US

Abstract

Salih Efendi Myftia was born in 1891 in Shkodra, in a prominent familiar, intellectual, religious and social environment. He received the first lessons in the Madrassah of Shkodra and then met in Vlora the well-known intellectual and theologian Haxhi Vebbi Dibra, the mufti of that city at the time, showing a special commitment to religious knowledge. Since an early age he had good knowledge in Oriental languages: Arabic, Persian and Turkish. Very soon he gained the sympathy of the inhabitants of his homeland, and with his commitment and dedication, he elevated the image of prominent religious leaders. A special attention he had given to the enrichment of the family library, which he had inherited from the ancestors. This library has been mentioned in many press organs, but it can be noted that it was among the oldest and most complete library available, containing religious, philosophical works and many books of other branches of science where Salih Efendi studied and supplemented his cultural and religious background. Unfortunately, this 300-year-old library has completely vanished because of the destructive billow and persecution of the atheistic political spirit.

Retrospective

9. New Initiatives for Cooperation between Religions (II)

Abstract

Since universal friendship (fellowship, brotherhood) is a desirable goal, people of faith must guide their forces towards the development of this companionship and summarize its accomplishment with seriousness and full confidence. This seriousness must address the religious consciousness – for which we have discussed to - and benefit from the powerful influence that this awareness has to the spirit of the faithful and from the legacy of its purpose as well as by the instinct that skins the nature of the human beings soul. It is necessary to start from here the development of a universal fellowship.

The accomplishing of this great goal for the universal brotherhood and its development can

Abstracts in English

be done through the religious awareness of all religions as well as through the practical virtue and good social principles found in each religion.

In all religions there are many divine principles that serve the good and the benefit of mankind and therefore, every religious should be a useful social organ.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtrton.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.